

UNIVERZITETI I EJL



Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ

Факултет за јавна администрација и политички науки

SEE UNIVERSITY

Faculty of Public Administration and Political Science



STUDIMET POSDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

“Shtetformësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pavarësia e deri më sot”

Kandidati:

Miranda Fejzullai Murseli

Mentori:

Prof. dr. Agron Rustemi

Tetovë, Gusht, 2019

DEKLARATË

Unë Miranda Fejzullai Murseli,

me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autor origjinal i këtij desertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale. Informacini i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listen e burimeve .

Tetovë , 2019

.....

Gjithkush dëshiron të jetojë në kurriz të shtetit.

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

DEKLARATË.....	2
ABSTRAKT (Në Gjuhën Shqipe).....	7
1. HYRJE.....	11
2. Qëllimet e hulumtimit.....	14
3. Hipotezat.....	15
4. Rëndësia e punimit	16
KAPITULLI I DYTË.....	18
2. Kthesë historike për RMV.....	18
1.1 Pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.....	21
1.2 Aparati shtetëror në shuarjen e mendimit të lirë	23
KAPITULLI I TRETË.....	28
3. Pavarësia e RMV-së.....	28
3.1 Problemet e trashëguara nga ish-RSFJ.....	30
3.2 Laramania e partive politike.....	38
3.3 Indiferenca ndaj problemeve ndëretnike	46
3.3 Sfidat me të cilat ballafaqohet RMV.....	53
3.4 Marrëdhëniet me fqinjët.....	57

KAPITULLI I KATËRT.....	62
4. Zgjedhjet parlamentare të 2016.....	62
4.1 Periudha pas zgjedhjeve 2016.....	66
4.2Ndryshimi i emrit	72
a) Bisedimet e drejtëpërdrejta.....	78
b) Shërbimet e mira	79
c) Ndërmjetësimi	79
d) Komisionet anketuese	83
e) Pajtimi	84
f) Arbitrazhi	86
a) Reagimi i opinionit të brendshëm dhe të jashtëm	94
4.3 Ndryshimi i kushtetutës	101
4.2.1 VENDIM PËR SHPALLJEN E AMENDAMENTEVE XXXIII, XXXIV, XXXV DHE XXXVI TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	103
4.3 Ratifikimi i protokollit	105
KAPITULLI I PESTË.....	107
5. Përfundimi.....	108
5.1 Vlersime individuale	116
□ Literatura e konsultuar	120
Dokumente burimore.....	125

Falënderim

Falënderimi më i madhë i takon ALL-LLAHUT të madhëruar që së pari më ka dhënë shëndet dhe pastaj të gjitha mundësit tjera për të studiuar dhe arritur gjerë këtu .

Përgatitja dhe finalizimi i këtij projekti kaq të rëndësishëm në jetën profesionale dhe akademike ka gjetur mbështetjen , përkrahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm në jetën time , të cilët gjej rastin t'i falenderoj për zemërsisht.

Mirënjohje dhe falënderim për udhëheqësin shkencorë Prof. dr. Agron Rustemi për ndihmën që më ka dhënë gjatë strukturimit dhe shkrimit të temës dhe për mbështetjen profesionale , akademike , psikologjike , dhe shpirtërore në hartimin dhe përfundimin e këtij punimi .

Falënderimet më të përzemërta i takojnë familjes sime , në veqanti prindërve të mijë të cilët në rradhë të parë më dhanë edukiminë mbështetjen dhe inkurajimin për të arritur objektivat jetësore.

Njëkohësishtë falë përvojës së tyre , ata më dhanë besimë dhe kurajo përgjatë periudhave më të vështira duke dëgjuar ankesat dhe frustrimet mia .

ABSTRAKT (Në Gjuhën Shqipe)

Lënda e këtij hulumtimi do të jetë shqyrtimi i krijimit të shtetit maqedonas, raportet e shtetit me shqiptarët, procesin e zgjidhjes së problemit të emrit, mënyrën e ndërmjetësimit ndërkombëtar si dhe zhvillimin e diplomacisë mes vendeve fqinje që nga themelimi i Maqedonisë deri tek arritja e Marrëveshjes së Prespës. Që nga shek VI e deri në rënien e Perandorisë Romake: Në kohën e Filipit II të Maqedonisë simbolit 359-336 pes) dhe birit të tij Aleksandrit të Maqedonisë simbolit 336-323 pes) shteti i Maqedonisë ka arritur zenitin e zhvillimit të saj. Rebelimi në XI shekullin mizor kundër Perandorisë Bizantine, e udhëhequr nga Peter Delijan, nipi i Samuelit. Maqedonia ra nën dominimin e Perandorisë Osmane, e cila do të zgjasë pesë shekuj. Themelimi i Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (VMRO) në Selanik. Objektivat kryesore: liria kombëtare dhe të drejtave autonome dhe krijimi i shtetit. Kryengritja e Ilindenit e udhëhequr nga banorët e Maqedonisë, kërkonte pavarësinë nga Perandoria Osmane. Kryengritja filloi në Ilinden dhe përfundoi dhjetë ditë më vonë me shuarjen e osmanëve që la 4.000 të vdekur. Kryengritja ka qënë kryesisht në qendër dhe në veri të territorit të sotëm të Republikës së Maqedonisë, në afërsi të fshatit të Ilindenit në Krushevë, e cila më vonë është quajtur edhe si Kryengritja e Ilindenit. Lufta e Dytë Ballkanike nis me aleatët e Luftës së Parë Ballkanike t[cilët filluan një luftë për dominim mbi Maqedoninë. Traktati i Bukureshtit (10 gusht 1913) e ndanë Maqedoninë mes Bullgarisë, Greqisë dhe Serbisë. Vijon periudha e dy luftërave botërore dhe historiku i Republikës së Maqedonisë së Veriut mes periudhës të dy luftërave, të cilat lanë gjurmë të thellë në gjithë historikun njerëzor. Data e 11 tetorit, 1941 njihet edhe si data e fillimit të luftës kundër fashizmit.

Republika e Maqedonisë të gjitha forcat e tyre dhe potencialet lëvizur drejt zhvillimit ekonomik dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm ekonomik. Stabiliteti gjatë makroekonomik dhe inflacioni i ulët ka mesatarisht 2 për qind në 10 vitet e fundit, vendi ka balancuar financat publike, deficitet e ulëta buxhetore, kurs këmbimi stabël dhe borxh të ulët publik është 32.5% të produktit të brendshëm bruto. Në vitet e fundit implementuar një sërë reformash në lidhje me tregun e punës dhe masave aktive për punësim, papunësia ra me rreth 4 për qind. Reformat e gjithanshme e kanë përmirësuar klimën e përgjithshme të biznesit, sepse shumica e përgjithshme e

investimeve të huaja direkte në Maqedoni në periudhën prej 1998 deri 2009 është rreth 3 miliard euro. Në Kushtetutë, si bashkësi që është shumicë—merret vetëm bashkësia e popullit maqedonas. Kjo e drejtë i mohohet popullit shqiptar edhe pse janë shumicë mbi 40% e popullatës dhe padrejtësisht i llogarisin si bashkësitë që nuk janë shumicë (sipas terminologjisë ndërkombëtare—pakica nacionale). Populli shqiptarë, për nga të drejtat kushtetuese dhe shtetformësia, barazohet me turqët, vllehët, romët, serbët, boshnjakët dhe të tjerët. Këta janë përfshirë në një terminologji të re të përbashkët kushtetuese, “të drejtat e pjestarëve të komuniteteve” me kuptimin e pakicave kombëtare. Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, u braktisën, poashtu edhe terminologjitë e mëhershme: “nacionalitete” si dhe “kombësi” 228 dhe zëvendësohen me emërtimet: “pjesë e popullit shqiptar” -“komunitete” apo “bashkësi”; -“pjestarë të komuniteteve”;²²⁹ -“së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshëm nga gjuha maqedonase”; “deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në RM-së”

PJESA E PARË

1. HYRJE

Mbledhja e parë e ASNOM-it u mbajt më 2 gusht të vitit 1944 në hapsirat e manastirit “Shën. Prohor Pçinsiki”, në veri të Kumanovës. Pak para fillimit të mbledhjes nga 115 delegatët e zgjedhur, kanë ardhur 60 delegatë. Ata që nuk kanë mundur të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në këtë mbledhje, kanë dërguar persona të autorizuar të tyre. Në mbledhjen e parë të ASNOM-it ka pasur delegatë nga pjesa e vardarit, pirinit dhe egjeut të Maqedonisë, si dhe ka pasur delegate nga Presheva dhe Bujanovci. Në këtë mbledhje janë sjellur 9 akte shtetërore-konstituive. Domethënia dhe rëndësia e dokumenteve nuk ka qenë e njëjtë, por ka qenë po aq e rëndësishme sa i përket konstituimit të Maqedonisë si shtet. Përveç kësaj, në mbledhjen e parë të ASNOM-it, është zgjedhur Presidiumi (Kryesia) e ASNOM-it, e përbërë nga kryetari, dy nënkryetarë, dy sekretarë dhe 17 delegatë të besuar. Për kryetar të Presidiumit është zgjedhur Metodija Andonov-Çento. Nga mbledhja kanë dalë edhe Manifesti dhe Shpallja deri te populli i Maqedonisë në të cilën kanë qenë të dhëna rezultatet të cilat kanë qenë si obligim për angazhimin e mëtejshëm për realizimin e qëllimeve paraprake. Mbledhja e parë e ASNOM-it jo rastësisht zë vend të rëndësishëm në historinë kombëtare të popullit maqedonas.

Por rëndësia e kësaj mbledhje nuk merret vetëm me sukseset e arritura për zhvillim të lirë dhe të gjithashnjshëm kombëtar, por edhe me zhvillim që arrin kulmin për të rrumbullaksuar përpjekjet për formim të shtetit. Vendimet e ASNOM-it promovuan procese të karakterit të vazhdueshëm të nisura qysh para Kryengritjes së Ilindenit në vitin 1903 dhe të vazhduara pas Ilindenit të asnomit në vitin 1944. Marshi i madh i shkurtit, i realizuar nga njësitë e LNÇ-së dhe APM-së, si dhe luftimet gjatë ofenzivës pranverore, gjegjësisht kundërofenzivës në vitin 1944, në historinë e taktikës dhe strategjisë së luftimeve në Luftën e Parë Botërore paraqet një provë për udhëheqësinë ushtarako-politike të Maqedonisë të cilët për udhëheqje të suksesshme të operacioneve për lirinë përfundimtare të Maqedonisë. Gjatë operacioneve njësitë e LNÇ-së dhe APM-së jo vetëm që me sukses arritën ta mbrojnë territorin aktual, por arritën që të çlirojnë edhe territore të reja të cilat më vonë shërbyen si bazë për luftimet e mëtejshme gjatë periudhës vijuese. Në territorin e lirë të Kozjakut, më 2 gusht të vitit 1944 u mbajt mbledhja e parë e ASNOM-it në manastirin “Shën. Prohor Pçinski”. Duke miratuar dhe duke vlerësuar angazhimin e përgjithshëm që deri atëherë e dhanë SHP i LNÇ dhe APM, mbledhja e parë e ASNOM-it me

njërën ndër vendimet e para të saj, shprehu falenderimet dhe mirënjohjet ndaj SHP dhe ndaj Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Maqedonisë dhe aradhave partizane. Me 6 gusht të vitit 1944 në përputhje me ndarjen administrative territoriale të Maqedonisë nga ana e Presidiumit të ASNOM-it, pason ndarja e dytë me rradhë ushtarako-territoriale e Maqedonisë nga ana e SHP të LNÇ dhe APM në katër zona operative. Në atë kohë lufta e armatosur mer intenzitet dhe shëndërrohet në lutë masive, para se gjithash falë fluksit të madh të ushtarëve dhe vullnetarëve të rinj. Fillon procesi i rritjes së numrit të njësisve të LNÇ-së dhe APM-së dhe formimi i divizioneve. Duke parashikuar kapitullimin e Bullgarisë, SHP e LNÇ dhe APM zhvilloi përgaditje organizative për çarmatimin e ushtrisë okupatore bullgare me qëllim të hapjes masive të luftimeve. Ndarja e dytë me rradhë ushtarako-territoriale e Maqedonisë përputhej me ndarjen e parë administrative të territorit të Maqedonisë të cilën e realizoi Presidium i ASNOM-it. Katër zonat e reja operative ishin: Zona e Shkupit, e dyta Zona e Manastirit, e tretë Zona e Strumicës dhe Bregallnicës dhe e katërta ishte Zona e Kërçovës dhe Dibrës. Kurajo të madhe për zhvillimin e ushtrisë së Maqedonisë në këtë periudhë dha edhe mbledhja e parë e ASNOM-it më 2 gusht të vitit 1944 në manastirin “Shën Prohor Pçinski”. Kjo solli deri në formimin e katër divizioneve ushtarake sipas madhësisë. Për shkak kësaj SHP e LNÇ më 24 gusht të vitit 1944 kërkoi nga Shtatmadhëria e UNÇJ-së numra të reja të formacioneve për DNÇM-në si dhe për ato grupe që ishin në formim e sipër. Më 26 gusht të vitit 1944, Shtatmadhëria e UNÇJ-së ju përgjigj kësaj kërkesë dhe i ndau numrat e ri të formacioneve në kuadër të LNÇ-së dhe APM-së të DNÇM-së, të cilat në të ardhën do ti mbanin numrat 41. dhe 42. të DNÇM të UNÇJ-së. Pas kapitullimit të Bullgarisë si dhe fluksit të shpejtë dhe të madh të ushtarëve dhe vullnetarëve të ri, sidomos pas luftimeve 15 ditore për lirinë e Prilepit, përmes të cilat kaluan pothuajse të gjitha njësitë e Maqedonisë të cilat vepronin në perëndim të lumit Vardar, u ndje nevoja për tërheqjen nga vija e frontit për marrjen e këtij qyteti, për të fituar kohë për një riorganizim ushtarak si dhe për përcaktimin e një strategjie të re për luftimet vijuese. Për këtë qëllim SHP e LNÇ-së dhe APM dha urdhër për vendosjen e njësisve të Maqedonisë në një hapësirë më të gjërë në afërsi të linjeve të komunikimit me qëllim që të mund të drejtojnë luftën e tyre përgjatë linjeve hekurudhore dhe atyre të komunikacionit. Të gjitha luftimet paraprake kontribuan që njësitë e LNÇ dhe APM të marin përvojën e duhur ushtarake, përvojë e cila zbatimin e saj do ta gjejë gjatë periudhës së ardhshme në operacionet për lirinë e qyteteve dhe vendeve tjera për lirinë përfundimtare të Maqedonisë, kur pothuajse çdo qytet duhej të meret me

luftime të afërta. Kapitullimi i Bullgarisë në shtator të vitit 1944, SHP e LNÇ e priti me një rritje të konsiderueshme të formimit të brigadave dhe divizioneve të reja. Ky process edhe më shumë filloj të përshpejtohet gjatë muajve të ardhshëm. Ashtu si rritej intenziteti i luftimeve të armatosura, ashtu edhe njësitë ushtarake bëheshin më masive, numri i të cilave gjatë periudhës së ardhshme rritej në mënyrë kualitative dhe kuantitative. Formimi i qeverisë së parë maqedonase. Në 45 vitet e ardhshme, Maqedonia është një nga gjashtë republikave që përbënin federatën jugosllave. Referendumi për Pavarësinë e Republikës së Maqedonisë. Pas shpërbërjes së federatës jugosllave, Maqedoni, në vitin 1991, me referendum shpallet shtet i pavarur, sovran dhe i pavarur, deri në vitin 2001 kur gjërat filluan të eskalojnë jasht kontrollit. Një tension i fortë etnik fillon të ndikojë në vendin në vitin 2001, tension i cili theksoi rëndësinë e popullsisë shqiptare, si pjesa më e madhe në disa territore të vendit të cilët kërkonin pushtet më të madh. Më 13 gusht të vitit 2001 u nënshkruajt Marrëveshja Kornizë e Ohrit në mes të dy palëve dhe përfaqësuesve të veçantë të BE dhe SHBA, marrëveshje e cila i dha fund konfliktit etnik gjashtë-mujor në vend. Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe zbatimi i saj është një nga prioritetet kryesore të Republikës së Maqedonisë për procesin e demokratizimit, ndërtimin e besimit në institucione dhe integrimin e vendit në Unionin Evropian. Marrëveshja Kornizë e nënshkruar më 13.08.2001 i dha fund konfliktit të mbrendshëm në Republikën e Maqedonisë, dhe qëllimi kryesor i saj ishte promovimi i një shoqërie paqësore dhe harmonike, si dhe zhvillimi i shoqërisë qytetare, duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të kësaj Marrëveshje dolën një numër i konsiderueshëm i ndryshimeve Kushtetuese dhe reforma ligjore të cilat duhet të zbatohen nga ana e institucioneve të Republikës së Maqedonisë në sferën e decentralizimit, përfaqësimit të drejtë, procedurave speciale parlamentare për mbrojtjen e etniteteve që nuk janë shumicë, arsimimin, përdorimin e gjuhës, simbolet, shprehja e identitetit kultoror dhe etnik si dhe masat për zbatim. Nga pikëpamja kushtetuese-juridike, Marrëveshja e Ohrit paraqet një kompromis të pashmangshëm lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja Kornizë vendos qytetarin në qendër të sistemit kushtetues dhe politik, duke përmbushur të gjitha vullnetet e çdo individi veç e veç dhe të kolektivitete të tyre bashkarisht për arritjen e paqës, demokracisë, progresit dhe harmonisë së përgjithshme.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet e hulumtimit janë paraqitja kronologjike e zhvillimeve politike në Maqedoninë e Veriut, problemi i identiteti kombëtar maqedonas dhe zgjidhja e tij nëpërmjet të përvetësimit të shtetit dhe shfrytëzimit të aparatit shtetëror për shtypjen e identitetit të etnive të tjera në vend si dhe shpjegimi i marrëdhënieve të Maqedonisë me fqinjët dhe me aktorët global. Në kapitullin e parë do të trajtojmë fillet e qarqeve politike të dalura nga Lufta Anti-Fashiste, për krijimin e një shteti kombëtar maqedonas, Kuvendin e ASNOM-it dhe figurat kyçe që hodhën hapat për krijimin e një shteti të konsoliduar maqedonas, duke e nxjerrë territorin e Maqedonisë së Veriut jashtë kornizave të Serbisë së Madhe (Vardarska Banovina) dhe krijimin e një shteti ekskluziv maqedonas në dëm të pakicave të tjera kombëtare në vend. Në këtë kapitull do të shpjegojmë edhe ngulfatjen e lëvizjeve politike të popujve jomaqedonas, me theks të veçantë të faktorit politik shqipar, si atij komunist po edhe atij antikomunist. Duke vazhduar në periudhën e pavarësisë, problemet e trashëguara nga Jugosllavia si dhe kulminimin e pakënaqësive me konfliktin e 2001. Pjesa më e rëndësishme do të jetë tranzicioni nga partitë populiste në ato me agjendë proevropiane si dhe ndryshimi i emrit me Marrëveshjen e Prespës.

3. Hipotezat

Hipoteza kryesore: Republika e Maqedonisë së Veriut, nga pavarësia e deri më sot nuk ka treguar zhvillim të duhur në formësimin demokratik të saj.

Hipotezat ndihmëse

- Republika e Maqedonisë së Veriut ka treguar rezultate të dobëta në integrimin e saj në NATO.
- Republika e Maqedonisë së Veriut ka treguar rezultate të dobëta në integrimin e saj në Bashkimin European.
- Republika e Maqedonisë së Veriut nga pavarësia e deri më sot nuk ka treguar kapacitete demokratike në zgjidhjen e çështjeve të lidhura me marrëdhëniet ndëretnike.
- Marrëveshja e Prespës i hap rrugën RMV-së për integrimin e vendit.

4. Rëndësia e punimit

Rëndësia e temës në fjalë qëndron në shpjegimin e proceseve integruese , të brendshme dhe të jashtme, dhe rëndësinë e tyre. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që do të trajtohet është edhe arritja e marrëveshjes bilaterale duke i mbrojtur interesat e të dyja palëve dhe duke ofruar zgjidhje të pranueshme për të dy palët e implikuara në çështjen e emrit “Maqedoni”. Do të fillojmë me shpjegimin e terrorit sistematik të ndihmuar nga aparati shtetëror jugosllav për të tjetërsuar kombet tjera të këtij territori dhe për ti bërë pjesë e kombit të ri maqedonas. Kjo qasje destruktive ndaj pakicave kombëtare shkaktoi ndarje të thellë mes popujve të ndryshëm që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Do të ndërlidhim zhvillimet e të kaluarës jugosllave, e që u përsëritën e pavarësinë e RMV-së, gjë që shkaktoi pasiguri në pjesën shqiptare të RMV-së, pasiguri që kulminoi me konflikt të armatosur, gjakderdhje dhe plagë që ende sot nuk janë shëruar.

Rëndësia më e madhe e punimit është tranzicioni i viteve të fundit nga elitat politike populiste në ato progresive dhe me agjendë të qartë europiane dhe integruese. Mënyrën se si u arrit Marrëveshja e Prespës dhe hapjen e rrugës për aderim në strukturat e sigurisë së paktit NATO dhe të hapjes së rrugës së integrimit europian.

PJESA E DYTË

TRAJTIMI TEORIK DHE DEFINIMI I PROBLEMIT

KAPITULLI I DYTË

2. Kthesë historike për RMV

Bota bashkëkohore gjendet në ndryshime të vazhdueshme. Po ndryshojnë edhe marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike, subjektet, bartësit e këtyre marrëdhënieve. Vitet e fundit ndodhën ndryshime të mëdha dhe të fuqishme që e përfshinë të gjithë hapësirën dhe jetën tonë. Me studimin intensiv të disa çështjeve që kanë të bëjnë me ndryshimet thelbësore të rregullimit të sistemit politik, juridik dhe ekonomik të Maqedonisë, prej paraqitjes si shtet i pavarur në skenën ndërkombëtare dhe qëllimi i sajë për t'u zhvilluar si shtet modern demokratik duke u bazuar edhe në përcaktimet dhe parimet e Marrëveshjes së Ohrit janë objekt i këtij hulumtimi të disertacionit të doktoratës.¹ Gjasat e Maqedonisë për ta përsheptuar afrimin dhe integrimin e saj në NATO dhe në Bashkimin Evropian duke e zgjedhur në mënyrë adekuate pozitën shoqërore, ekonomike, institucionale dhe politike të shqiptarëve që jetojnë në këtë shtet paraqet shtyllën e këtij punimi. Shqiptarët në Maqedoni, aktualisht i kanë kushtet dhe rrethanat ideale ta ndryshojnë gjendje dhe fatin e tyre; e kanë momentin e artë në duar për ta ndryshuar rrotën e historisë edhe përkundër faktit se kanë përjetuar vitet më të tmerrshme, fatin e trishtueshëm që t'i përfaqësojë një klasë politike e papërgjegjshme, e korruptuar dhe jo atdhetare, pa plene dhe strategji, pa projekte dhe vizion për të ardhmen. Atë që popujt e botës nuk mund ta arrijnë me shumë sakrifica, me luftë, gjak e shkatërrime, shqiptarët e Maqedonisë e kanë fatin në duar që ta bëjnë vetëm për disa muaj, me organizim dhe rezistencë paqësore, vetëm nëse rizgjojnë në këtë kthesë historike, kur aleatë të fuqishëm që vendosin për fatet e popujve dhe të shteteve janë në anën e tyre.² Këtë mund ta bëjnë shqiptarët në Maqedoni vetëm duke e larguar nga skena politike një

¹ M. Filipović, Deset predavanja o ideji Europe, Pravni centar FOD, Sarajevë, 2000., f. 12-13.

² Roumen Daskalov and Tchavdar Marinov. *Entangled Histories of the Balkans: Volume One: National Ideologies and Language Policies*. 2013. p. 318.

grusht politikanësh të korruptuar dhe hajdutë, një grup oligarkësh të pangopshëm, një klan mafioz dhe një klikë armiqësore e antikombëtare që e mban peng fatin e tyre. Kjo klikë e politikanëve të dështuar, të kapur e të shitur, duhet të ndalohet, të shpërfillet, të bojkotohet, të pensionohet me procedurë të shpejtë dhe në mënyrë shumë elegante. Secili shqiptar i ndërgjegjshëm nuk mund ta tolerojë këtë gjendje, ta nënshkruaj këtë fat me dorën e tij, për pak interesa momentale e të përkohshme, duke e ditur që njeriu jeton vetëm një herë dhe jeta nuk bëhet reprizë; fati që të buzëqesh sot, nesër mund të ju braktisë dhe të mbeten të mjerë, pa mirëqenie, pa lumturi, pa ekzistencë dhe pa nder e dinjitet, pa liri, të humbur përgjithmonë dhe të braktisur edhe nga miqtë. Fati nuk u buzëqesh atyre të që nuk duan të zgjohen as për të mirën e vetvetes, në orën e madhe të historisë që kalon shumë rrallë mbi fatet e popujve. Në shekullin e 19-të, rajoni i Maqedonisë u bë objekt i konkurrencës mes nacionalizmave rivalë. Secila palë, nacionalistët grekë, serbë dhe bullgarë, pretendote se popullata sllavishtfolëse ishte etnikisht e lidhur me kombin e tyre, duke mëtuar kështu të drejtën e përfshirjes së kësaj popullsie në shtetet e tyre.³ Pohimet e para të nacionalizmit maqedonas u ngritën në fund të shekullit të 19-të. Nacionalistët e parë maqedonë u inkurajuan nga qeveri të huaja që kishin interesa në rajon. Qeveria serbe filloi të besonte se çdo përpjekje për serbizimin e maqedonëve dhe për inkorporimin e Maqedonisë në shtetin e tyre, do të ishte e pasuksesshme për shkak të ndikimit të fortë bullgar në rajon. Në vend të kësaj, qeveria serbe besonte se dhënia e mbështetjes për nacionalistët maqedonas do të bënte që këta të fundit nga njëra anë të kundërshtonin bashkimin me Bullgarinë, kurse nga ana tjetër të kishin qasje më miqësore ndaj Serbisë. Një vend tjetër që nxiti nacionalizmin maqedonas ishte Austria-Hungaria, e cila kërkonte të pengonte Serbinë dhe Bullgarinë që ta aneksonin Maqedoninë ndaj pohoi një karakter të veçantë etnik të maqedonasve

³ Roumen Daskalov and Tchavdar Marinov. *Entangled Histories of the Balkans: Volume One: National Ideologies and Language Policies*. 2013. p. 318.

sllavë. Në vitet 1890 u shfaqën përkrahësit rusë të një etnie sllavo-maqedonase. Hartat etnike të bëra nga rusët filluan të tregonin një etni sllave maqedonase kurse nacionalistët maqedonas filluan të vendoseshin në Rusi për t'u mobilizuar.⁴ Duke parë situatën në lidhje me perspektivën e Maqedonisë, në këtë rast, për mua, ka pasur një rëndësi të veçantë përpjekja për të parë të paktën pjesërisht disa institucione evropiane dhe mekanizmat ekonomike dhe politike përmes të cilave mbrohen interesat e përbashkëta të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Ajo që veçanërisht më ka interesuar, dhe që jam përpjekur në këtë punim ta pasqyroj është roli i Marrëveshjes së Ohrit në afrimin e Maqedonisë me Bashkimin Evropian, pra të sqarojë, se çfarë është ajo që duhet të bëjë një shtet, si Maqedonia, për të arritur sa më shpejt të bëhet anëtare e plotë e saj. Kjo ka qenë gjithashtu një nga çështjet e rëndësishme për të cilën dhe nëpërmjet të cilës jam përpjekur të ofroj një përgjigje modeste.

⁴ M. Filipović, Deset predavanja o ideji Europe, Pravni centar FOD, Sarajevë, 2000., f. 12-13.

1.1 Pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

Më 8 shtator të vitit 1991, Republika Socialiste e Maqedonisë mbajti referendumin që vendosi pavarësinë e saj nga Jugosllavia, nën emrin Republika e Maqedonisë. Me rënien e komunizmit, shpërbërjen e Jugosllavisë dhe mungesën e mëpasme të një fuqie të madhe në rajon, Republika e Maqedonisë ra në konflikte të vazhdueshme me fqinjët e saj. Bullgaria vinte në pikëpyetje gjuhën dhe identitetin e saj kombëtar, Greqia vinte në pikëpyetje emrin dhe simbolet e saj, kurse Serbia identitetin e saj fetar. **Republika Socialiste e Maqedonisë** apo Maqedonisa Socialiste ishte një ndër shtetet socialiste-federsale të Jugosllavisë së atëhershme. Kryeqytet i Maqedonisë Socialiste ishte Shkupi (edhe i sotshëm). Maqedonia Socialiste ishte shteti i 4-të për sipërfaqje dhe për popullësi, Maqedonia Socialiste kishte gjithsej 25,333 km² dhe 1.9% ujë ndërsa ishte gjithashtu edhe shteti federal i 4-ti për banorë. Kishte gjithsej 2,033,964 apo më shumë se 2 milion, me dendësi 79.1. Paraja kohore ishte Dinari Jugosllav që në Maqedoni u njoh si **Denarë** apo Denari Maqedon (македонски денари - Makedonski Denari) Nga ana tjetër, shqiptarët etnikë në vend këmbëngulnin të njiheshin si një komb i barabartë me maqedonasit etnikë. Si kundërpërgjigje, u krijua një tip më këmbëngulës dhe më i pakompromis i nacionalizmit maqedon.⁵ Në atë kohë, koncepti i identitetit të lashtë paonian u ndryshua në një lloj identiteti të përzier paonian-maqedon, që më vonë u shndërrua në një identitet maqedono-antik të veçantë, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë me maqedonët e sotëm.

⁵ Këtë konstatim, duke u thirrur në Deklaratën e Këshillit Evropian për Evropën Qendrore dhe Lindore (Statement by the European Council on Central and Eastern Europe), e miratuar në Strasburg, 8 - 9 dhjetor 1989. E kanë publikuar : C. Hill - K. Smith, në: European Foreign Policy – Key documents, London and New York, 2000., f. 194, për tekstin e Deklaratës shih: Po aty, f. 270-271.

Konfliktet që çuan deri në shpërbërjen RSF të Jugosllavisë edhe për bashkësinë ndërkombëtare kanë qenë shumë të vështira.⁶ Shpërbërja e Jugosllavisë, paraqitja e shteteteve të reja të pavarura, dalja e Maqedonisë si një shtet i ri në skenën ndërkombëtare politike dhe ekonomike, e ka intensifikuar problemin e "modelit të tranzicionit " të kalimit nga socializmi në kapitalizëm. Shpresat se, pas dështimit të përjetuar, me transformimin e shpejtë të sistemit socialist në atë kapitalist, Maqedonia do të arrijë një zhvillim të shpejtë dhe dinamik, dolën të gabuara.

Në vend të suksesit, në vend të rritjeve të premtuara dhe të pritura të ekonomisë,⁷ Maqedonia përjeton një rënie të vazhdueshme të potencialit të saj ekonomik⁸ duke e rritur edhe më tepër borxhin me kredi të huaja, kurse ngjarjet e përgjakshme në Kroaci dhe në Bosnje dhe Hercegovinë edhe më tepër e kanë ngushtuar rrethin reth qafës së saj. Procesi i krijimit të kombit maqedonas dhe i Maqedonisë si shtetit është një dukuri relativisht e re. E vendosur në Ballkan, në shekullin e njëzetë, pas përpjekjeve të vazhdueshme për mbijetesë dhe liri, të popullit maqedonas së bashku me popullin shqiptar dhe me popujt tjerë të cilët jetojnë në Maqedoni, gradualisht dhe në mënyrë të sigurt, Maqedonia arriti të krijohet si shtet i pavarur dhe Sovran. Ky proces filloi gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë⁹ dhe përfundoi më 8 shtator të vitit 1991, kur populli maqedonas përmes referendumit në të cilin dolën 75 % të votuesve, prej të cilëve 91 % u deklaruan për Maqedoninë si shtet i pavarur dhe subjekt i barabartë ekonomik, politikë dhe juridik ndërkombëtar. Për shkak të çështjeve të pa zgjidhura në lidhje me pozitën e tyre politiko-

⁶ "Ashtu sikur që natyra nuk toleron kërcime, gjithashtu edhe ekonomia nuk toleron kërcime. Nacionalizimi i të gjitha gjërave ishte një kërcim i tillë, dhe dihet se deri ku çoi kjo. Tranzicioni është një kërcim i ngjashëm dhe vetëm mund të supozojmë se deri ku mund të na çojë "- V. Mileta, Suvremeni procesi europske integracije, Zagreb, 2000. f. 25

⁷ B. Blazhevski, Ostvaruvanja i proekciji na izvozot na Republika Makedonija, Skopje, 2000., f. 167 - 188.

⁸ V. Kandikjan, V. Pendovska, T. Grozdanovski, Ekonomskite odnosi na Makedonija so Evropskata unija, tendenciji i perspektivi, Shkup, 1995., f. 72 - 77

⁹ I. Katardziev, , Makedonija sto godini po Ilindenskoto vostanie ..., op., f. 80

juridike, shqiptarët nuk e përkrahën referendumin për pavarësi të Maqedonisë, por e respektuan apelin e partive politike shqiptare për mosdalje në votim. Si gurthemel i parë i shtetit të ri - Republikës së Maqedonisë, konsiderohet kryengritja e Ilindenit e vitit 1903 kundër sundimit turk. Ngjarjet që ndodhën pas vrasjes së Goce Delçevit nga ana e autoriteteve turke në 4 Maj 1903., çuan deri te kryengritja e 2 Gushtit të vitit 1903, që së shpejti, u kthye në një lëvizje popullore për çlirim kombëtar dhe shoqëror nga sundimi turk.¹⁰

1.2 Aparati shtetëror në shuarjen e mendimit të lirë

Veprimtaria e administratës publike është e gjithanshme dhe paraqitet në forma të ndryshme. Nëpunësit publikë dhe organet e administratës publike kryejnë veprimtarinë e përditshme administrative, e cila përfshin që nga veprimet e thjeshta të karakterit teknik dhe deri në ato që kanë të bëjnë me sigurimin e funksionimit normal të veprimtarisë së saj.

E rëndësishme është të kuptohet se jo e gjithë veprimtaria që kryejnë organet e administratës dhe nëpunësit e saj publikë përmban në vetvete elementin juridik. Kjo do të thotë se jo çdo veprim i tyre sjell detyrimisht pasoja juridike dhe, për rrjedhojë, prodhon akte administrative. Shumë nga veprimet e administratës publike dhe e punonjësve të saj janë veprime të një karakteri material dhe të tjera janë me karakter teknik. Vetëm ajo veprimtari administrative që sjell lindje, ndryshim ose shuarje të pasojave juridike do të konsiderohet veprimtari juridike. Pra, këto veprime, nëse do të plotësohen dhe me ato elemente ose kërkesa të nevojshme që kërkon ligji nga pikëpamja formale, atëherë mund të konsiderohen si akte administrative.

¹⁰ Po aty, f. 104-105.

Elementin juridik të aktit administrativ e përcakton fakti, nëse ky akt *krijon ose shuan një marrëdhënie të caktuar juridike* nëpërmjet vendosjes së normave të detyrueshme të sjelljes për subjektet, të cilëve ai u drejtohet. Ky element juridik është shkak përcaktues për ardhjen e pasojave juridike, sepse vetë krijimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike nënkupton ardhjen e pasojës konkrete, pa të cilën nuk kuptohet lindja ose shuarja e kësaj marrëdhënieje. Prandaj ardhja e pasojave nuk është element më vete, por përfshihet brenda elementit të krijimit, ndryshimit ose shuarjes së marrëdhënieve juridike.¹¹ Kjo ndërthuret detyrimisht edhe me faktin se *vullneti i shprehur* nëpërmjet aktit, nuk mund të shfaqet nga kushdo, por vetëm nga një organ kompetent që ushtron veprimtari administrative dhe i njohur nga ligji si i tillë. Ekziston edhe një element i tretë që ka të bëjë me *karakterin nënligjor* të aktit administrativ, por që për arsye të rëndësisë që paraqet trajtohet në vazhdim të këtij kreu si një element më vete i aktit administrativ. Ekzistenca e këtyre elementeve shumë të rëndësishëm, jo vetëm përcakton karakterin juridik të aktit administrativ, por njëkohësisht i bën të dallueshme veprimet juridike të organit administrativ nga veprimet e thjeshta teknike ose materiale që kryhen si nga organi, ashtu dhe nga nëpunësit e tij.

Nëpërmjet veprimeve teknike ose materiale realizohen detyra, mbahen shënime për dukuritë e ndryshme, jepen të dhëna ose provohen fakte mbi këto të dhëna. Me veprimet materiale e teknike nuk shprehet autoriteti i organit administrativ. Karakteristikë e përgjithshme e tyre është se me to nuk krijohen efekte juridike dhe nuk caktohen detyrime në mënyrë të njëanshme. Në këto veprime të kryera rëndom nga nëpunësit e administratës publike mungon elementi i shprehjes së vullnetit shtetëror. Mungesa e vullnetit shtetëror në veprimet e mësipërme, nuk do të thotë se këto duhen konceptuar si veprime të pavullnetshme ose si veprime që kryhen mekanikisht nga nëpunësit publik

¹¹ Nëpërmjet këtij saktësimi synohet të sqarohet ndonjë keqkuptim që vjen nga ndonjë artikullshkrues polemizues lidhur me këtë çështje që i ndan si elemente më vete krijimin, ndryshimin ose shuarjen e pasojave juridike nga ardhja e pasojave juridike.

të administratës. Si në veprimet teknike, ku këta punonjës në mënyrë të vullnetshme aktivizojnë profesionalizmin e tyre, ashtu dhe në kryerjen e veprimeve materiale, që kuptohet janë më të thjeshta, atyre nuk u mungon ky element vullneti. Por është e kuptueshme se në të dyja këto lloje veprimesh, mungon elementi kryesor që përcakton aktin administrativ, pra elementi juridik, që do të thotë se nëpunësit e administratës nuk veprojnë si organ administrativ, me qëllim krijimin, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve të reja juridike.

Veprimet materiale, që për efekt të studimit nga shkenca e së drejtës administrative quhen të tilla, janë ato veprime të thjeshta për nga rëndësia, të cilat kryhen nga niveli më i ulët i punonjësve të administratës shtetërore, nëpërmjet të cilave sigurohen kushtet materiale për nëpunësit dhe vet organin e administratës. Të tilla mund të konsiderohen veprimet që kryhen nga sekretaret, daktilografistët, arkivistët, e deri te punonjësit e shërbimit.

Edhe veprimet teknike që në dallim nga ato materiale janë në një nivel më të lartë, gjithashtu, nuk deklarojnë vullnet juridik të organit administrativ, si dhe nuk janë akte administrative. Ato mund të shërbejnë në të ardhmen si bazë për nxjerrjen e akteve administrative, por do të jetë e nevojshme që për to të bëhet deklarimi i vullnetit shtetëror nga organi i caktuar. Është organi administrativ që do të vlerësojë mënyrën e krijimit, të ndryshimit a shuarjes së një pasoje ose të një gjendjeje juridike të caktuar. Në këto raste, akti administrativ nuk do të jetë veprimtaria teknike e kryer nga punonjësit e aparatit administrativ, por vullneti juridik i shfaqur mbi bazën e veprimeve teknike nga autoriteti kompetent. Ja një shembull: E gjithë puna përgatitore që ndiqet për hartimin (si p.sh. të një projektvendimi të Këshillit të Ministrave) shërben si bazë dhe është kushti i domosdoshëm për nxjerrjen në të ardhmen të aktit administrativ. Në vetvete ky projektvendim i hartuar ende nuk është akt administrativ. Që ai të konsiderohet akt administrativ

duhet patjetër shfaqja e vullnetit juridik të organit administrativ, në rastin konkret të Këshillit të Ministrave, që ky projektvendim të shndërrohet në vendim.

Gjithashtu, nuk janë akte administrative edhe veprimet e ndryshme teknike që kryejnë punonjësit e administratës për kontrollin e zbatimit të akteve. Në raste të tilla, këta punonjës, megjithëse gjatë kontrollit të tyre vërejnë të meta dhe shkelje të ndryshme brënda kuadrit të detyrave të tyre shtetërore, përsëri, masat që ata marrin me karakter organizativ për ndreqjen dhe mënjanimin e këtyre shkeljeve ose nxjerrja e përfundimeve për kontrollin e ushtruar, mbeten në kuadrin e veprimeve teknike dhe nuk përbëjnë akte administrative.

Masat ose veprimet që merr një organ i administratës publike për t'u konsideruar akt administrativ duhet të kenë si qëllim krijimin e pasojave ligjore. Kjo do të thotë se pasojat janë rezultat i drejtpërdrejtë i masave a veprimeve të marra. P.sh., miratimi ose refuzimi i dhënies së lejes së ndërtimit një subjekti juridik sjell pasoja ligjore të drejtpërdrejta dhe prandaj është akt administrativ. Një raport ose informacion i inspektorit ose specialistit, mbi të cilën bazohet një vendim i tillë, nuk është akt administrativ, sepse nuk krijon ndonjë pasojë të menjëhershme ligjore. Ai mbetet thjeshtë një veprim teknik që i shërben organit administrativ. Nga vetë funksionet që i janë ngarkuar organeve të administratës publike dhe nga larmia e detyrave që ato kanë, del e nevojshme kryerja e veprimeve me karakter teknik. Problemet e shumta që paraqiten në administratën publike nuk mund të zgjidhen të gjitha nëpërmjet nxjerrjes së akteve administrative. Prandaj, për këtë qëllim janë veprimet me karakter teknik ato që e plotësojnë këtë detyrë, si p.sh. përgatitja e studimeve, projekteve, dhënia e mendimeve, kryerja e kontrolleve për zbatimin e akteve administrative etj.

Në praktikën administrative veprimet teknike janë të larmishme. Ato mund të paraqiten si akte të evidentimit ose të dokumentacionit. Të tilla janë evidencat, regjistrat, kartoteka, protokollet, librat e ndryshëm, shkresat, vërtetimet, aktet e lajmërimit ose të njoftimit, si dhe çdo lloj dokumentacioni që evidenton një dukuri ose të dhënë zyrtare. Këto dokumente ose siç përdoret shpesh termi “akt zyrtar”¹² nuk janë akte administrative. Ato janë dokumente publike që evidentojnë një të dhënë ose dukuri, të cilat përbëjnë, sipas legjislacionit procedural, provë të plotë dhe kanë fuqi provuese, derisa të vërtetohet e kundërta. Këto dokumente mund të jenë pjesë përbërëse e aktit administrativ, vetëm kur organi nxjerr një akt duke u orinetuar nga të dhënat që ato evidentojnë. Dhe në këtë kuptim ato i vlejnë organit, për të argumentuar se akti që ato kanë nxjerr është i arsyetuar.

Veprimet teknike, ndërsa dallohen nga aktet administrative, sepse ato nuk janë shfaqje e ndonjë vullneti juridik dhe, për rrjedhojë, nuk krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë pasoja juridike, ato dallohen nga veprimet materiale nga fakti se për kryerjen e tyre kërkohet përgatitje e posaçme, aftësi profesionale të një niveli të lartë. Edhe në raport me aktet administrative, veprimet materiale e teknike varen nga vendi që zë çdo organ i administratës publike. Në këtë aspekt, kuptohet se sa më i lartë të jetë organi në sistemin e përgjithshëm të organizimit shtetëror, aq më shumë shfaqet veprimtaria e tij në formën e nxjerrjes së akteve administrative.

¹² Këtë terminologji përdor edhe Kodi i Procedurës Civile i vitit 1996, në nenin 253.

KAPITULLI I TRETË

3. Pavarësia e RMV-së

Pas shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë, Maqedonia si njëri ndër suksesorët e sajë, pos disa favoreve, suksedoi edhe një mori vështirësish dhe problemesh, që fill pas shpalljes së pavarësisë u bënë pengesa serioze në zhvillimin e mëtutjeshëm të sajë. Ndër pengesat më serioze me të cilat pas shpalljes së pavarësisë u ballafaqua Maqedonia ishte padyshim edhe trashëgimia e rëndë sociale, ekonomike e sidomos statusi i pazgjidhur politiko-juridik i shqiptarëve që la pas vetes ish RSF e Jugosllavisë. I cilësuar si „fuçi baroti“, i tërë Ballkani, pra edhe Maqedonia si pjesë e tij, nuk treguan gatishmëri dhe vullnet për zgjidhjen e çështjeve kombëtare dhe etnike me mjete paqësore dhe demokratike. Maqedonia si bartëse e epitetit „mollë sherri“, që e „fitoi“ fill pas viteve 1912 - 1913, pra, pas luftave ballkanike, në ish bashkësinë e RSF të Jugosllavisë, ia doli që të fitojë statusin e Republikës, duke e ngritur çështjen kombëtare Maqedone deri në nivel të zgjidhjes. Mirëpo, vështirësitë që u grumbulluan në fushën politike, sociale dhe etnike, veçmas keqësimi i vazhdueshëm i pozitës politiko-juridike i shqiptarëve në Maqedoni, e rritën numrin e çështjeve të pazgjidhura, të cilat pa tjetër, u bartën edhe në dhjetëvjeçarin e parë të ekzistimit të Maqedonisë si shtet sovran dhe i pa varur. Pozita diskriminuese e shqiptarëve në të gjitha sferat e jetës shoqërore-politike, në fakt, gjatë vitit 2001 solli deri në konfliktin e armatosur që shpërtheu në territorin e Maqedonisë dhe i cili, fal intervenimit të fuqive të mëdha, veçmas të SHBA-ve dhe BE-së, përfundoi me firmosjen e Marrëveshjes së Ohrit me çka nisi faza e konsolidimit të plotë të Maqedonisë si shtet demokratik me perspektivë të qartë të integritetit të sajë në NATO dhe në BE. U deshtë pra të kaloj një shekull nga ditët kur vetëdija kombëtare e popullit të Maqedonisë u ndez, e deri në ditën kur, përmes një referendumi, të mbajtur më 8 Shtator të vitit 1991., të shpallet shteti i pavarur - Republika e Maqedonisë. Shtetin i ri - Republika e

Maqedonisë, së shpejti, u shfaq në skenën politike ndërkombëtare si subjekti i ri, politik, ekonomik dhe juridik, ndërkombëtar, i barabartë me të gjitha shtetet deri atëherë ekzistuese të botës. Elementet e para të shtetësisë Maqedonia i ka fituar gjatë Lëvizjes Popullore Çlirimtare, e cila filloi gjatë viti 1941, si organizim në nivel lokal dhe rajonal, në të ashtuquajturat Komitete nacionalçlirimtare. Këto Komitete nacionalçlirimtare, kanë qenë të organizuar nga Partia Komuniste në të gjithë territorin e ish-Mbretërisë së Jugosllavisë, e cila më 6 Prill të vitit 1941., kapitulloi para Rajhut të Tret Gjerman dhe kanë qenë aktiv gjatë vitit 1942 deri në 1944. me emrat si psh, Komiteti për të ndihmuar popullin, Fronti Kombëtar, Komitete lokale popullore dhe Komitete rajonale popullore, etj¹³ Gjatë këtij zhvillimi janë paraqitur vështirësi të mëdha në drejtimin e përcaktimit dhe definimit të formës dhe përmbajtjes së "pushtetit popullor" dhe "vetëqeverisjes", e cila është reflektuar në ndryshimet relativisht të shpeshta në strukturën kushtetuese dhe politike të vendit. Faza e parë, që mbulon periudhën nga viti 1942., (domethënë, nga seanca e parë e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë, KANÇJ, 26 dhe 27 nëntor 1942.) deri në vitin 1946. (kur Jugosllavia Demokratike Federative u shëndrua në Republika Federale Popullore të Jugosllavisë, dhe u miratua kushtetuta e parë), karakterizohet nga përpjekjet për konstituimin, zhvillimin dhe njohjen ndërkombëtare të Jugosllavisë së re - Jugosllavisë Demokratike Federale, kurse Republika Popullore e Maqedonisë, si njësi federale e shtetit të përbashkët, miratoi kushtetutën e saj të parë në 31 Dhjetor të vitit 1946.¹⁴

¹³ Kalimovski S., V. Patel, R. Treneska, T.Karakamiševa, Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija, Shkup, 2003., f. 21

¹⁴ Aktet legislative dhe traktatet ndërkombëtare që janë të marrë nga Jugosllavia, shih te : T. Džunov, Sukcesijata na državite, državjanstvoto i noviot praven poredok na Republika Macedonia, Godišnik PF Shkup, 1992 -1993.

3.1 Problemet e trashëguara nga ish-RSFJ

Procesi i shthurjes së Jugosllavisë socialiste u përshkrua me “orekse” për territore nga popujt më të fuqishëm brenda kësaj federate. Serbët shfaqën “orekset” territoriale për Kroacinë, Bosnje-Hercegovinën dhe Kosovën. Ndërsa, maqedonasit *nuk kishin potencial ushtarak për të plotësuar “orekset”, por ata përpiqeshin të krijojnë shtetin e tyre nacional edhe në hapësirat e banuara me shumicë shqiptare. Në vitet 90-të shekullit XX, Evropën Lindore dhe Juglindore e kaploi kriza më e thellë pas Luftës së Dytë Botërore. Ra sistemi komunist e me këtë edhe Pakti i Varshavës, si mekanizëm që mbante me forcë aleancën politike dhe ushtarake në mes Evropës Lindore dhe BRSS. Ndryshimet e mëdha politiko-shoqërore në vendet e Evropës Lindore u reflektuan edhe në Jugosllavi, në të cilën krahas reformave në sistem, ndodhi edhe shthurja e shtetit. Çështja shqiptare asnjëherë nuk ishte shtruar për t’u zgjidhur, si problem i veçantë në Jugosllavinë socialiste. Ndryshimet “kozmetike” që kishin ndodhur kohë pas kohe, përfshinin vetëm Kosovën. Hapësirat e banuara me shqiptarë, në ish Jugosllavi, ishin ndarë në katër njësi administrative, Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoni. Propaganda jugosllave, zhurmshëm, afirmonte idenë e barazisë nacionale dhe të vëllazërim-bashkimit, edhe për kundër faktit se shqiptarët si popull as për së afërmi nuk gëzonin të drejtat e shpallura kombëtare, edhe pse sipas numrit të përgjithshëm përbënin popullin e tretë, pas serbëve dhe kroatëve. Rrënia e sistemit komunist dhe shthurja e Jugosllavisë, u përshëndet pothuajse nga të gjithë shqiptarët e atij shteti si një “e keqe” që duhej flakur. Ishte ky një moment i shumëpritur për çlirimin nacional nga shtypjet aventuriere të aparateve shtetërore sllave: serbe, malaziase dhe maqedonase.¹⁵

¹⁵ Llambro Filo, Historia për Sistemet e Qeverisjes, Extra, Tiranë, 2004, f.323.

Në këtë proces, Maqedonia ishte një problem në vete. Në kuadër të Jugosllavisë, në Maqedoni ishte eksperimentuar politika diskriminuese serbe kundër shqiptarëve, e cila do të gjente zbatim edhe në hapësirat e tjera shqiptare. Vështruar nga aspekti historik, në sikurse shqiptarët edhe maqedonasit, ishin të shtypur njësoj nga pushtues të huaj, si edhe nga vetë politika serbe, gjatë kohës së Mbretërisë së Jugosllavisë. Ndërkaq, gjatë luftërave për çlirim nacional, maqedonasit qenë ndihmuar nga shqiptarët (në kohën e kryengritjes së Ilindenit dhe Republikës së Krushevs). Gjatë Luftës së Dytë Botërore sllavo-komunistët u përpoqën që përmes frymës së luftës së përbashkët antifashiste dhe “vëllazërim-bashkimit”, të përçajnë popullatën shqiptare, duke iu kundërvënë kështu përpjekjeve për çlirimin nacional të shqiptarëve. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe më vonë, politika sllavo-komuniste shumë shpejt u demaskua përmes diskriminimit të shqiptarëve në të gjitha sferat e jetës. Marrëdhëniet u ashpërsuan, sidomos pas ngjarjeve revolucionare të pranverës së vitit 1981, në Kosovë dhe në hapsirat tjera shqiptare.¹⁶Gjatë kësaj periudhe politika maqedonase hidhte vallen e njëjtë me politikën nacistë serbe. Maqedonia dhe strukturat e saj politike paraprinin në proceset e diferencimit ndaj shqiptarëve. Në Maqedoni zhvilloheshin format eksperimentale të politikës antishqiptare, ku diskriminimi i shqiptarëve mund të vërehej në çdo fushë të zhvillimit të shoqërisë. Rruga e vetme e mbijetesës, për shqiptarët e Maqedonisë ishte kurbeti. Diferencimet ideo-politike të atyre pak shqiptarëve të arsimuar zhvilloheshin në përmasa shqetësuese. Të gjithë këta procese antishqiptare zhvilloheshin nga një strukturë politike e quajtur-Partia Komuniste Jugosllave, nën zhurmën e fuqishme të propagandës së “vëllazërim-bashkimit” të popujve.¹⁷

¹⁶ Llambro Filo, Historia për Sistemet e Qeverisjes, Extra, Tiranë, 2004, f.323.

¹⁷ Faton Mehmetaj, Veprimtaria kriminale e “Dorës së zezë” serbe në trojet shqiptare, Anatema, Prishtinë, 2004, f. 365

Maqedonia,¹⁸ në prag të shpalljes së pavarësisë, ndeshej me dy probleme: problemi i parë ishte raporti i jashtëm ndaj republikave të tjera të Jugosllavisë dhe shteteve fqinje, Bullgarisë dhe Greqisë dhe i dyti ishte problemi i brendshëm, raportet ndëretnike në mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Për problemin e brendshëm zyrtarët maqedonas vinin në pah parimet evropiane, ndërsa në praktikë zbatonin mënyrat ballkanike të zgjidhjes së problemit. Në Maqedoni zhvillohej luftë permanente në mes dy koncepteve politike për shtetin : konceptit unitarist-etnocentrik, i ngjashëm me atë serb dhe atij multi-etnik. Konceptin e parë e përfaqësonin strukturat politike maqedonase të ish-Lidhjes Komuniste të kryesuar nga Gligorovi, ndërsa të dytin e përfaqësonin subjektet politike shqiptare, por pa ndonjë ofertë konkrete të koordinuar dhe të qartë.¹⁹

Në hapësirën gjeografike të Maqedonisë gati gjysma e popullatës është jo-sllave dhe jo-maqedonase, ndër të cilët bindshëm numerikisht shumicë janë shqiptarët. Në fakt, Maqedonia, për nga përbërja nacionale është një “mini Jugosllavi” multi-etnike. Por, edhe përkundër këtij fakti, struktura politike maqedonase përpiquej që përmes proceseve të reja pluraliste, që lindën në vitin 1990, të ndërtojë konceptin e shtetit nacional sipas parimit serb, >>një njeri - një votë<<. Protagonistët kryesorë të këtij koncepti të shtetit ishin grumbulluar rreth platformës së ish-Lidhjes Komuniste, të reformuar nën emrin e ri, Lidhja Komuniste – Partia për Transformim Demokratik dhe udhëhiqeshin nga Presidenti Kiro Gligorov. Ideologët e këtij koncepti në vazhdimësi injoruan të drejtat kombëtare të shqiptarëve dhe kështu artificialisht krijuan antagonizma politike dhe ndëretnike. Koncepti i tillë i shtetit unitarist dhe etnocentrik mbolli farën e kundërthënive ndëretnike dhe shpërthimin e konfliktit shqiptaro-maqedonas.²⁰

¹⁸ Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel*, Westview, 2002, USA, f. 56

¹⁹ Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel*, Westview, 2002, USA, f. 56

²⁰ Faton Mehmetaj, *Veprimtaria kriminale e “Dorës së zezë” serbe në trojet shqiptare*, Anatema, Prishtinë, 2004, f. 365

Dalja në skenë e pluralizmit politik imponoi nevojën e transformimit të ish- Lidhjes komuniste, e cila në IRJM ndërtoi doktrinën politike që mbështetej mbi konceptin e “Oazës së paqes” dhe të “bashkëjetesës” (Sozhitelstvo)* në shtetin e posaformuar. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ofrohej si model në gjithë botën për zgjidhjen e çështjeve ndëretnike.

Në të vërtetë, praktika dëshmoi se refrenet e këtilla fshihnin në vete regjimin e egër, policor dhe nacionalist maqedonas. Makineria propagandistike që ishte në shërbim të nacionalizmit “gligorovian”, arriti të përcjellë në arenën ndërkombëtare të “vërtetën” e njëanëshme, duke lënë nën hije çështjen shqiptare, me retorikën e bukur të “bashkëjetesës”, në Maqedoni.

Se sa radikale ishte politika nacionaliste dhe etnocentrike e Gligorovit, mund të vërtetohet edhe nga fakti se, në momentin kur Bashkësia ndërkombëtare ishte e përqëndruar tek luftërat në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, atëherë , nën maskën e “oazës së paqes”, në Maqedoni përgatiteshin kurthe sipas nevojës momentale të politikës ditore, për të krijuar imazhin negativ ndaj shqiptarëve si kriminelë, klandestinë, destabilizues të rajonit apo fundamentalistë islamikë. Pra, kjo politikë antishqiptare ishte në funksion të krijimit të imazhit të keq për shqiptarët në tërësi dhe në veçanti për shqiptarët etnik të Maqedonisë.²¹

Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, më 17 Nëntor 1991, mënyra tradicionale e mospërfilljes së skajshme të kërkesave të shqiptarëve, kundërthëniet ndëretnike, sjelljet brutale të organeve policore, diskriminimi në arsimim, kulturë, art, punësim, etj. pak nga pak i keqësoi edhe më tepër marrëdhëniet edhe ashtu të tensionuara ndëretnike duke prodhuar konfliktin e armatosur, të vitit 2001. Procesi i krijimit të një Republike të pavarur të Maqedonisë është paralel me të gjitha proceset globale të shpërbërjes së ish-Evropës Lindore sistemet e partive, përfshirë

²¹ Faton Mehmetaj, Veprimtaria kriminale e “Dorës së zezë” serbe në trojet shqiptare, Anatema, Prishtinë, 2004, f. 365

ish-Jugosllavinë e SFR-së, dhe promovimin e politikave pluralizmi dhe demokracia si përbërës themelorë të shoqërive moderne. Pavarësia e Maqedonisë u krijua me referendumin e 8 shtatorit 1991. Pas kësaj periudhe të konsolidimit të brendshëm dhe njohjes ndërkombëtare ndjekur. Nismat diplomatike rezultuan në anëtarësimin e Republikës Maqedonia (zgjidhni referencën e përkohshme të ish-Republikës Jugosllave të Maqedoni) në Kombet e Bashkuara. Në periudhën pasuese, si rezultat i ndërhyrjes më të gjerë ndërkombëtare në ish-Jugosllavi dhe bllokada nga Greqia, Maqedonia ishte e lodhur situatë e vështirë dhe komplekse. Si rezultat i të ashtuquajturit Issështja e Emrit, Greqia imponoi embargo dhe bllokada e tregtisë së brendshme për integrim të mëtejshëm në ndërkombëtarët e tjerë organizatat dhe nismat. Situata e status quo-së ndryshoi me Interim marrëveshje, pas së cilës periudha e stabilizimit dhe vendosjes së marrëdhënieve me SH.B.A. Dhe shumica e vendeve të BE-së kanë ndjekur. Nga përvojat e shteteve në tranzicion, por edhe nga përvojat me të cilat u ballafaqua Republika e Maqedonisë, në katërmëdhjetë vitet e fundit u dëshmuua fakti se për stabilitetin e shtetit dhe për sigurinë e tij nuk janë vendimtare forcat represive, ushtria e fortë dhe policia, por për ndikimin për krijimin e një shoqërie stabile me një siguri të qëndrueshme janë disa parametra të tjerë, si: ngritja e nivelit të demokracisë, respektimi i të drejtave të njeriut, kultivimi i raporteve të mira ndëretnike, mirëqenia ekonomike dhe sociale etj. Veprimet e politikanëve që janë të prirë të nxisin procese pozitive, duke iu përkushtuar paraqitjeve publike që mund të jenë ndikuese, krijojnë hapësirë për implementimin e konstelacionit të ri të forcave politike për koalicione të afrimit dhe afirmimit të qëndrimeve që i afrojnë njerëzit.²² Potenciali politik kadrovik që e kanë shqiptarët dhe maqedonasit në Republikën e Maqedonisë duhet të jetë në shërbim të afrimit të pozicioneve të interesit shtetëror për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE. Në RM, nga strukturat politike të pushtetit dhe ato opozitare, duhet të krijohen kushte reale për harmonizimin e aktiviteteve politike, për

²² John R. Lampe, Yugoslavia as History, Cambridge University Press, 1996, f.345

krijimin e besimit të ndërsjellë ndëretnik dhe në të gjitha aktivitete integruese brenda shtetit, ato dallime të shndërrohen në luftë politike, duke e avancuar formën e dialogut të mirëfilltë për ruajtjen e vlerave të interesit të përbashkët që maqedonasit dhe shqiptarët e Maqedonisë e kanë në shtetin e përbashkët në Republikën e Maqedonisë. Fundi i viteve 80-ta në Ish- Jugosllavi, karakterizohet me specifika të shumta në rrafshin e politikës shtetërore, pasi tani jo vetëm shqiptarët kërkonin që të bëhet një riorganizim politik i Federatës. Ngjitja në pushtet e Slllobodan Millosheviçit, nga viti 1986-87, shënoi edhe ngritjen e tensioneve ndëretnike në gjithë Federatën Jugosllave, duke filluar nga sllovenët, kroatët, boshnjakët, për të vazhduar deri te maqedonasit, me theks të veçantë shqiptarët. Shteti i përbashkët, që ishte ndërtuar dekada me radhë, në krye të të cilit qëndronte figura e pakontestueshme nga jugosllavët, Josip Broz Tito, vetëm për disa muaj, pushteti po rrëshqiste në duart e një anonimi në politikën jugosllave, Slllobodan Millosheviçi, një bankier në moshë të mesme dhe me karakter të një agresivi në raport me gjithë stafin e lartë të federatës jugosllave. Ai krijoi një regjim autoritar dhe nuk mbante llogari, as para institucioneve, as para elektoratit²³. Ky politikan filloi të rrënojë gjithë atë që kishte ndërtuar Titoja dhe stafi i tij, duke nisur nga reputacioni në sferën ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet ndëretnike, që ishin shumë të rëndësishme, për të mbajtur një ekuilibër në mes bashkësive etnike që jetonin në federatë.²³ Krijesa artificiale e quajtur Jugosllavi, vetëm se kishte filluar të kalbet nga brenda. Ndër popujt, që nuk ishin të kënaqur me rendin kushtetues të saj dhe me agresionin shovinist serb, ishin sllovenët, kroatët dhe shqiptarët. Për dallim nga të tjerët, shqiptarët ishin të vetmit që morën guximin të sfidojnë një federatë të fuqishme politike dhe ushtarake, që ishte ndërtuar me dekada. Arsytet ishin të shumta. Vetëm se kaluan vite që pushteti serb dhe ai jugosllav, në tërësi nën dirigjimin e Millosheviçit, po ushtronin dhunë të vazhdueshme mbi popullatën shqiptare në gjithë Jugosllavinë. Më 1 shkurt 1990, në qendër të Tetovës do të

²³ John R. Lampe, Yugoslavia as History, Cambridge University Press, 1996, f.345

organizohet një demonstratë e shqiptarëve kundër diskriminimit shtetërorë ndaj tyre. Gazeta e përditshme maqedonase, zëdhënëse e pushtetit maqedonas, raporton për këtë veprim të shqiptarëve duke filluar artikullin që nga titulli tendencioz “Provokime të reja të nacionalistëve shqiptarë - Demonstrata separatiste në Tetovë”. Sipas autoriteteve maqedonase, në protestë kanë marrë pjesë rreth 300 vetë, ndërsa sipas organizatorëve, thuhet se kanë qenë të paktën 2000 demonstrues.²⁴ Sigurisht që ky guxim i shqiptarëve në Maqedoni ishte shqetësues për strukturat e shtetit. Forcat e rendit reagues në mënyrë shumë energjike dhe për gjysmë ore shpërndanë demonstruesit nga sheshi i qytetit, duke rrahur dhe arrestuar shumë të rinj. Pavarësisht nga ky intervenim i milicisë maqedonase, ata sërish u rigrupuan në qendër dhe disa rrugë afër qendrës, por edhe afër tregut të qytetit. Ishin shkruar shumë parulla, si: “Liri”, “Demokraci”, “Kosova Republikë” etj. Jovan Tërpenovski, sekretar i Sekretariatit për Punë të Brendshme të Maqedonisë do të deklarojë se nga të arrestuarit ka edhe nga Kosova, i cili dëshironte ta ndërlihtë situatën me trazirat atje dhe se prokuroria dhe gjykatat do të kryejnë punën e tyre²⁵ Peshën që patën këto demonstrata, mund të vërejmë edhe nga mbledhja urgjente që mbajti Këshilli Ekzekutiv i RS të Maqedonisë, po të njëjtën ditën, i cili organ debatoi për gjendjen e krijuar dhe obligoi të gjitha strukturat lokale dhe shtetërore që t’i ndërmarrin masat e duhura kundër këtyre veprimeve. Pavarësisht nga shpërndarja e demonstruesve më 1 shkurt dhe arrestimin e disa prej tyre nga disa vendbanime, si: Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ferizaj etj., sërish ditën e nesërme, nëpër qytet vëreheshin parulla që kishin vendosur pjesëtar të lëvizjes ilegale shqiptare, që tregonte vendosmëri para organeve të shtetit, ndërsa shqetësim për sistemin e sigurisë në Maqedoni, pasi nuk kishin fuqi të shuajnë.

²⁴ John Philips, Macedonia, warlords & rebels in the Balkans, Yale University Press & New Haven and London, 2004, f.64. ; Ismail Vlasi, Një nga organizatorët e demonstratës 1 shkurt 1990, intervistuar më 25 dhjetor 2011.

²⁵ Gazeta “Nova Makedonija”, Demonstrata Separatiste në Tetovë, 2 shkurt 1990.

Çështja demografike në Maqedoni, çdoherë ka qenë top prioritet i politikave shtetërore, si gjatë periudhës së komunizmit, ashtu edhe pas vitit 1990, e cila vazhdon të trajtohet nga institucionet shtetërore me shumë kujdes. Është për t'u habitur se deri tani asnjë studiuës i politikave të Maqedonisë dhe ishJugosllavisë në përgjithësi, nuk e ka vënë theksin te përpjekjet e maqedonasve, gjatë dekadave të fundit, për të ndryshuar strukturën e popullsisë në vend. Nëse i kthehemi gjenezës së problemit, do të vërejmë se ky shqetësim i autoriteteve maqedonase daton që nga Lufta e Dytë Botërore kur Tito në Jajce (29 nëntor 1943) të Bosnjës në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist të Luftës Nacional Çlirimtare, Maqedoninë e avancoi në statusin e njësisë së barabartë federative. Menjëherë pas përfundimit të LDB-së, udhëheqësit komunist të Maqedonisë në koordinim me udhëheqësit më të lartë të Federatës, përfshirë edhe Titon, hartuan planin për të shpërngulur shqiptarët nga trojet e tyre. D.t.th. numri i madh i popullatës shqiptare në Maqedoni dhe nataliteti i lartë i tyre paraqiste rrezik të drejtpërdrejtë për maqedonasit, pasi që ata për një periudhë të shkurtë kohore kishin mundësi ta marrin shtetin (Republikën). Në një artikull në gazetën ditore në gjuhën shqipe në Shkup, qartë mund të shohim se i gjithë aparati shtetëror është angazhuar për të shtypur në çdo formë shqiptarët, me qëllim që ata të mos kenë mundësi të rrisin numrin e tyre të popullatës. “Edhe më tej vazhdojnë shpërnguljet nga Kosova në republikën tonë, ... Lëvizje të tilla janë vërejtur edhe brenda republikës, prej një komune në tjetrën, siç është rasti me komunën e Titov- Velesit dhe me atë të Manastirit (Bitolës), në të cilat vazhdimisht po shtohet numri i shqiptarëve, të cilët blejnë tokë nga familjet maqedonase me çmime jashtëzakonisht të larta ... Aktivitetet dhe masat e ndërmarra deri më tani nuk dhanë rezultate të duhura as në drejtim të pengimit të formimit të mjediseve etnike të pastra ... as për zvogëlimin e lindshmërisë.

3.2 Laramania e partive politike

Përfaqësimi politik d.m.th. qeverisje e popullit nëpërmjet përfaqësuesve, ndërsa jo direkt, qeverisje në emër të popullit dhe për popullin, por jo të vetë popullit. Përfaqësuesi zgjedhor e paraqet shoqërinë në tërësi, e jo ato të cilët e kanë zgjedhur. Ai është i lirë për vendimin dhe i përgjegjës. Përfaqësimi politik është formë e përcjelljes së pushtetit nga shumica e përfaqësuesve zgjedhor – nëpërmjet zgjedhjeve të lira në të cilat garojnë partitë politike. Pluralizmi politik në shek. XVII dhe XIX dhe zgjedhjet e lira dhe të sinqerta e ofrojnë të njëjtën. Me krijimin e shteteve të mëdha nacionale në të cilat nuk mund të qeveriset nëpërmjet formave të demokracisë direkte, përfaqësimi bëhet domosdoshmëri. Xhon Stjuart Mil është mbrojtës i demokracisë përfaqësuese. Cështja e tij themelore është si të sigurohet qeveria efikase dhe respektimi i të drejtave dhe lirive personale. Zgjedhja gjendet në zgjedhjet e përgjithshme dhe në shtypin e lirë. Nën ndikimin e teorisë liberale, përfaqësimi demokratik llogaritet për “ formë më të mirë të qeverisjes”. Ajo bazohet në tri shtylla : a) përfaqësimi; b) zgjedhjet e lira; c) të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarëve. Megjithatë, në kushte të përfaqësimit demokratik, politika gjithnjë e më pak është res publike (punë publike), ndërsa gjithnjë e më shumë veprimtari e rezervuar për elitat partiake. Pas shpërndarjes së Republikës së Maqedonisë nga ish RSFJ-ja, Maqedonia hyri në procesin e tranzicionit me çka shteti i posalindur autonom filloi një proces të ri e të pavarur të funksionimit. Në fillim Maqedonia konsiderohej si shtet unitar, i cili jo vetëm se ishte larg multietnicitetit, por kryesisht favorizonte popullin maqedonas si popull shumicë në Maqedoni, ndërsa të gjithë minoritetet përfshirë edhe popullin shqiptarë në Maqedoni i konsideronte si popull pakicë.

Që në fillet e funksionimit të Maqedonisë si shtet i pavarur, qeveria e RM-së dhe e gjithë hierarkia shtetërore instaloi diskriminimin dhe dhunën ndaj popullit shqiptar. Edhe përpos faktit që shqiptarët në këtë shtet të posalindur mbanin një optimizëm të rezervuar por prap se prap ky optimizëm tek shqiptarët transformohej si një barometër që kishte rënie-ngritje e cila do të dëshmohej më vonë. Së paku ardhja e pluralizmit politik në Maqedoni, shqiptarët i nxori në proces për të ndërmarë armët politike dhe pa hezituat të hapin shtigje në shtrirjen e misionit kombëtar.²⁶ Megjithatë, pluralizmi politik në Maqedoni, në vend që të sjell një demokraci me standarde përëndimore, ajo solli një demokraci të cunguar me elemente diskriminuese dhe si target diskriminimi ishte etniteti i dytë më i madh në Maqedoni, përkatësisht populli shqiptar.

Shqiptarët në fillim dolën me një kapacitet politik të unifikuar dhe mjaftë relevante, por këtij unifikimi politik i parapriu aparati shtetëror, duke vënë në disponim të gjitha mekanizmat për ta sforcuar në masë të madhe subjektin politik asokohe, pra PPD-në e cila tek shqiptarët në Maqedoni konsiderohej edhe si lëvizje popullore.

Me pavarësimin e Maqedonisë, statusi juridiko-politik i shqiptarëve në Maqedoni, u bë diskriminues fillimisht në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Maqedonisë, madje edhe në aspektin politik diskriminimi ndaj shqiptarëve hapi një kapitull të ri. Statusi juridik i shqiptarëve me kushtetutën e vitit 1991 ka qenë diskriminues fillimisht në aspektin gjuhësor, madje edhe në të gjitha format tjera. Shqiptarët në fillim dolën me një kapacitet politik të unifikuar dhe mjaftë relevante, por këtij unifikimi politik i parapriu aparati shtetëror, duke vënë në disponim të gjitha mekanizmat për ta sforcuar në masë të madhe subjektin politik asokohe, pra PPD-në e cila tek shqiptarët në Maqedoni konsiderohej edhe si lëvizje popullore. Me pavarësimin e Maqedonisë, statusi juridiko-politik i shqiptarëve në Maqedoni, u bë diskriminues fillimisht në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së

²⁶ Nevzat Dervishi, Procesi I shpëtimit kombëtar, Tetovë, 2005, fq.6

Maqedonisë, madje edhe në aspektin politik diskriminimi ndaj shqiptarëve hapi një kapitull të ri. Statusi juridik i shqiptarëve me kushtetutën e vitit 1991 ka qenë diskriminues fillimisht në aspektin gjuhësor, madje edhe në të gjitha format tjera. Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetëadministrimit lokal, në të cilat si shumicë jetojnë pjestarët e kombësive në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive në mënyrë të përcaktuar me ligj.²⁷

Duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës, shohim se pozita juridike e shqiptarëve në raport me atë të maqedonasve është në nivel më të ulët dhe i vënë në një pozitë të barabartë me bashkësitë tjera etnike që numerikisht janë pakicë në Republikën e Maqedonisë. Statusi politiko-juridik i shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë në fundshekullin e kaluar ka qenë diskriminues edhe në rafshin e simbolit kombëtar (Flamurit), në rafshin arsimor, kulturor, ekonomik, social dhe kështu me radhë. Edhe pse me aktin më të lartë formalo-juridik garantohen të drejtat politike për të gjithë qytetarët, megjithatë në praktikë ndryshon situata. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991 e përfshin një numër të konsiderueshëm të të drejtave politike dhe qytetare, ndërsa sundimi i ligjit dhe shtetit ligjor përcaktohen si parime themelore të sistemit të pushtetit.²⁸ Do të thotë se ajo që është e shkruar me kushtetutë nuk korrespondon në praktikë. Në këtë rafsh, shqiptarët gjithnjë janë konsideruar në praktikë si qytetarë të dorës së dytë. Statusi politik i shqiptarëve që me konstituimin e Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur u la anash nga politikat nacionaliste maqedonase të trashëguara nga ish-sistemi komunist. Si reagim ndaj anashkalimit të të drejtave thelbësore të shqiptarëve të Maqedonisë erdhi nga partitë politike shqiptare të sapo themeluara.²⁹ Përfaqësuesit e partive politike shqiptare qartë bënin të ditur se partitë shqiptare janë të përcaktuara për Maqedoni sovranë dhe të pavarur,

²⁷ Shih paragrafin 1 dhe 2 të nenit 7 të Kushtetutës së vitit 1991 të RM-së

²⁸ Jonuz Abdullahi, Politika dhe politikat publike, Tetovë, 2010, 144

²⁹ Etem Aziri, Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2012, 137

megjithatë ata mendonin se paraprakisht duhej të zgjidhej çështja e arsimit në gjuhën shqipe dhe shumë çështje të tjera dhe ç'është më e rëndësishmja, ata angazhoheshin të dihet shkurt se cili do të jetë statusi i tyre në Maqedoninë e ardhshme të pavarur dhe sovranë, a do të jenë edhe ata bartës të sovranitetit, gjegjësisht a do të jenë përbërës i saj ose jo. Nga kjo nënkuptohet se shqiptarët janë anashkaluar në të gjitha segmentet dhe se papërfillshmëria e tyre ka qenë e theksuar që nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë e deri më sot.

Akumulimi i diskriminimit kur arriti kulminacionin, u imponua që të drejtat e shqiptarëve të zgjidhen me një konflikt të armatosur, gjë që ndodhi në vitin 2001. Konflikti në Maqedoni, duke mos u nisur si konflikt luftarak territorial, u imponua thjesht si forcë luftarake për ndryshim të Kushtetutës së vitit 1991, e cila e gjeneroi pakënaqësinë politike, gjegjësisht konfliktin politik shqiptaro-maqedonas.³⁰ Domethënë padrejtësitë e vazhdueshme ndaj statusit politiko-juridik të shqiptarëve erdhën deri te një konflikt i armatosur që kishin për qëllim zgjidhjen e problemit shqiptar njëherë e përgjithmonë në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë se sa u arit që të zgjidhen të drejtat politiko-juridike të shqiptarëve në Maqedoni do të flasim në vijim, respektivisht në nëntitujt e mëposhtëm. Demokracia bashkëkohore bazohet në forma të ndryshme të organizimit të qytetarëve. Kuptohet, në formimin e tyre qytetarët udhëhiqen nga interesat konkrete politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera. Duke u lidhur, ato realizojnë ndikim të madh. Pluralizmi i interesave natyrisht kërkon pluralizëm politik, pra shumësi të pyetjeve nga interesi publik. Aleksis de Tokvil do të vërente në “Demokracia në Amerikë” (1835) “e drejtë më natyrore e njeriut, përveç të drejtës të veprojë në interes të vetin është e drejtë t'i lidhin interesat e veta me interesat e më të afërmëve dhe të veprojnë me to”. Për atë “e drejta e shoqërimit është e drejtë e patjetërsueshme si edhe e drejtë e lirisë personale”. Baza kushtetuese e pluralizmit politik janë të drejtat dhe liritë politike, e veçanërisht liria e të folurit dhe liria e

³⁰ Zemri Elezi, E drejta kushtetuese, Tetovë, 2007, 183

shoqërimit politik. Pluralizmi politik është pjesë e pluralizimit shoqëror. Ai realizohet nëpërmjet formave të ndryshme : partive politike, grupeve të interesave, shoqërimi i qytetarëve, lëvizja politike. Ato janë lidhje, medijatorë, ura në mes të qytetarëve si individë dhe pushtetit. Qytetarët shoqërohen në parti politike që të marrin pjesë në luftën për pushtet, ndërsa në grupe dhe shoqata të interesave që të ndikojnë dhe i kontrollohen bartësit e pushtetit. Ka dy shekuj, që partitë politike janë instrument i pazavendësueshëm i përfaqësimit demokratik. Pa to demokracia dhe pluralizmi politik janë vetëm kategori teorike dhe ideologjike. Etimologjikisht, fjala parti rrjedh nga fjala latine pars – pjesë e një tërësie dhe folja partire që d.m.th. ndarje ose mbajtje e anës së caktuar. Bëhet fjalë për grup që formohet me ndarjen nga grupi tjetër ose tërësi e cila mban anën e vet, për shkak të së cilës është në konflikt me grupin tjetër. Partitë politike formohen me paraqitjen e përfaqësisë demokratike gjatë shekullit XVIII, e veçanërisht me zgjerimin e të drejtës zgjedhore në shek. XIX. Shkaku? Nevoja për ndërmjetësues në mes të zgjedhësve dhe instituteve përfaqësuese. Për Maks Veber “ partitë janë fëmijë të demokracisë dhe të drejtës së përgjithshme zgjedhore”. Partia politike është organizim i përhershëm politik i mendimtarëve me ide të njëjta të cilët në mënyrë demokratike luftojnë për pushtet ose , për ndikim në pushtet. Elementet konstitutive të partive politike janë : • e para, ajo është formë e përhershme e organizimit politik të qytetarëve; • e dyta, ka ideologjinë personale të shprehur në program; • e terta, vepron të tërë territorin shtetëror; • e katërta, lufton për fitimin e pushtetit me anë të zgjedhjeve të përgjithshme ose . për ndikimin demokratik ndaj saj. Sistemi partiak është sistem i marrëdhënieve në mes të partive të përhershme në vend, marrëdhënie të bashkëpunimit dhe marrëdhënie e opozitës dhe konfliktit. Nga aspekti i numrit të partive politike që ndërrohen në pushtet, dallojmë : sistem dypartiak dhe shumëpartiak.

Sistemi dypartiak paraqitet kur dy parti reciprokisht ndërrohen në pushtet në kushte të pranishme të sistemit të shumicës zgjedhore. Në to ekziston disiplinë e fortë partiake me ndihmën e të cilëve sigurohet shumica e sigurtë parlamentare.(psh. Anglia- partia Konservative dhe Laburiste). Pluralizmi politik është vlerë themelore e rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë (neni 8, paragrafi 1,alineja 5). Kushtetuta i përcakton partitë politike si formë të realizimit të saj (neni 20, paragrafi 2). Ligji për partitë politike është sjellë në vitin 1993. Sipas tij, partitë politike janë grupe të organizuara të qytetarëve të cilët pajtohen për pjesëmarrje në pushtet. Ai parasheh mënyrë mjaft liberale për formimin e partive politike nga ana e 500 qytetarëve të rritur- shtetas të Republikës së Maqedonisë, me vendbanim të përhershëm në të. Partia politike mund të fillojë me punë fill pas regjistrimit ta saj në regjistrin gjyqësor në gjyqin e apelacionit. Programi dhe aktiviteti i partive politike nuk guxojnë të jenë të orientuara në drejtim të shkatërrimit me dhunë të rregullimit kushtetues, nxitjes ose thirrjes në agresion luftarak dhe flakjen e urrejtjes nacionale fetare ose racore dhe pa durueshmërinë (neni20,paragrafi 3 nga Kushtetuta). Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë katërdhjetë parti politike. Disa prej tyre janë të formuara sipas kriterit qytetaro-sociologjik, e të tjerat sipas kriterit etnik dhe fetar. Është e njohur se skena e partive maqedonase është më dinamike, ndërsa shoqëria e Maqedonisë politikisht është e segmentuar. Partitë tona ende nuk janë në bazë të thellë socialo-ekonomike. Në mungesë të traditës, të demokracisë dhe të kulturës demokratike politike, nuk përkujdesen dhe nuk preferojnë dialogun dhe tolerancën. Marrëdhëniet ndërpartiake më shumë janë relacion i armiqëve partiak, se sa partner dhe jomendimtarë të njëjtë partiak. Partitë politike shqiptare që nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë, kanë qenë të “preokupuar” me çështjen shqiptare, të paktën paraqitjet e tyre në politikat ditore kanë qenë të tilla. Në të

njëjtën kohë edhe në programet e tyre të shkruara kanë inkorporuar pika relevante për zgjidhjen e statusit politik të shqiptarëve në Maqedoni.

Edhe pse deklarohen se profilizimi i tyre politik është i orientuar në djathtizëm apo majtizëm, por këto çështje shumë pak janë debatuar në opinion publik që të dijmë më tepër për ideologjite e tyre politike.

Të paktën tek partitë politike maqedonase dihet shumë qartë orientimi i tyre politik. VMRO-DPMNE-ja është parti djathtise e cila është edhe anëtare në bllokun e partive djathtiste në Evropë, përkatësisht në Partinë Popullore Evropiane. Ndërsa LSDM-ja deklarohet se është parti majtiste, normalisht që edhe ajo është anëtare e partive majtiste në Evropë. Njëjt edhe në Shqipëri e kemi të njëjten situatë ku Partia Socialiste(PS), deklarohet si parti majtiste, ndërsa Partia Demokratike(PD), si parti djathtiste. Partitë shqiptare në Maqedoni nuk kanë një profilizim të qartë orientimi. Shoqëria dhe opinion publik shqiptarë e ka pak të njohur se Partia Demokratike Shqiptare profilizohet si parti djathtiste, megjithatë kjo nuk mjafton vetëm të deklarohen si djathtist, por atë duhet ta dëshmojnë edhe de jure me fjalë të tjera të anëtaresohen edhe në bllokun e partive djathtiste në Evropë. Ndërkaq partia shqiptare në pushtet është deklaruar si parti majtiste, megjithatë profilizimi i tij politik është ende i paqartë. Kjo për arsye se ka qenë në pushtet edhe me LSDM-në majtiste por edhe tani që është në pushtet me VMRO-në djathtiste.

Shumë pak me rëndësi është tek shoqëria shqiptare se si janë të profilizuara partitë politike, për shkak se ende i tangojnë çështjet e pazgjidhura të shqiptarëve në Maqedoni. Megjithatë është koha që edhe ata të përcaktohen në blloqe majtiste dhe djathtiste, në këtë mënyrë hapen shtigje të koalicionimeve me parti minore dhe njëherit konsolidohet skena politike shqiptare.

Subjektet kryesore politike të spektrit të majtë dhe të djathtë, deri me tani nuk kanë pasur sukses në mënyrë të pavarur të realizojnë fitore të madhe politike në zgjedhjet parlamentare ose lokale. Numri i madh i partive politike në ofertën demokratike kontroibuan që aktorët kryesore të jenë të detyruar, thuaj se çdoherë të formojnë koalicione me subjekte më të vogla.³¹ Me fjalë të tjera dy blloqe të fuqishme të subjekteve politike të orientuara me ideologji të qarta mund të mbijetojnë me gjatë në skenën politike. Të njëjtën duhet që ta bëjnë edhe partitë politike shqiptare, të definojnë qartë ideologjinë e tyre politike. Politika është proces përmes së cilit organizohet jeta e përbashkët në një shoqëri. Në kushte të demokracisë çdo qytetar mund të merr pjesë në këtë proces – përmes qasjes së lirë deri te informatat, të cilat kanë të bëjnë me çështje politike, përmes manifestimit të hapur të mendimeve të tyre në lidhje me çështje publike, përmes ndërtimit të pritshmërive, propozimeve ose kërkesave, pa pasur frikë nga shtypja, përmes votimit në zgjedhje, përmes angazhimit në shoqëri civile ose parti politike ose përmes kandidaturës në zgjedhje demokratike. Në këtë mënyrë demokracia paraqet “qeveri të popullit, nga populli dhe për popullin”, të thirruri në fjalët e famshme të Abraham Linkoln-it, President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në periudhën 1961- 65

Polarizimi i subjekteve politike shqiptare në Maqedoni pësoi gjatë këtyre dy dekadave vetëm për shkak të mos orientimit të qartë, përkatësisht si të papërcaktuara si të djathtë të majtë apo të qendrës. Pikërisht mbijetesa e tyre politike është afatshkurtë, sepse nuk fuqizohet blloku politik me plotëkuptimin e fjalës.

Tradicionalisht partitë e djathta janë karakterizuar si parti ekstreme dhe nacionaliste. Duke u bazuar nga kjo traditë e trashëguar, mund të konstatojmë deri diku se edhe partitë politike shqiptare në Maqedoni de fakto kanë një ideologji.

³¹ Eilhem Hofmeister, Karsten Graboë, Partitë Politike, Shkup, 2013, 105

Te paktën deklarativisht dhe me paraqitjet nacionaliste para popullatës PDSH-ja konsiderohet si një parti djathtiste, por pa qenë anëtare në familjen e partive djathtiste në Evropë.

3.3 Indiferenca ndaj problemeve ndëretnike

Partitë politike gjatë këtyre dy dekadave kanë patur një përceptim të gabuar rreth demokracisë. Demokracinë e kanë konsideruar si mundësi armiqësie midis partive politike pozitare dhe opozitare. Ky përceptim i gabuar ka bërë që raportet midis pozitës dhe opozitës, jo vetëm që të përkeqësohen, por në të shumtën e rasteve janë përcjellë edhe me fyerje personale, me shantazhime dhe me sulme fizike. Kur bëhet fjalë për raportet midis partive politike shqiptare, nuk kemi ndonjë përvojë të mirë në aspektin e bashkëveprimit për një vendim marje për të bashkërenduar çështjet politike të pazgjidhura të shqiptarëve në rrugë institucionale.

Vazhdimisht ata kanë qenë dhe vazhdojnë të jetën kritike ndaj njëra tjetrës me një retorikë të papërgjegjeshme, dhe deri më tani asesi të thyejnë barrierat e antagonizmave politik dhe të bashkëveprojnë në një rrugë të vetme. Nëse i analizojmë raportet midis pozitës dhe opozitës shqiptare në Maqedoni, do të shohim se këto raporte kanë qenë të përkeqësuar si pasojë e politikave ditore. Pozita shqiptare gjithmonë ka qenë më e përmbajtur në përmirësimin e raporteve me opozitën, ndërsa opozita shqiptare ka qenë më e ashpër në këtë drejtim. Më së tepërmi këto raporte midis pozitës dhe opozitës janë përkeqësuar gjoja për statusin politik të shqiptarëve në Maqedoni. Por fytyra reale e përkeqësimit të raporteve midis tyre u sheshua me arritjen e kulmacionit të përkeqësimit në vitin 2008 si pasojë e inateve dhe armiqësisë ndërpartiake, me çka erdhi edhe deri te sulmet fizikë midis tyre. Rruga e zhvillimit demokratik në Maqedoni duhet të jetë e hapur nga kushtet dhe faktorët që e determinojnë atë dhe do të

shërbejnë si bazë për zhvillimin e përgjithshëm të saj. Maqedonia duhet të përcaktohet në aspektin politik dhe kushtetues që të ndjekë rrugën e zhvillimit demokratik të shteteve perendimore demokratike, për shkakë se vetëm integrimi në sturkturat euroatlantike mund të siguroj ardhmëri të sigurt për Maqedonin. Prandaj Republik e Maqedonisë tetëmbëdhjetë vite të procesit të tranzicionit, gjendet para sfidave historike të arritjes së kohezionit të shoqërisë në baza të principeve demokraite dhe standardeve evropiane për të gjithë qytetarët e saj, pa marrë parasyshë racën, besimin, përkatësisë nacionale ose përkatësisë tjetër, që respektivisht do të integroj Republikën e Maqedonisë në Unionin Evropian, dhe rumbullaksimin e procesit historik të evropeizimit të Maqedonisë në aspektin politik, juridik, ekonomik dhe kulturor. Sipas palës sllavo-maqedonase, faktori politik shqiptar mund të bëhet pjesë e bashkëqeverisjes, vetëm si ***përfaqësues i pakicës shqiptare*** dhe jo si përfaqësues i bashkësisë etnike shqiptare, që përbën një të tretën e popullsisë së Maqedonisë. Ky është pra thelbi i problemit ndëretnik në Maqedoni. Kjo çështje nuk u tejkalua si duhet as pas luftës së 2001-shit dhe miratimit të Marrëveshjes së Ohrit. Hyrja e partisë politike shqiptare në qeveri në rolin e përfaqësueses së “minoritetit” shqiptar, ka këtë domethënie: *subjekti politik shqiptar që bëhet pjesë e bashkëqeverisjes, partnerit sllavo-maqedonas të koalicionit nuk mund t’i shtrojë kërkesa politike. Ajo mund të paraqesë vetëm kërkesa infrastrukturore dhe ca kërkesa që kanë të bëjnë me lëmin e kulturës.* Sipas palës sllavo-maqedonase, çështja shqiptare në Maqedoni nuk është veçse një *çështje kulturore*. Sipas sllavo-maqedonasve, shqiptarët nuk mund të jenë *ortakë* të shtetit me sllavo-maqedonasit. *Shteti është yni – thonë ata. Ai është një dhe i pandarë. Ju s’mund të jeni ortakë të tij. Pronarë të tij jemi ne.*

* * *

Është e vetëkuptueshme se në qeveri duhet të hyjë vetëm ajo parti shqiptare e cila i fiton zgjedhjet. Në vitin 2006, VMRO-ja nuk e përfilli një gjë të tillë. E mori në qeveri partinë shqiptare që i humbi zgjedhjet. Duke qenë se një gjë të tillë synon ta bëjë edhe tani, atëherë para faktorit politik shqiptar imponohet *detyra historike*:

- Të veprojë i bashkuar, në mënyrë që të imponojë ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë; me ndryshimin e bërë do të përcaktohej me akt normativ që në qeveri të hyjë vetëm ajo parti shqiptare që i fiton zgjedhjet;

- Derisa të mos e imponojnë ndryshimin e kushtetutës, partitë politike shqiptare duhet të arrijnë një *marrëveshje të ndërsjellë*, sipas së cilës, në qeveri duhet të hyjë vetëm ajo parti shqiptare që i fiton zgjedhjet. Çështja e hyrjes në qeveri nuk është çështje partiake. Kjo është një çështje me rëndësi kombëtare. Çështja e hyrjes në qeveri i tejkalon interesat partiakë. Interesi partiak është i pjesshëm, ndërsa ai kombëtar, është i përgjithshëm. Partia politike shqiptare, e cila lidhur me hyrjen në qeveri, nuk pranon të arrijë një marrëveshje brendashqiptare, merr përsipër *përgjegjësi historike*. Formimi i qeverisë me partitë politike që i fitojnë zgjedhjet është dashur të parashikohet në mënyrë të prerë qysh në Marrëveshjen e Ohrit. Duke qenë se një gjë e tillë nuk u parapa me të, atëherë kjo duhej të bëhej në vitin 2002, si plotësim i kushtetutës së Maqedonisë.

Hyrja në qeveri e partisë shqiptare humbëse, në vitin 2006 përbën *precedent*. Po që se kjo ndodh edhe në vitin 2014, atëherë ekziston rreziku që një gjë e tillë të bëhet *praktikë* dhe të përsëritet e të ripërsëritet kurdo që t'i kujtohet mandatarit sllavo-maqedonas. ***Shqiptarët pas kësaj, s'do të kishin asnjë arsye për të dalë në zgjedhje.*** Ç'do të kishte bërë VMRO-ja sikur partitë politike shqiptare, rreth çështjeve me interes kombëtar, të bashkëpunonin ndër vete, të bashkëvepronin dhe t'i bashkërenditnin veprimet politike?! Mungesa e bashkëpunimit, e bashkëveprimit dhe e bashkërendimit të veprimeve politike midis partive shqiptare, ndikon në *depozicionimin* e faktorit politik shqiptar, përballë faktorit politik sllavo-maqedonas. Veprimi politik i përbashkët do ta forconte pozitën e faktorit politik

shqiptar përballë VMRO-së. Pas një pozicionimi të fuqishëm, faktori politik shqiptar do të dilte para saj me *kërkesa politike* dhe jo me kërkesa të dorës së dytë.

Për ta parandaluar veprimin politik të bashkërenduar të spektrit politik shqiptar, pala sllavo-maqedonase, me ndihmën e infrastrukturës *përçarëse* të shtetit, që nga viti 1991 e deri më sot, në hapësirën politike shqiptare vazhdimisht e ka hedhur *mollën e Eridës*, duke ndezur kësisoj grindje të ashpra ndërshtetërore.

Marrëveshjet ndërmjet partive politike shqiptare duhet të arrihen para zgjedhjeve parlamentare dhe jo pas tyre. Marrëveshja brendashqiptare nuk nënkupton *homogjenizimin* e faktorit shqiptar. Duke qenë se çështja shqiptare në Maqedoni ka mbetur e pa zgjidhur, duke qenë se shqiptarët nuk e kanë fituar statusin e *popullit shtetformues*, atëherë një marrëveshje midis partive politike shqiptare ka qenë dhe mbetet *imperativ* i kohës.

Për ta arritur një marrëveshje brendashqiptare në Maqedoni, nuk duhet pritur ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të *qendrave politike shqiptare të vendosjes* – Tiranës dhe Prishtinës. Një ndërhyrje të tyre në skenën politike shqiptare në Maqedoni, *qendrat politike ndërkombëtare të vendosjes* – Uashingtoni dhe Brukseli, nuk do ta parapëlqenin dhe nuk do ta mirëpritnin. Ndihma eventuale e Tiranës dhe e Prishtinës për harmonizimin e pikëpamjeve dhe të veprimeve politike të faktorit shqiptar në Maqedoni, do të cilësohej nga ndërkombëtarët si *paternalizëm*, që bie ndesh me konventat ndërkombëtare.

* * *

Në çastin e pikërisht, VMRO-ja dhe Gruevski ballafaqohen me qëndrimin e opozitës sllavo-maqedonase, d.m.th. të LSDM-së, e cila nuk i njeh zgjedhjet, as presidenciale, as ato parlamentare. Përfshirja eventuale në qeveri e partisë shqiptare humbëse, paraqet mosrespektim të vullnetit të shumicës së elektoratit shqiptar. Një hap i tillë i VMRO-së dhe i partisë shqiptare

humbëse, do të shkaktonte *probleme ndëretnike*. Me këtë rast, VMRO-ja do të ballafaqohej me dy lloj problemesh:

- Me ***krizën politike*** të shkaktuar nga LSDM-ja, dhe

- Me ***problemet ndëretnike*** të shkaktuara nga shkelja dhe nëpërkëmbja e vullnetit të shumicës së votuesve shqiptarë. E ballafaquar me dy lloj rezistencash, të opozitës sllavo-maqedonase dhe të opozitës shqiptare, Maqedonia do të hynte në ***krizë të thellë politike*** dhe ***ndëretnike***. Si rrjedhojë, do të kishim ***delegjitimimin*** e dy pushteteve: të pushtetit *ligjvënës* dhe të pushtetit *ekzekutiv*. Me një fjalë, legjitimiteti i qeverisë së Gruevskit do të vihej në dyshim. Në rrethana të tilla, do të pasonte ***destabilizimi*** i vendit, me pasoja edhe për *destabilizimin e rajonit*. Maqedonia do të shënonte hapa regresivë, që shpijnë në drejtim të kundërt të integriteteve euro-atlantike.

Faktori politik shqiptar duhet të manifestojë ***kapacitet politik***. Për të manifestuar kapacitet politik, ai duhet të posedojë *potencial politik*. Kërkesat e një partie mund të jenë: *infrastrukture, kulturore, sociale, ekonomike dhe politike*. Faktori politik shqiptar duhet të dalë para VMRO-së me ***kërkesa politike***. Kërkesat politike të tij nuk paraqesin kurrfarë ***radikalizmi*** politik. Kërkesat politike të faktorit shqiptar nuk kanë të bëjnë me *ndryshim kufijsh*, as *të brendshëm* dhe as *të jashtëm*. Derisa kërkesat politike nuk e prekin tërësinë tokësore të vendit, ato nuk mund të cilësohen si radikale. Dihet mirëfilli se kërkesat politike të faktorit shqiptar janë ***primordiale*** dhe *reale*.

Faktori politik shqiptar, e sidomos BDI-ja duhet të dalë para palës sllavo-maqedonase me kërkesat e poshtëshënuara:

- të njihet zyrtarisht *lufta e 2001-shit*;

- të njihet zyrtarisht roli i *UÇK-së* në luftën e 2001-shit;

- dita e nënshkrimit të *Marrëveshjes së Ohrit* të kremtohet si festë shtetërore;

- të zgjidhet me ligj *statusi i dëshmorëve* të luftës së 2001-shit;
- të zgjidhet me ligj *statusi i invalidëve* të luftës së 2001-shit;
- lufta e 2001-shit, UÇK-ja dhe Marrëveshja e Ohrit të jenë pjesë e *historisë* së shtetit;
- lufta e 2001-shit, UÇK-ja dhe Marrëveshja e Ohrit të përfshihen në *tekstet e historisë* të shkollave të mesme si dhe në tekstet universitare të historisë. Kërkesat e lartpërmendura është dashur të zgjidheshin qysh në vitin 2002. Zgjidhja e tyre është *conditio sine qua non* për zgjidhjen e kërkesave politike vijuese. Ato duhet të zgjidhen nga *brezi i tashëm* i faktorit shqiptar, që ishte mbartës i luftës së 2001-shit dhe pjesë e pandarë e saj, e ngjarjeve historike dhe e proceseve politike. Po qe se kërkesat e sipërthëna nuk zgjidhen nga brezi i sotëm i klasës politike dhe intelektuale, atëherë ekziston rreziku që ato të mos zgjidhen kurrë. Lufta e 2001-shit është pjesë e rëndësishme e popullit shqiptar në Maqedoni dhe e kombit shqiptar në gadishull. Po qe se ajo nuk përshihet në dokumentet zyrtare të shtetit, si *luftë e drejtë*, si dhe në plan-programet e historisë të shkollave të mesme dhe të universiteteve, atëherë të rinjtë e sotëm, për luftën do të mësojnë nga *gojëdhënat* e gjyshërve të tyre, si në *epet homerike*. Gojëdhënat, mitet dhe legjendat, në kohën e internetit do të duken anakronike. Faktori politik shqiptar nuk duhet të harrojë se populli shqiptar: luftëtarëve të lirisë ia çeli vatrat e shtëpisë dhe me nderime *spartakiane* i përcolli në fushëbeteja; luftën e 2001-shit e mbështeti moralisht dhe materialisht, duke ia dhënë bijtë më të mirë, për ta falur *gjakun* në altarin e lirisë. BDI-ja nuk duhet të harrojë se populli shqiptar, që nga viti 2002 e deri më sot, në të gjitha zgjedhjet - parlamentare dhe vendore - ia dha besimin kombëtar, politik dhe demokratik, për të qenë *mbartëse e proceseve politike*. Përgjegjësia e saj para popullit shqiptar është tepër e madhe. Si pjesë e bashkëqeverisjes në vitet 2008-2014, ajo nuk ia doli të demonstrojë kapacitet të duhur politik.

Të jetë shqiptar kryetari i kuvendit të shtetit, nuk është ndonjë arritje e madhe. Një shqiptar “*indershëm*” ka qenë kryetar kuvendi republikan qysh në vitet 1986-1991. Ai edhe sot mund të jetë shqiptar, por sipas kushtetutës, Maqedonia – *në thelb* - përkufizohet si shtet **unitar, një-etnik** dhe **centralist**.

Faktori politik shqiptar, palës sllavo-maqedonase duhet t’i parashtrojë kërkesa që kanë të bëjnë me **dezunitarizimin** e shtetit, d.m.th me **federalizmin** dhe me **dyetnizimin** e tij. *Liri ke aq sa meriton. Fitorja i përket atij, i cili çdo ditë shkon në luftë për të (Gëte)*. Raportet e tyre për interesa madhore të çështjes shqiptare në Maqedoni, asnjëherë nuk janë ndërtuar midis pozitës dhe opozitës. Vetëm kur i ka detyruar faktori ndërkombëtar që të ulen dhe të marri vendim për çështjet e detyrueshme, kushtimisht të imponuara nga ata. Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, si një akt historik në interes të të gjithë shoqërisë dhe shtetit në veçanti për shqiptarët, raportet pozitive - opozitive kanë të domosdoshme dhe në instancë të fundit të imponuar nga faktori ndërkombëtar.

Përplasjet midis tyre kanë qenë evidente edhe nëpër insitucionet shtetërore, për shkak të ligjeve selektive, përkatësisht për proceset politike të pazgjidhura të shqiptarëve etj.

Kriza politike në Maqedoni që ekziston gati disa vite me radhë ka sjellë edhe krizë të re të raporteve mes pozitës dhe opozitës shqiptare. Këto raporte kanë qenë destruktive, me vet faktin se në vend që pozita shqiptare participuese në qeveri t’i paralizoj institucionet me braktisjen nga qeveria, ajo ende ia shton jetëgjatësinë pushtetit maqedonas. Dhe pikërisht ngecjet e raporteve evidentohen në këtë drejtim.

Kjo krizë politike që ka tronditur opinionin e brendshëm dhe ndërkombëtar, nuk ka lënë vend edhe për partitë jashtaparlamentare shqiptare opozitare të ngrijnë raportet me pozitën shqiptare (BDI-në).

Një zili tanimë e dukshme që mbretëron në mjedisin e skenës politike shqiptare në Maqedoni në raport me partitë jashtëparlamentare të themeluara dy viteve të fundit, është shumë evediente dhe pikërisht këto parti kanë krijuar edhe një ripolarizim të ri politik. Ndër të tjera ky realitet ka shkrirë akujt ndërpartiak mes BDI-së dhe PDSH-së dhe ka rezultuar me raporte më të mira kuptohet në mënyrë të fshehtë, vetëm e vetëm për të eliminuar partitë e reja jashtëparlamentare.

Megjithatë kalimthi vlen të theksojmë edhe polarizimin brenda kampusit të partive opozitare jashtëparlamentare, të cilat ende pa u konsoliduar ashtu siç duhet raportet e tyre janë ashpërsuar dhe asesi të gjejnë gjuhë të përbashkët për të bashkërenduar proceset politike me krijimin e një blloku opozitar të fuqishëm.³²

3.3 Sfidat me të cilat ballafaqohet RMV

Linjat e ndarjes sipas identitetit janë të shpeshta dhe të ndryshueshme. Njëherazi, Maqedonia është shoqëri me ndarje të thellë mes shumicës maqedonase dhe pakicës shqiptare. Duke qenë të ndarë sipas gjuhës, fesë dhe me ndjenjë të fuqishme të identitetit nacional, komunikimi mes dy bashkësive ka qenë i kufizuar në periudhën e dhjetëvjeçarëve të fundit. Së këndejmi, tensioni mes pakicës shqiptare dhe shumicës maqedonase është bërë veçoria definuese e shtetit maqedonas që nga krijimi i tij. Pas referendumit për pavarësi në fundin e vitit 1991 dhe miratimit të Kushtetutës së re, Maqedonia është themeluar formalisht si shtet nacional, por i dobësuar për shkak të aspektit rajonal dhe nuk ka pasur përkrahje nga bashkësia shqiptare për shtetin e ri. Vitet e nëntëdhjeta janë shënuar me dy zhvillime kundërtë: përfshirja politike e

³² Analizë nga autori punimit (Miranda F.)

pakicës shqiptare dhe thellimi (madje edhe zgjerimi) i ndarjes mes dy bashkësive më të mëdha. Si që ceket edhe në vijim, përfshirja e partive politike shqiptare në kuvend dhe qeveri ka qenë rezultat i baraspeshës së veçantë të fuqisë mes partive të bazuara tek shumica dhe i politikës së qëllimshme të përfshirjes. Njëherazi, periudha mes vitit 1991 dhe 2001 nuk ka rezultuar me përfshirje substanciale të popullatës shqiptare në administratën publike dhe shteti ka vepruar kryesisht si shtet nacional i shumicës. Ndonëse shqiptarët kanë qenë të përfshirë në qeveri, sistemi qeveritar nuk mund të konsiderohet si formë e ndarjes së pushtetit, por si një përpjekje për përfshirjen e elitës shqiptare. Numri i shteteve nacionale që i kanë përjashtuar në mënyrë eksplicite pakicat nga jeta politike ose që i kanë penguar të drejtat e pakicave është i vogël. Njëherazi, shumica e shteteve nacionale kanë krijuar klerarki simbolike ose pronësi dhe privilegj për shumicën në sfera të ndryshme. Vendosija e simboleve nacionale maqedonase në shtet kanë qenë përgjigjja kyçe ndaj sfidave të shumëfishta, të cilat janë krijuar nga shtetet fqinje për shtetin dhe veçueshmërinë e popullit maqedonas. Pika kryesore e kontestimit ka qenë në marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit, duke u fokusuar në çështjen e emrit (me Greqinë), veçueshmërinë e popullit dhe gjuhës maqedonase (me Bullgarinë) dhe Kishën ortodokse maqedonase (me Serbinë). Sa i përket përdorimit të simboleve, shqiptarët dhe shumica e pakicave tjera nuk e kanë kundërshtuar zgjedhjen e simboleve të shtetit.³³ Njëherazi, Kushtetuta e re maqedonase jo vetëm që e ka përcaktuar në Preambulë dominimin e popullit maqedonas (ku shteti është përshkruar si shtet i popullit maqedonas), por edhe në përcaktimin e gjuhës maqedonase si gjuhë shtetërore dhe në dallimin e Kishës ortodokse maqedonase. Si që ceket edhe nga Jenny Engström, "në tërësi.... Kushtetuta e ka pranuar konceptin liberal dhe qytetar të shtetësisë, duke dhënë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e Maqedonisë, pa dallim nga përkatësia etnike dhe/ose

³³ Engström, citat i hapur, fq. 335-48; Keith S. Brown, "Seeing Stars: Character and Identity in the Landscape of Modern Macedonia," *Antiquity*, Vol. 68, 1994, fq. 784-796.

fetare".³⁴ Është e sigurt që pohimi për inkorporim vetëm të populli maqedonas në shtet ka qenë më pak i zhvilluar, në krahasim me shumicën e kushtetutave në ish-republikat jugosllave. Kjo dukuri emërohet nga Robert Hayden si "nacionalizëm kushtetues".³⁵ Për më tepër, nëse e krahasojmë raportin e KE-së me Maqedoninë Veriore me vërejtjet nga një pjesë të disa vendeve anëtare dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për të njëjtat çështje, vërehet një mospërputhje e pjesshme në lidhje me vlerësimin e cilësisë së reformave të kryera në vend gjatë viteve të fundit. Megjithëse raporti është përgatitur sipas një metodologjie të paracaktuar dhe do të duhej të ofrojë një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe objektiv të punës së bërë edhe gjatë vitit të fundit edhe në mënyrë kumulative, duhet të kihet parasysh se versioni përfundimtar miratohet në nivel politik.

Në atë kontekst, për këtë përbërje të KE-së në largim, i cili nuk shënohen arritje të konsiderueshme në politikën e zgjerimit, sidomos për Përfaqësuesen e Lartë dhe Komisionarin për zgjerim, të cilët personalisht u angazhuan për Marrëveshjen e Prespës si një mënyrë për Maqedoninë e Veriut që të përparojë në rrugën drejt UE-së, mbështetja është e kuptueshme për Qeverinë në vitin e parë të nënshkrimit dhe ratifikimit të Marrëveshjes nëpërmjet instrumentit të vetëm që e kanë në dispozicion - një raport "i zbukuruar". Por duke e pasur parasysh zgjedhjen e ardhshme të Komisionit të ri nga përfaqësuesit e vendeve që kanë një qëndrim negativ në rritje ndaj zgjerimit, ka të ngjarë që raporti i ardhshëm të mos jetë aq pozitiv dhe do ta reflektojë në mënyrë reale mungesën e reformave në vendin tonë, që është një faktor shtesë rëndues për ne. Qeveria, në përpjekje për ta kapërcyer mosmarrëveshjen që deri para disa vitesh ishte e vetmja pengesë për fillimin e negociatave, tërësisht anashkaloi "fotografinë e madhe", përkatësisht ndryshimet që ndodhën në ndërkohë brenda BE. Përkatësisht, kriza financiare, ajo e borxheve

³⁴ Engström, citat i hapur, fq. 338.

³⁵ Robert Hayden, *Blueprints for a House Divided. The Constitutional Logic of the Yugoslav Conflicts* (Ann Arbor: University of Michigan Press, 1999), fq. 71-72.

dhe kriza e ekonomisë evropiane në periudhën 2008-2013 “nxorën” në sipërfaqe sfida të shumta të brendshme dhe mosmarrëveshje midis shteteve anëtare për çështjet kyç që lidhen me funksionimin e UE. Në kombinim me krizën e migrantëve të vitit 2015 dhe Bregzitin, problemet me të cilat ballafaqohet UE dhe shtetet anëtare e vënë në plan të dytë politikën e zgjerimit. Në këtë kontekst, përmbushja e kriterëve që mundësuan që Mali i Zi dhe Serbia të fillojnë negociatat qasëse në vitin 2012 përkatësisht në vitin 2013 tanimë nuk janë të mjaftueshme dhe praktika e vendosjes së standardeve më të ashpra dhe më të larta që ka filluar në vitin 2004 dhe 2007 edhe më tej vazhdon.

Përveç kësaj, zgjidhja e përkohshme e kontesteve me Greqinë dhe Bullgarinë nëpërmjet Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes të fqinjësisë së mirë nuk siguron asnjë garanci se procesi i pranimi do të vazhdojë pa pengesa dhe pa bllokada të reja nga këto ose vendet e tjera anëtare. (Këq) përdorimin e vetos në procesin e zgjerimit për të arritur interesat e brendshme që nuk lidhen drejtpërdrejt me vetë procesin ose vendet aspirante po bëhen tanimë bëhet një praktikë e rregullt. Për shembull, në Këshillin e fundit, Qiproja kërcënoi me veto çdo përpjekje për zgjerim të mëtejshëm nëse UE nuk merr një qëndrim më të rreptë ndaj Turqisë. Ajo paralajmëron një krizë serioze në lidhje me instrumentet dhe parimet aktuale të politikës së zgjerimit. Politika “**e rreptë, por fer**” e zgjerimit në të cilën çdo shtet avancohet sipas meritave të veta, siç duket tanimë është koncept i cili nuk përkon me realitetin.

3.4 Marrëdhëniet me fqinjët

Ndër katër vendet fqinje, Maqedonia ka marrëdhënie bilaterale shumë të mira me Kosovën, dhe kështu është e renditur si fqinji i dytë i Kosovës, dhe është në vendin e katërt në rajon, nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve bilaterale me Kosovën. Ngjashëm me marrëdhëniet e shkëlqyera të Kosovës me Shqipërinë, marrëdhëniet shumë të mira me Maqedoninë përfitohen nga rezultati i tërësishëm që Maqedonia e ka në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, për dallim nga vendet e tjera të rajonit, shumica e të cilave e kanë njohur Kosovën, ose menjëherë, ose brenda 6 muajve të parë, Maqedonia e njohu Kosovën më 9 tetor 2008, rreth 8 muaj pasi që kjo e shpalli pavarësinë e vet, gjë kjo që Maqedoninë e bën njërin nga vendet e fundit në rajon, dhe të 50-in në botë, që e njohu Kosovën.³⁶ Vonesa në njohjen e Kosovës ishte rezultat i mendimeve të ndryshme të zgjatura; Maqedonia frikësohej se Serbia mund t'i prishë keq marrëdhëniet me të, meqë ish-Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq i kishte thënë Presidentit të atëhershëm të Maqedonisë, Branko Crvenkovskit që njohja e Kosovës do të thoshte “ndërrhyrje në punët e brendshme [të Serbisë] dhe që kjo gjithsesi do t'i përkeqësonte marrëdhëniet [e tyre]”³⁷ Kjo u bë e evidente kur, si reagim ndaj njohjes së Kosovës, Serbia e dëboi Ambasadorin e Maqedonisë në Beograd,⁵¹ edhe pse kjo ishte një praktikë e rëndomtë e Serbisë në fillim me pothuaj çdo shtet që e njohte Kosovën.³⁸ Po ashtu, në një analizë që u bë në vitin 2008, pasi që Kosova e kishte shpallur pavarësinë e vet, 60% të maqedonasve ishin kundër njohjes së Kosovës nga ana e Maqedonisë, kështu që ishte po ashtu edhe një trysni

³⁶ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

³⁷ [tregtare”], KIPRED, 26-29. 48 “Key facts and figures” [“Faktet dhe shifrat kyçe”], KFOR, 30 nëntor, 2012, qasur më 21 janar, 2014, http://www.nato.int/kfor/structur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf

³⁸ Shih vendet që e kanë njohur Kosovën, <http://www.kosovothankyou.com/>.

publike e supozuar dhe këmbëngulëse në Qeverinë nga bashkësia maqedonase.³⁹ Maqedonia duket sikur ishte po ashtu nën “trysni” nga aleatët e vet perëndimorë për të lëvizur përpara me njohjen⁴⁰ Duke e marrë parasysh që kërkesat e tilla bëheshin nga vendet të cilat Maqedonia tashmë i kishte përcaktuar të jenë në interesin e politikës së vet të jashtme, dhe atë kryesisht nga vendet anëtare të UE-së dhe të NATO-s, Maqedonia, më 9 tetor 2008 vendosi ta njohte Kosovën; megjithatë, kjo u përpoq, por pa sukses, që njohjen ta kushtëzonte me demarkacionin e kufirit midis dy vendeve. Pos vonimit të njohjes, u desht mjaft kohë para se Maqedonia t’i vendoste marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivel ambasadorësh me Kosovën, dhe të cilën, përsëri, u përpoq ta bënte të kushtëzuar nga puna në demarkacionin e kufirit.⁴¹ Rreth një e katërta e popullsisë së Maqedonisë përbëhet nga shqiptarët, çka bën që influenca e Shqipërisë në një periudhë krize të fortë politike dhe tensionesh etnike në Maqedoni, të ketë implikime në zhvillimet e brendshme dhe politikën e jashtme të Maqedonisë. Kjo mund të vërehet edhe në një numër akuzash gjatë vitit 2017 për përfshirjen e Shqipërisë në punët e brendshme të vendit. Në mars të vitit 2017, zyrtarë të Maqedonisë pretenduan se Shqipëria po përpiqej të promovonte axhendën e saj të politikës së jashtme, duke nxitur ndryshimet kushtetuese në Maqedoni, duke e njohur gjuhën shqipe si gjuhën e dytë zyrtare të vendit. Gjatë periudhës së sipërpërmendur, media raportoi se partitë politike shqiptare të Maqedonisë, të mbështetura nga Tirana zyrtare, paraqitën kushtet paraprake të hyrjes në cilindo koalicion qeveritar. Rusia, një aktor tjetër i përfshirë gjatë kësaj periudhe, do të argumentonte se Bashkimi Evropian po mbështet “Platformën Shqiptare” dhe po luante një rol të dëmshëm në garantimin e stabilitetit të rajonit.

³⁹ “When will Macedonia Recognize Kosovo” [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën”], qasur më 19 janar, 2014, <http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/When-Will-Macedonia-Recognize-Kosovo-43368>

⁴⁰ Po aty

⁴¹ “When will Macedonia Recognize Kosovo” [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën”], qasur më 19 janar, 2014, <http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/When-Will-Macedonia-Recognize-Kosovo-43368>

Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, një çështje kyçe shqetësuese është gjendja e të drejtave të njeriut, të shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni. Qëndrimi zyrtar shqiptar është se pavarësisht nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, ka mungesa të theksuara të barazisë së të drejtave midis qytetarëve shqiptarë dhe maqedonas të Maqedonisë.⁴² Veçanërisht shqetësues është progresi i ngadaltë në garantimin e respektimit të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar shqiptar, punësimit dhe shërbimeve sociale. Mbulimi i Shqipërisë⁴³ në mediat maqedonase është sa interesant aq dhe i pazakontë. Rasti i Maqedonisë është i veçantë për shkak se shumica e mbulimit mediatic të shqiptarëve lidhet me zgjedhjet lokale në vend. Roli i partive politike në koalicionet post-zgjedhore në vend ka qenë në qendër të vëmendjes mediatike. Gjithashtu, një pjesë e mbulimit të Shqipërisë lidhet me rastet kur ka raportime për ngjarje të rëndësishme në Shqipëri, me impakt apo dimension edhe rajonal, si kriza politike dhe bojkotet e herëpashershme të proceseve politike e institucionale.

Pavarësisht ngjarjeve të fundit, Shqipëria dhe Maqedonia kanë ndërtuar një bashkëpunim intensiv në fushën e sigurisë. Që prej vitit 2000, midis dy vendeve janë nënshkruar të paktën shtatë marrëveshje vetëm në sektorin e sigurisë. Në vitin 2000 ministrat e brendshëm të të dy vendeve nënshkruan një protokoll kundër emigracionit të jashtëligjshëm. Protokolli do të kontribuonte në përmirësimin e koordinimit të politikave të emigracionit dhe në përpjekjet kundër emigracionit të jashtëligjshëm në të dy anët e kufirit. Pas krizës së vitit 2001 në Maqedoni, ku Ushtria Çlirimtare Kombëtare u përplas me Forcat e Sigurisë të Maqedonisë,

⁴² CODEXTER (2014, November). Profiles of Counter-Terrorist Capacity: Albania. Council of Europe, f. 1. 25 Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare. Vjenë. (22 Maj 2014). Notë Verbale. Nr. Prot. 304. <http://www.osce.org/fsc/119814?download=true> (parë për here të fundit në datën 12/07/2016)

⁴³ Zëri i Amerikës. (Mars 2017). Presidenti i Maqedonisë paralajmëron për kërcënimin e sovranitetit të vendit nga Shqipëria. <https://www.voanews.com/a/macedonian-president-warns-of-albanian-threat-to-sovereignty/3754238.html> (parë për herë të fundit më 10/11/2017); Euractiv. (Mars 2017). Shqipëria paralajmëron Maqedoninë të mos i japë krizës ngjyrim etnik. <http://www.euractiv.com/section/elections/news/albania-warns-macedonia-not-to-bring-ethnic-twist-to-crisis/> (parë për here të fundit më 10/11/2017).

qeveria shqiptare dhe ajo maqedonase nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të vijuar dhe përparuar bashkëpunimin dhe kontaktet midis dy ministrive të mbrojtjes. Bashkëpunimi midis dy vendeve u forcua edhe në kuadrin e luftës së përbashkët kundër terrorizmit. Përpjekjet e para për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar u konkretizuan në vitin 2004, kur dy qeveritë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Qëllimi i marrëveshjes ishte intensifikimi i bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikeve të jashtëligjshme, trafikut ndërkombëtar të drogës, emigracionit të jashtëligjshëm dhe aktiviteteve të tjera të jashtëligjshme. Për të intensifikuar përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore përgjatë kufijve të dy vendeve në vitin 2006 u nënshkrua një Protokoll shtesë, i cili do të plotësonte marrëveshjen e mëparshme. Objektivi specifik i tij do të ishte intensifikimi i bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përgjatë kufirit. Ky intensifikim i raporteve institucionale në nivelin e politikës së jashtme dypalëshe dëshmon se reciprociteti ka prodhuar një shkallë të lartë ndërvarësie. Kjo ndërvarësi, e ndërthurur dhe me elementë të tjerë si integrimi i Shqipërisë⁴⁴ në NATO, ka potencialin të prodhojë një inerci afatgjatë bashkëpunimi midis këtyre dy vendeve në rajon. Një vit më pas u nënshkruan edhe dy marrëveshje të tjera që përfshinin Shqipërinë, Maqedoninë dhe vende të tjera të NATO-s, për të zhvilluar stërvitje të përbashkëta ushtarake dhe për bashkëpunim ushtarak në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto marrëveshje kishin si synim të asistojnë Shqipërinë dhe Maqedoninë në përmbushjen e standardeve të NATO-s, duke i përgatitur këto vende për anëtarësimin e ardhshëm në aleancë. Në të njëjtën fushë u nënshkrua më vonë një memorandum i dytë mirëkuptimi midis ministrive të mbrojtjes së të dy vendeve. Qëllimi i këtij memorandumi ishte rritja e bashkëpunimit dhe

⁴⁴ Zëri i Amerikës. (Mars 2017). Presidenti i Maqedonisë paralajmëron për kërcënimin e sovranitetit të vendit nga Shqipëria. <https://www.voanews.com/a/macedonian-president-warns-of-albanian-threat-to-sovereignty/3754238.html> (parë për herë të fundit më 10/11/2017); Euractiv. (Mars 2017). Shqipëria paralajmëron Maqedoninë të mos i japë krizës ngjyrim etnik. <http://www.euractiv.com/section/elections/news/albania-warns-macedonia-not-to-bring-ethnic-twist-to-crisis/> (parë për herë të fundit më 10/11/2017).

vullneti i të dy vendeve për të arritur paqen dhe prosperitetin në rajon përmes shkëmbimit të ekspertëve të të dy vendeve. Maqedonisë, para disa kohësh nuk i ishte dhënë ftesë për anëtarim në NATO për shkak të vetos greke. Në Samitin e NATO-s të mbajtur në Bukuresht, liderët aktualisht refuzuan të dërgojnë ftesë për anëtarim në alijansën pasi që Greqia e bllokoi vendimin për shkak të emrit të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.⁴⁵ Sekretari Gjeneral i NATO-s , Jan De Hop Shefer në konferencën për shtypin tha:”Ne u pajtuam që ftesa ti dërgohet Ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë menjëhere pasi që të arrihet zgjidhje e përbashkët e pranueshme për çështjen e emrit “. Qëndrimi oficial i Minsitrisë të Punëve Jashtme të Greqisë thotë që është e “pamundur ti lejohet IRJM hyrje në EU dhe NATO me emrin Republika Maqedonisë” dhe se “Slavomaqedonasit e IRJM-së insistojnë edhe më tutje qëndrim e tyre këmbëngulës negativ në drejtim të zgjidhjes të çështjes së emrit “⁴⁶Sipas Ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, Dora Bakojani, emri “Republika e Maqedonisë”... është e lidhur me plan pregaditor për përvetsim të teritorit grek, që ka identitet grek më shumë se tre mileniume dhe gjithashtu është e ndërlidhur me shumë dhimbje dhe sakrificë të popullit grek.⁴⁷ Maqedonia ka të drejtë legjitime në emër dhe identitet. Kjo e drejtë bazohet në më shumë argumente dhe atë juridike, morale, historike ose thjesht argumente të bazuara në ide liberalo demokratike.Vetëpërcaktimi është princip që konsiderohet si e drejtë morale dhe ligjore se “ të gjithë njerëzit kanë të drejtë ta shprehin statusin e tyre politik dhe lirshëm ta realizojnë zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor”⁴⁸

⁴⁵ <http://www.reuters.com/article/topNews/idUSL0327252820080403>, On the Greek veto see also <http://www.anampa.gr/anaeb/user/shoëplain?maindoc=6305115&maindocimg=6305032&service=6>

⁴⁶<http://ëëë2.mfa.gr/ëëë.mfa.gr/enUS/Policy/Geographic+Regions/SouthEastern+Europe/Balkans/Bilateral+Relations/FYROM/FYROM+-+THE+NAME+ISSUE.htm>

⁴⁷ <http://ëëë.iht.com/articles/2008/03/31/opinion/edbakoy.php>

⁴⁸ Мегународна спогодба за граѓански и политички права, член 1. maqedonist

KAPITULLI I KATËRT

4. Zgjedhjet parlamentare të 2016

Zgjedhjet parlamentare paraqesin mekanizma demokratike, me ndihmën e të cilëve zgjidhen deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, i cili është organ njëdhomësh përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës në Republikën e Maqedonisë. Nëpërmjet këtij mekanizmi populli ia beson ushtrimin e pushtetit politik, organit përfaqësues i cili pastaj e prezanton vullnetin e vetë sovran. Elektorati e mundëson kalimin e sovranitetit nga qytetarët te përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike. Parimet themelore të zgjedhjeve parlamentare janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ndërsa mënyra, kushtet dhe procedurat për zgjedhje të deputetëve janë të rregulluara me Kodin Zgjedhor. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Kuvendi përbëhet nga 120 deri në 140 deputetë. Numri i saktë i deputetëve është verifikuar në Kodin Zgjedhor dhe ai numër deri në vitin 2008, ishte 120, kurse më pas numri i deputetëve u zmadhua në 123. Deputetët marrin mandate 4 vjeçare në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votime të fshehta. Zgjedhjet parlamentare zhvillohen çdo katër vjet gjatë 90 ditëve të fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve, ndërsa ato i shpall kryetari i Kuvendit. Zgjedhjet parlamentare zhvillohen edhe në rast të vetëshpërbërjes së Kuvendit (zgjedhje të parakohshme), nëse për të deklarohen shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në këtë rast, zgjedhjet zhvillohen, në afat prej 60 ditësh nga dita e shpërbërjes së Kuvendit. Të drejtë për votim ka secili shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili ka mbushur 18 vjeç, ka kapacitet juridik dhe ka adresë të përhershme në njësinë zgjedhore, në të cilën ka votime. Në zgjedhjet për deputetë votojnë edhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët në ditën e zgjedhjeve janë me punë dhe qëndrim të përkohshëm jashtë vendit.

Të drejtën për votim ata e realizojnë në përfaqësitë diplomatike konsullore të Republikës së Maqedonisë në vendet ku qëndrojnë ose punojnë. Votimi nuk është i detyrueshëm. Kandidat për deputet mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili ka mbushur 18 vjeç, ka kapacitet juridik dhe nuk është duke vuajtur dënim me burg për kryerje të veprës penale, gjegjësisht nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, ndërsa ende nuk ka filluar ta vuajë dënimin. Zgjedhjet parlamentare të tetat me radhë nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjet e parakohshme të katërta me radhë, do të mbahen më datë 11 dhjetor 2016. Më datë 17 tetor 2016, në seancën e 125-të, me 110 vota “PRO”, me asnjë votë “Kundër” ose “Abstenim”, Kuvendi e miratoi njëzëri vendimin për shpërndarjen e Kuvendit. Ditën e ardhshme, më datë 18 tetor, kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanoski, në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore i shpalli zgjedhjet.⁴⁹ Këto zgjedhje të parakohshme parlamentare do të organizohet në gjashtë njësi zgjedhore (NJZ) në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në një njësi zgjedhore (NJZ 7) jashtë vendit, e cila i përfshinë të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë jashtë shtetit. Në përfaqësitë diplomatike konsullore (PDK) të Republikës së Maqedonisë votimi do të mbahet një ditë më herët, përkatësisht më datë 10 dhjetor 2016. Këtyre zgjedhjeve u parapriu një periudhë turbulente dhe dinamike përplot me kthesa, ngjarje dhe tensione politike. Kriza politike, e cila e përfshiu Maqedoninë viteve të fundit, kulminoi në vitin 2015 me “afërën e përgjimeve”⁵⁰ Marrëveshja u

⁴⁹ Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Vendimi është shkarkuar nga faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). I aksesshëm në: <http://www.sec.mk/predvremeni-izbori-za-pratenici-2016/> (vizita e fundit: 7 nëntor 2016).

⁵⁰ Në muajin shkurt të vitit 2015 partia më e madhe opozitare LSDM filloi të publikojë biseda të përgjuara nga vitet e kaluara (në publikë të njohura si “bomba”) për të cilat pohonte se kinse e vënë në dukje përfshirjen e nëpunësve të lartë qeveritarë dhe nëpunësve publikë në mashtrime zgjedhore, korrupsion, abuzim të pushtetit, presion mbi mediat. Kryetari i LSDM Zoran Zaev vuri në dukje se bëhet fjalë për më shumë se 20.000 qytetarë të përgjuar në mënyrë të paligjshme. Sa i përket këtij numri, më 18 nëntor të vitit 2016 Prokuroria Speciale Publike në një konferencë për shtyp njoftoi se ka në dispozicion materiale dhe prova të cilat vënë në dukje se në periudhën kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2015 në mënyrë të drejtpërdrejt janë përgjuar më së paku 5.827 numra telefonik. Për më shumë informacione shih: www.jonsk.mk/2016/11/18/deklarate-nga-pres-konferenca (vizita e fundit: 22 nëntor 2016).

nënshkrua nga katër partitë më të mëdha politike – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), ndërkaq me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të Komisionit Evropian, të Parlamentit Evropian dhe SHBA. Njëra nga masat e parashikuara me Marrëveshjen ishte edhe mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, fillimisht të caktuara për 24 prill 2016. Si pjesë e Marrëveshjes, më 11 nëntor 2015 u formua Qeveria kalimtare, ndërsa më 15 janar të vitit 2016 Kryeministri i atëhershëm Nikolla Gruevski dha dorëheqje. Në pozitën e Kryeministrit u caktua Sekretari i Përgjithshëm i VMRO-DPMNE, Emill Dimitriev, i cili në njëqind ditët deri në zgjedhje duhej të ishte në krye të Qeverisë. Megjithatë, në janar të vitit 2016, LSDM paralajmëroi se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ndërsa si shkak u theksua mospërbushja e kushteve të Marrëveshjes së Përzghinos, veçanërisht mosazhurnimi i Listët së Zgjedhësve dhe pjesa e reformave në media.⁵¹ Konform Marrëveshjes së Përzghinos, BE dhe SHBA datën 20 shkurt e caktuan si afat brenda të cilës do të vlerësohet se sa janë përmbushur kushtet e mbajtjes së zgjedhjeve të besueshme më 24 prill.⁵² Midis kushteve të parashikuara ishte pastrimi i Listës së Zgjedhësve, reformat në media, ndarja e shtetit nga aktivitetet partiake. Pas skadimit të këtij afati, ambasadorët e BE dhe SHBA në Maqedoni para publikut dolën me qëndrim se edhe përkrah asaj që është arritur një progres i caktuar, megjithatë,

⁵¹ Me Marrëveshjen e Përzghinos dhe Protokollin u parashikua një spektër i gjerë masash për zgjidhjen e krizës politike, në mesin e të cilave emërimi i përbërjes së re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kthimi i LSDM në Kuvend, formimi i Prokurorisë Speciale Publike për shqyrtimin e regjistrimeve të përgjuara, formimi i “Qeverisë kalimtare” në të cilën do të përfshihen edhe ministrat dhe zëvendësministrat e caktuar nga LSDM dhe dorëheqja e Kryeministrit. LSDM me këtë Marrëveshje e fitoi pozitën e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit për Punë dhe Politikë Sociale dhe të zëvendësministrave në resorin e Bujqësisë dhe Financave.

⁵² “LSDM – Bojkot në 24 prill dhe datë e re për zgjedhje”, Radio Evropa e Lirë, 20 janar 2016. I aksesshëm në: <http://www.slobodnaevropa.mk/a/27499957.html> (vizita e fundit: 14 tetor 2016)

nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve kredibile.⁵³ Së këtejmi, data e caktuar e re duhej të ofronte kohë plotësuese për tejkalimin e sfidave ekzistuese, por, ngjarjet të cilat pasuan në mënyrë plotësuese e vështirësuan atmosferën politike. Para ricaktimit zyrtar të zgjedhjeve, më 9 prill, LSDM dhe 17 parti më të vogla politike e nënshkruan platformën për Maqedoni Demokratike me të cilën përsëri u theksuan parakushtet e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta, të ndershme dhe demokratike, megjithatë u paralajmërua edhe bojkotimi i zgjedhjeve.⁵⁴ Njëri grup i protestuesve të organizuar me iniciativën “Protestoj” kërkonin dorëheqje nga Presidenti dhe shtyrje të zgjedhjeve, ndërsa grupi tjetër, i bashkuar nga LQMM (Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë) e mbështesnin qëndrimin e Qeverisë dhe idenë për mbajtjen e zgjedhjeve më datë 5 qershor. Në periudhën që pasoi, dy partitë më të mëdha politike dhe nënshkruese të Marrëveshjes së Përzghinos edhe më tutje kishin divergjenca në qëndrimet e tyre lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të cilat u ricaktuan për 5 qershor të vitit 2016. VMRO-DPMNE e mbante qëndrim se zgjedhjet e parakohshme. LSDM konsideronte se është i nevojshëm zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Përzghinos, si garanci e vetme për mbajtjen e zgjedhjeve të ndershme dhe kredibile. Meqë kushtet e Marrëveshjes nuk u plotësuan, LSDM e mbajti qëndrimin e vet për t’i bojkotuar zgjedhjet, ndërsa BDI dhe PDSH dolën me qëndrim se janë të pranueshme vetëm zgjedhje inkluzive në të cilat do të merrnin pjesë të gjitha partitë politike.⁵⁵ Pas përpjekjeve të pasuksesshme që partitë të arrijnë marrëveshje, më 11 maj VMRO-DPMNE e vetmja nga katër partitë nënshkruese të Marrëveshjes së Përzghinos paraqiti lista të kandidatëve për pjesëmarrje në

⁵³ BE dhe SHBA e përcaktuan afatin: deri më 20 shkurt do ta bëjnë vlerësimin se a ka kushte për zgjedhje, Telegraf, 29 janar 2016. I aksesshëm në: <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-340495-eu-i-sad-si-zadadoa-rok-do-20-februari-ke-ocenuvaat-dali-ima-uslovi-za-izbori.nsp> (vizita e fundit: 21 nëntor 2016)

⁵⁴ Me 83 vota “PRO”, 3 vota “Kundër” dhe asnjë “Abstenim”, VMRO-DPMNE, BDI dhe PDSH i votuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor me të cilat u përcaktua datë e re e zgjedhjeve, 5 qershori, dhe shpërndarja e Kuvendit më 7 prill. LSDM nuk mori pjesë në këtë seancë.

⁵⁵ Uniteti i kontestoi zgjedhjet pra Gjykatës Kushtetuese, Dojçe Vele, 25 tetor 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/унитети-ги-оспори-изборите-пред-установен-суд/a-36148913open_in_new (vizita e fundit: 11 nëntor 2016)

zgjedhje. LSDM, BDI dhe PDSH u tërhoqën dhe nuk paraqitën lista të tyre. Mundësia për mbajtjen e zgjedhjeve vetëm me një parti është në kundërtënie me vet konceptin e pluralizmit politik dhe pas kësaj më 16 maj erdhi kritika e Komisionit Evropian për mosekzistimin e kushteve minimale për mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme dhe demokratike më 5 qershor.⁵⁶

4.1 Periudha pas zgjedhjeve 2016

Ngjarjet e këtilla kulminuan me nismën e BDI-së të paraqitur më 15 maj, e cila kishte për qëllim të rishikohet aspekti kushtetues i vendimit për shpërndarjen e Kuvendit, me ç'rast më 18 maj, Gjykata Kushtetuese miratoi masë të përkohshme për ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve zgjedhore deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës⁵⁷. Po atë ditë, kryetari i Kuvendit Veljanoski caktoi seancë, e thirri përbërjen paraprake dhe pas kësaj pasoi ndryshimi i Kodit Zgjedhor, me të cilin 5 qershori u fshi si datë e zgjedhjeve.⁵⁸ Pas votimit në Kuvend të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve, të cilët rezultuan nga Aneks Marrëveshja e fundit e Përzghinos (Përzghino 2), më 31 gusht u mbajt edhe një takim i liderëve në të cilin u konstatua se është plotësuar ajo për të cilën paraprakisht kanë rënë dakord dhe u caktua data për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor.⁵⁹ Megjithatë, edhe periudha pas caktimit të datës për zgjedhje u përcoll me ngjarje të caktuara. Çështja e numrit joproporcional të

⁵⁶ Bruksel: Nuk ka as kushte minimale për zgjedhje më 5 qershor, Dojçe Vele 16 maj të vitit 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/брисел-нема-ни-минимум-условиза-избори-на-5-јуни/a-19260597 (vizita e fundit: 10 nëntor 2016)

⁵⁷ Kuvendi vendosi – nuk ka zgjedhje më 5 qershor, 24 Vesti, 18 maj 2016. I aksesshëm në: <http://24vesti.mk/sobranieto-odluchi-nema-izbori-na-5-juni> (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

⁵⁸ Të gjithë deputetët e pranishëm e mbështetën këtë vendim me përjashtim të PDSH e cila nuk mori pjesë në aktin e votimit.

⁵⁹ Më datë 31 gusht u mbajt takimi i liderëve të katër partive më të mëdha politike në të cilin në fokus ishte çështja se a ekzistojnë kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në dhjetor. Në këtë takim, liderët ranë dakord për datën e zgjedhjeve të parakohshme – 11 dhjetor, si dhe për masa të tjera plotësuese të cilat rezultojnë nga Marrëveshja e Përzghinos.

votuesve në njësitë zgjedhore dhe iniciativa për rikonfiguracionin e njësive zgjedhore ishte njëra nga çështjet më aktuale. Me fjalë të tjera, tek një pjesë e qytetarëve mbizotëronte qëndrimi se moszgjidhja e kësaj çështjeje mund ta vë në pikëpyetje legjitimitetin dhe ligjshmërinë e zgjedhjeve, dhe së këtijmi mund të shfrytëzohet si alibi nga ndonjëra prej partive e cila do të ishte e pakënaqur me rezultatet e zgjedhjeve që zgjedhjet t'i shpall për jolegjitime.⁶⁰ Gjithashtu, më së voni deri më 3 nëntor, tre ditë nga formimi i KKZ, KSHZ deri te KKZ i dërgoi të dhënat për të punësuarit në administratën shtetërore dhe komunale, në administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratën publike me vendbanim në territorin në juridiksion të KKZ, me qëllim të formimit, përkatësisht plotësimit të këshillave zgjedhorë (KZ) me anëtarë të rinj në vendet e atyre të cilëve iu ka pushuar mandati. Si plotësim të kësaj, deri më 2 nëntor KSHZ dërgoi kërkesë deri te partitë politike në opozitë dhe pozitë, me numër më të madh të votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, të paraqesin propozime të anëtarëve të KZ dhe zëvendësve të tyre me qëllim të formimit, përkatësisht plotësimit të KZ. Partitë e kishin për detyrë më së voni deri më 7 nëntor, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të të dhënave nga KSHZ t'i paraqesin, përkatësisht dërgojnë propozimet e tyre në KKZ, të cilët pastaj, në bazë të të dhënave të pranuara i formuan KZ-të. Sa i përket zbatimit të votimit jashtë vendit, afati i formimit të KZ ishte 8 nëntori. Në përputhje me Kodin Zgjedhor, 10 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve KSHZ e vë në këqyrje publike Listën e Zgjedhësve në faqen e saj të internetit <http://izbirackispisok.gov.mk>, në njësitë e veta rajonale dhe në zyrat e vendit, si dhe në PDK. Për këto zgjedhje, këqyrja në Listën e Zgjedhësve zgjati nga 28 tetori deri më 11 nëntor. Në afat prej 5 ditësh pas përfundimit të këqyrjes, më së voni deri më 16 nëntor, KSHZ-ja ua dërgon partive politike Listën e Zgjedhësve, të cilat pastaj në afat prej 5 ditësh, deri më datën 21 nëntor, mund të paraqesin

⁶⁰ Të gjitha partitë kanë alibi për humbje në zgjedhje, Radio Evropa e Lirë, 18 tetor 2016. I aksesshëm në: <http://www.slobodnaevropa.mk/a/28060549.html> (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

kërkesa për regjistrime, plotësime ose shlyerjen e të dhënave. Komisioni për kërkesat vendos në afat prej 3 ditësh, më së voni deri më 24 nëntor. Dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, më 1 dhjetor, KSHZ e nënshkruan Listën përfundimtare të Zgjedhësve. Sipas Agjendës, raportet financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore paraqiten në KSHZ, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), në afatet si vijojnë: • më 1 dhjetor për të ardhurat dhe shpenzimet në 11 ditët e para të fushatës; • më 10 dhjetor për të ardhurat dhe shpenzimet në gjysmën e dytë të fushatës; • raportet financiare përfundimtare paraqiten menjëherë, ndërsa më së voni deri në 30 ditë nga mbyllja e llogarive të transaksionit dhe shpallen publikisht në ueb-faqen e KSHZ, ESHT dhe KSHPK; • radiodifuzerët dhe mediat e shkruara në Republikën e Maqedonisë e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore edhe atë jo më vonë se 15 ditë pas ditës së përfundimit të fushatës zgjedhore. Sa i përket vëzhgimit të zgjedhjeve, sipas Agjendës, paraqitja e kërkesave për vëzhgim në KSHZ fillon më 18 tetor dhe zgjatë deri më 6 dhjetor, përkatësisht më së voni 5 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Më së voni 2 ditë pas pranimit të kërkesës, KSHZ u lëshon autorizim vëzhguesve. Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor rezultuan si pjesë e Marrëveshjes së Përzghinos. Në seancën e 75 Kuvendi, me procedurë të shkurtuar, e miratoi pakon e ligjeve përfshirë edhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor,²⁰ të cilat rezultojnë nga Marrëveshja e Përzghinos dhe nga takimi i liderëve, ndërsa kanë për qëllim krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të ndershme dhe legjitime. Këto ndryshime u referohen aspekteve thelbësore të procesit zgjedhor, si vijon:

- Modeli zgjedhor me gjashtë njësi zgjedhore në territorin e Republikës së Maqedonisë mbetet i pandryshueshëm. Ndryshim ka në njësitë zgjedhore të diasporës, me ç'rast tri njësitë

zgjedhore të deritanishme (NJZ 7, NJZ 8 dhe NJZ 9) u zëvendësuan me një njësi zgjedhore – NJZ 7, e cila i përfshinë të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë në Evropë, Azi, Afrikë, Amerikën Veriore dhe Jugore dhe Australi. Deputetët në NJZ 7 do të zgjidhen sipas modelit proporcional. Kjo nënkupton se numri i nevojshëm i votave që të zgjidhet një deputet në NJZ 7 duhet të korrespondojë me minimumin e votave të cilat i ka fituar deputeti i cili është zgjedhur me numër më të vogël të votave në ndonjërin nga njësitë zgjedhore në zgjedhjet paraprake parlamentare.

- Ndalohet përdorimi i hapësirave të zyrave, pajisjes dhe automjeteve zyrtare të organeve shtetërore për nevojat e fushatës zgjedhore, përveç nëse ndryshe nuk është përcaktuar me ndonjë akt tjetër.

- Si pjesë e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor u parashikua edhe Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike 21, i cili do të nënshkruhet nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Me këtë Kodeks pjesëmarrësit obligohen të mos bëjnë presione mbi të punësuarit në administratën publike shtetërore ose në institucione të tjera të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Veç tjerash, Kodeksi ka për qëllim të garantoj se mbështetja, përkatësisht mosmbështetja të cilësdo qoftë partie ose të kandidatit nga ana e qytetarëve, pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nuk do ta shfrytëzojnë si instrument për kërcënim lidhur me vendin e punës ose me sigurinë sociale.⁶¹

- Përbërja e KSHZ u ndryshua, nga shtatë anëtarët paraprak në nëntë anëtarë. Në këtë përbërje bëjnë pjesë: kryetari, nënkryetari dhe 7 anëtarë. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ u ndryshua. Me ndryshimet e reja tre anëtarë propozojnë partitë politike në pushtet, me

⁶¹ Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, nëntor 2016. I aksesshëm në: <https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zTGdoMmZIZjV4UkE/view> (vizita e fundit: 21 nëntor 2016).

ç'rast partia në pushtet me numër më të madh të deputetëve në Kuvend propozon dy anëtarë, ndërsa partia e dytë, sipas numrit të deputetëve në pozitë, propozon një anëtar. Partitë e opozitës propozojnë tre anëtarë, me ç'rast partia opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend propozon dy anëtarë, ndërsa partia opozitare e dytë për nga madhësia e numrit të deputetëve propozon një anëtar. Tre anëtarë do të zgjidhen përmes konsensusit, të cilët do ta përfaqësojnë publikun ekspert. Me ndryshimet u instalua edhe funksioni Sekretar i Përgjithshëm i KSHZ i cili ka për qëllim përforcimin e pjesës administrative. Sekretari i Përgjithshëm nuk është pjesë e përbërjes së KSHZ dhe nuk ka të drejtë vote. Ndryshimet plotësuese të Kodit Zgjedhor përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me Listën e Zgjedhësve. KSHZ u përcaktua si institucioni i vetëm kompetent për udhëheqjen dhe azhurnimin e Listës së Zgjedhësve. KSHZ siguron qasje elektronike deri te Lista e Zgjedhësve në përputhje me aktet normative. KSHZ e publikon Listën e Zgjedhësve në ueb faqen e vet, me ç'rast çdo qytetar ka të drejtë të paraqes kërkesë në KSHZ që adresa e tij të mos shpallet publikisht për shkaqe sigurie. KSHZ e bën azhurnimin e Listës së Zgjedhësve një herë në muaj, ndërsa në çdo 6 muaj shpall thirrje publike deri te qytetarët që të bëjnë këqyrje në të dhënat e tyre. Veç tjerash, me qëllim të përcaktimit të autenticitetit të Listës së Zgjedhësve, çdo anëtar i KSHZ mund të kërkoj të bëhet këqyrje në evidencën e MPB për lëshimin e dokumenteve biometrike, si dhe në bazat e të dhënave dhe në evidencat e qytetarëve të organeve dhe institucioneve tjera shtetërore. KSHZ miraton Rregullore për metodologjinë e udhëheqjes dhe azhurnimit të Listës së Zgjedhësve të bazuar mbi kontrolle dhe analiza statistikore, kontrolle të kryqëzuara të bazave të ndryshme të të dhënave dhe evidencave, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda të tjera të njohura të kontrolleve, si dhe Rregullore për metodologjinë e qasjes së plotë, kryerjes së ndryshimeve dhe shlyerjes së të dhënave në Listën e Zgjedhësve, si dhe procedurë për zbatimin e kontrolleve në terren, me qëllim të

azhurnimit të të njëjtës. Në kategorinë e prezantimit mediatik, me ndryshimet e Kodit Zgjedhor për herë të parë përfshihen edhe mediat elektronike (portalet e internetit), të cilat si edhe radiodifuzerët dhe mediat e shkruara të cilat e mbulojnë procesin zgjedhor e kanë për detyrë të punojnë në përputhje me Kodin Zgjedhor. Gjithashtu, ndalohet financimi dhe donimi i partive politike nga mediat dhe personat të lidhur me ata, si dhe inkorporohet ndalim për transmetimin e reklamave të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor fokusi u vu mbi mundësimin e qasjes së barabartë dhe të balancuar të partive politike në hapësirën reklamuese. Pas shtyrjes së zgjedhjeve të planifikuara të parakohshme parlamentare të 5 qershorit, ndërkaq si pjesë e raundit të ri të negociatave ndërpartiake, më 20 korrik, katër partitë më të mëdha politike arritën marrëveshje të re, Aneks të Marrëveshjes së Përzahinos (Përzahino 2), me të cilën, mes tjerash, u parashikuan ndryshime edhe në Kodin Zgjedhor.

Më 28 korrik u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor⁶². Ndryshimet e këtij Kodi kryesisht kanë të bëjnë me reformat e mediave: • Formimi i autoritetit ad-hok në kuadër të Agjencisë për Shërbime Meidatike Audio dhe Audiovizive, përkatësisht formimi i Komisionit të Përkohshëm Pesë-anëtarësh për monitorimin e përfaqësimit mediatik ka për qëllim monitorimin e raportimit mediatik në periudhën parazgjedhore. Mandati i këtij Komisioni do të zgjas deri në përfundimin e procesit zgjedhor.⁶² Caktimi i redaktorit të ri të programit informativ të Servisit Publik Radiodifuziv. Redaktori do të zgjidhet me propozim të partisë opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend, ndërkaq sipas konsultimit paraprak me dy partitë politike në pushtet me numër më të madh të deputetëve në Kuvend dhe

⁶² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 142 nga 1 gushti 2016. I aksesshem në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 11 nëntor 2016)

me partinë politike në opozitë e cila është parti e dytë opozitare për nga numri i deputetëve në Kuvend.

4.2Ndryshimi i emrit

Me shpalljen e pavarësisë, Maqedonia fitoi të drejtën e shkëputjes nga ish- Jugosllavia, duke përfutur sovranitetin e plotë. Por kjo periudhë në dukje e favorshme për Maqedoninë do të kishte koston e saj të faturuar nga fqinjët, e cila lidhet me problemet për çështjet e identitetit, gjuhës, emrit, kishës, kombit. Në të vërtetë të tria vendet fqinje të Maqedonisë mbajnë hapur çështje kontestuese ndaj saj: Greqia çështjen e emrit, Bullgaria çështjen e gjuhës, Serbia çështjen e kishës. Nga të gjitha kontestimet me të cilat përballet Maqedonia, më problematike mbetet ajo me Greqinë për emrin. Republika e Maqedonisë ka contest ndërkombëtar të hapur dhe të pa zgjedhur me Republikën e Greqisë, bëhet fjalë për një contest bilateral por edhe me pasoja praktike mbi shtetet e treta , në kuadër të forumit multilateral të OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombetare.

Me gjithë përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë, veçanërisht të SHBA-ve për zgjidhjen e problemit, kontesti mes Maqedonisë dhe Greqisë është kthyer në një problem vetëm rajonal. Çështja e emrit shihet në këndvështime të ndryshme si një problem mes Maqedonisë dhe Greqisë, por edhe si një problem që ka rrënjë të thella.

a) Sa i rëndësishëm është emri i Maqedonisë për të dyja palët?

b) Pasojat e vërteta të këtij kontesti?

Territori i Maqedonisë përfshinë pjesën qendrore të Ballkanit ku pozita e saj gjeografike shërben si një urë lidhëse për vendet fqinje dhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Emri Maqedoni ka rrënjë të thella dhe aspak nuk bëhet fjalë për ndonjë popull apo etnitet por, bëhet fjalë vetëm për një territor i cili përfshin pjesën e Detit Egje në Jug, Liqenit të Ohrit, Lumit Mesta në Lindje dhe vargun e maleve të Sharrit në Veri. Pozita gjeostrategjike e Maqedonisë është e rëndësishme dhe tangon thellë në gërshetimin e interesave të shteteve fqinje, atyre të Ballkanit dhe të vendeve më me ndikim në Evropë dhe më gjerë. Sa i përket nocionit të identitetit, kemi të bëjmë me veçoritë kryesore të individit, kolektivitetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Me këtë nënkuptojmë gatishmëri për njohjen e vetvetes, bashkësisë dhe kombit, gatishmëri e cila paraqet shtyllë dhe segment kryesor të formimit dhe funksionimit të një shteti që synon vlerat demokratike dhe avancuese. Duke u nisur nga identiteti kolektiv, si njëri ndër pjesët përbërëse të identitetit, mund të shtojmë se identiteti shoqëror dhe shtetëror i Maqedonisë përfshihet drejtpërdrejtë në kontest të hapur shumëvjeçar me fqinjin jugor, për të cilin shteti i Maqedonisë kërkon zgjidhje me qëllim të arritjes së vlerave të mirëfillta, përmes integritetit të vendit në strukturat euroatlantike. Proceset integruese, paraqiten si njëra ndër vlerat thelbësore për shoqëritë bashkëkohore, sidomos për vendet e Ballkanit, vendet të cilat pikërisht përmes integritetit synojnë arritjet maksimale dhe avancimet brendashoqërore. Republika e Maqedonisë përmes integritetit gjen veten e saj në përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë që jeton brenda kufijve të saj.⁶³

Kontestin të cilin e kam marrë për studim hasë në rrënjë të thella dhe të kah motshme. Pikë së pari e shohim të arsyeshme që të cekim se emri Maqedoni ka rrënjë të thella dhe se aspak

⁶³ Mr. Bujar Zylfiqari, Maqedonia – Identiteti dhe Integriteti, Autori është magjistër i Diplomasë në Fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, aktualisht i punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes së RM-së, bujarzylfiqari@gmail.com

nuk bëhet fjalë për ndonjë popull apo etnitet, por bëhet fjalë vetëm për një territor.⁶⁴
Fillimet e kontestimeve rreth Maqedonisë datojnë që në mesin e viteve '70 të shek XIX.

Me shpërthimin e Revolucionit Francez, nis edhe kriza në Ballkan. Në fillim serbët dhe bullgarët duke ndjekur politikën e Rusisë, interesimin dhe përkrahjen e saj ndaj tyre, nisën trazirat dhe shpallën kërkesë për pavarësi nga Perandoria Osmane. Revoltat ndaj Perandorisë Osmane shënojnë dhe fillimin e 'krizës lindore', e cila do të përfshinte edhe fuqitë e mëdha në zgjidhjen e saj. Kështu Rusia do t'i shpallte luftë Turqisë, kjo do të çontë në thellimin e krizës, me përfundimin e luftës ruso-turke, Maqedonia do të njohë momentin kryesor të kontestimeve rreth saj. Rusia fituese do të përcaktonte rregullat e lojës në Traktatin e Shën Stefanit, i mbajtur në mars 1878. Kostoja e humbjes së Perandorisë Osmane do të pasonte në krijimin e një shteti të ri bullgar, të zgjeruar në territoret e Maqedonisë së sotme. Në çështjen e emrit të Maqedonisë, kontesti në mes Grekeve dhe Maqedonasve është më i thellë sepse preken çështje egzistenciale të dy këtyre kombeve.⁶⁵

Maqedonia politike që u shfaq në hartat e VMRO-s në fillim të shek XX (20) është ajo që e frikëson Greqinë andaj çdo konotacion nacional i emrit Maqedoni është i papranueshëm për Greqinë ndërsa "maqedonasit" kombin e kanë të lidhur me emrin për shkak të kohezionit nacional, emri Maqedoni ka rëndësi egzistenciale sepse mbi këtë emer kombëtar dhe shtetëror dëshirojnë të mbajnë ekskluzivitetin etnik në këtë shtet. Në esencë kemi kontest në mes dy shteteve që janë krijuar mbi logjikën Staliniste të kombë formimit kur shteti ka formuar kombin. Pikërisht defektetë tyre janë të karakterit historik Sërbët formuan shtetin e tyre prej pashallëkut të Beogradit duke u marrë territore Hungarezeve, Bullgarëve dhe Shqiptarëve.

⁶⁴Dr. Alban Daci, "Një bashkëjetesë e "detyruar" mes Sllavo-maqedonasve dhe Shqiptarëve", <http://ëëë.forumivirtual.com/analiza/21868-ceshtja-e-maqedonise.html>

⁶⁵ <https://ëëë.scribd.com/document/116132813/Thelbi-i-Kontestit-Greqi-Maqedoni>

Greket u bënë shtet mbi modelin e Bizantit me një popullsi të përzier sllavobullgare,arvanite,came ,vllehe munduan të zbatojnë ideologjinë heleno-greke mbi popullatën e përzier përmes represionit ndërsa kombi maqedon u bë një krijim kominternian mbi logjikën staliniste të kombeve me involvimin e interesit serb. Ky kontest ka rrjedhën dhe vazhdimësinë e saj edhe në vitet në vazhdim, e sidomos gjatë viteve 1911-1913⁶⁶,kur fillojnë luftërat ballkanike dhe krijohen edhe Aleancat Ballkanike,fillimi i luftërave ballkanike dhe krijimi i Aleancës Ballkanike kishin qëllimin kryesor marrjen nën sundim të tokave të quajtura Maqedoni, të cilat në atë kohë llogariteshin si tokë e askujt.Në këto marrëveshje, rolin kryesor e kishte Rusia, e cila nuk kishte ndikim direkt, për shkak të problemeve që mund t'i ndodhin me fuqitë e tjera të mëdha, por ajo ndikimin indirekt e kishte nëpërmjet aleates së saj në Ballkan, Serbisë.

Luftërat ballkanike përfundojnë me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet shteteve ballkanike për formimin e aleancave ballkanike. Marrëveshja përfundimtare është nënshkruar më 10 gusht të vitit 1913 kur në Konferencën e Bukureshtit vendoset ndarja e Maqedonisë në atë të Egjeut (që do t'i takonte Greqisë), Pirinit (Bullgarisë) dhe Vardarit (Serbisë). Para se të shqyrtojmë mënyrat e zgjidhjes së konfliktit në mënyrë paqësore në të Drejtën Ndërkombëtare, duhet të kuptojmë se çfarë është konflikti ndërkombëtarë në vetvete.**Konflikti mund të përkuqizohet si një ndryshim në përfundimet e arritura të parapëlqyera të një rrethane përpjekjesh për marrvëshje.**⁶⁷Konflikti mes shteteve nuk është një rrethanë e pazakonshme, përkundrazi është mëse e zakonshme dhe sigurisht do ekzistojnë gjithnjë. Në të tilla konflikte të përpjekjeve për marrvëshje, shtetet zhvillojnë aftësi që u japin atyre mjete ndikimi për të fituar përfundime më të përshtatshme sesa çmund të kishin fituar pa këtë mjet.Për zgjidhjen e konfliktit

⁶⁶ Ky kontest ka rrjedhën dhe vazhdimësinë e saj edhe në vitet në vazhdim, sidomos gjatë viteve 1911-1913

⁶⁷Joshua S. Goldstein- *Marredheniet Nderkombetare*; Shtepia Botuese Dituria, 2003 (fq.195)

gjithnje jemi përpara dy rrugëve. Të zgjidhjes së konfliktit në mënyrë paqësore ose në kundërshtim me të parën është rruga e dytë, lufta. Praktika ka treguar se zgjidhja e konflikteve me mënyrën e parë, pra zgjidhjen paqësore të tyre, është kurdoherë rruga më e thjeshtë më ekonomike dhe si rrjedhojë më e drejtë. Ndërsa “zgjidhja” me luftë për shumë autor nuk është një zgjidhje, por thjesht një arsye për të nisur një konflikt. Për disa të tjerë një përfundim i keq. Kështu, shkrimtari i njohur romak Seneka, rreth 2 mijë vjet më parë shkruan për luftën: “Nga njerëzit e luftës mos kërkon shkaku, por përfundimin”⁶⁸

Sot ky postulat është i vështirë për tu pranuar pasi shkencëtarët e politikës gjithnjë e më shumë janë në kërkim të shkaqeve të luftës. Megjithatë ajo që do të trajtojmë ne është e kundërta e luftës dhe në objektin tonë do jenë mënyrat e zgjidhjes së konfliktit në mënyrë paqësore, pa dhunë, pa luftë metode kjo e mirëpranuar ndërkombëtarisht dhe në pamje të parë funksionale.

- *Tipologjia e Mosmarrveshjeve*

Kontestimet territoriale dhe kufijtë janë një shqetësim i tëdy interesave material që përfaqësojnë shtetet por edhe një pikpyetje ndaj gjeografisë sociale dhe lidhjeve tradicionale rajonale. Është interesante hartimi i një tipologjie të mosmarrëveshjeve. Sigurisht, kontestimet territoriale dhe kufijtë kanë karakteristikat relativisht të veçanta. Në radhë të parë, ato janë pjesë e shteteve fqinje dhe për këtë arsye mund të gjenerojë probleme të rendit publik. Së dyti, procesi i zgjidhjes paqësore mund të bëhet vetëm një vit ose dy pas një konflikti të armatosur në lidhje me një çështje shumë të njëjtë e cila edhe mund të rritet në një konflikt të armatosur. Një rast i tillë ka qenë çështja nr. 9 e Kamerunit kunder Nigerisë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

⁶⁸**Hercules Furens Seneca-** *Seneca Tragedies*; Vol 1; Perkth. Nga F.J.Miller; London, 1917

Së treti, zona e përfshirë në një mosmarrëveshje kufitare mund të përfshijë popullsitë rajonale dhe lidhjet historike e të cilave mund të kërcënohen, si një rezultat i drejtpërdrejtë i përcaktimit të kufirit *të tokës*.

Në vazhdim do t'i trajtojmë këto mjete për zgjidhjen paqësore të konflikteve apo kontesteve mes shteteve:

1) Bisedimet e drejtpërdrejta

2) Shërbimet e mira;

3) Ndërmjetësimin;

4) Komisionet anketuese;

5) Pajtimin;

6) Arbitrazhin.

Bisedimet janë një ndër mënyrat më të thjeshta më të rëndësishme e më të përhapura të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis shteteve. Rrëgullisht i paraprijnë përdorimit të mjeteve të tjera për zgjidhjen paqësore. Bisedimet varen nga vullneti i palëve në konflikt të cilat përmes një kontakti të drejtpërdrejtë provojnë të gjëjnë zgjidhjen që do të ishte e pranueshme për tëdy palët. Efekti i tyre i parështë zvoglimi i kundërthënies dhe rënia e tensionit. E drejta ndërkombëtare nuk përcakton mënyrat e zhvillimit të bisedimeve as afatin brenda të cilin duhet përfunduar.⁶⁹

Normalisht kërkohet që palët të udhëhiqen nga vullneti i mirë për të gjetur zgjidhjen dhe të përjashtohen presionet, kërcnimet, diktatet etj. Negociatat mund të jenë dypalëshe ose

⁶⁹ Zejnulla Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003, fq.415

shumëpalëshe, nëse në mosmarëveshje bëjnë pjesë e përfaqësuesve disa shteteve. Ato mund të zhvillohet me gojë me takimet të drejtpërdrejta të përfaqësuesve të shteteve të interesuara ose me shkrim. Mënyra e fundit praktikohet për çështje të rëndësishme. Bisedimet fillojnë me një deklaratë, e cila përmban qëndrimin e njërës palë. Pas kësaj, shtete këmbëjnë mendime, duke vënë në peshojë të drejtat e shtetit tjetër dhe të drejtat e veta derisa kjo zgjidhet.⁷⁰

a) Bisedimet e drejtpërdrejta

Bisedimet e drejtpërdrejta janë forma më e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Përmes kësaj forme, përfaqësuesit e shteteve provojnë të gjejë zgjidhje duke këmbëyer mendimet dhe argumentet.⁷¹

Shtetet preferojnë këtë formë, pasi kjo u mundëson relaksim dhe komoditet në zgjidhjen e problemeve. Këtu palët nuk i nënshtrohen aq shumë presionit nga opinioni, kurse përmes mesazheve optimiste palët relaksojnë ambientin politik, dhe kështu më lehtë krijojnë kushte të volitshme për t'i zgjidhur çështjet kontestuese. Bisedimet mund të jenë dypalëshe, pra drejtpërdrejtë në mes vet palëve në konflikt dhe shumëpalëshe, në konferenca dhe tubime ndërkombëtare. Zakonisht bisedimet zgjasin disa ditë, kurse në situata më të komplikuar zgjasin edhe shumë gjatë, gjersa të arrihet ndonjë kompromis. Megjithatë, jo gjithnjë bisedimet përfundojnë me sukses. Shpesh kemi edhe dështime të bisedimeve. Ana negative e bisedimeve të

⁷⁰Po aty, fq.415

⁷¹Shih. Thirlëay H, The Law and Procedure of the International Court of Justice 1960-1989, British Yearbook of International Law, 1992, pp. 5-6.

drejtpërdrejta është se këtu nuk kemi palën e tretë si ndërmjetësues, kështu që palët e kanë më vështirë vet të japin propozime të reja.

b) Shërbimet e mira

Kjo formë vjen në shprehje kur në mes palëve marrëdhëniet janë shumë të acaruar dhe vështirë që mundet vet të vendosin kontakte të drejtpërdrejta. Kështu që në këto raste mund të vjen ofertë nga ndonjë palë e tretë (shtet, organizatë apo personalitet), për ndërmjetësim në fillimin e bisedimeve të drejtpërdrejta. Në këtë rast pala e tretë do të ishte transmetuese e propozimeve prej njëres në palën tjetër dhe anasjelltas. Pra, këtu pala e tretë nuk paraqet propozime apo vizione të vetat për tejkalimin e kontestit. Qëllimi kryesor i shërbimeve të mira është vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta në mes palëve në konflikt.⁷²

c) Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi (mediacioni)⁷³ është shumë i përafërt me shërbimet e mira. Dallimi qëndron në atë se pala e tretë merr pjesë drejtpërdrejtë në dhënien e sugjerimeve apo propozimeve konkrete për zgjidhjen e një kontesti. Konventa e Hagës për zgjidhjen e kontesteve në mënyrë paqësore (1907), ndërmjetësimin e definon si procedurë që ka për qëllim pajtimin e kërkesave të kundërshtuara dhe qetësimin e ndjenjës së keqësimit që kanë palët në konflikt. Zakonisht për

⁷²Kryetari i SHBA-së kishte ofruar shërbime të mira në luftën ruso-japoneze, e cila solli gjer te përfundimi i luftës dhe lidhja e Marrëveshjes së Postdamit (1905); Bashkimi Sovjetik ka ofruar shërbime të mira në konfliktin në mes Indisë dhe Pakistanit në vitin 1965. Kështu u realizua takim i drejtpërdrejt mes kryeministrit të Indisë dhe kryetarit pakistanez, me ç'rast u ndërpre lufta mes këtyre dy shteteve.

⁷³Rubin J,Z, Mediation in International Relations, London, 1992.

ndërmjetësues caktohen subjekte apo personalitete me ndikim dhe me autoritet në të dy palët kontestuese, pasi nga autoriteti i tij varet edhe suksesi i bisedimeve. Në të kaluarën kemi pasur raste të shumta ndërmjetësimi. Këshilli i Sigurimit ka vepruar si ndërmjetësues në rastin e Kashmirit (kontestuese në mes Indisë dhe Pakistanit), po ashtu edhe në rastin e Qipros në vitin 1964. Papa Gjon Pali II, me sukses ka ndërmjetësuar në kontestin në mes Argjentinës dhe Kilit për Kanalin Beagle. Edhe Grupi i Kontaktit, ku merrnin pjesë disa shtete, duke përfshirë edhe SHBA, Rusinë, Britaninë e Madhe, kishte rolin e ndërmjetësuesit në konfliktin nëmes Jugosllavisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Kroacisë, me ç'rast u lidhë Marrëveshja e Dejtonit në vitin 1995. Ndërmjetësimi nuk ka karakter obligativ dhe ndërmjetësuesi kry-en punën e vet përderisa palët pajtohen me rolin e tij. Përndryshe, nëse mungojnë rezultatet ai mund të tërhiqet. Ndërmjetësimi ka karakter obligativ nëse parashihet me marrëveshjen e caktuar ndërkombëtare, për shembull, se palët kontestet në mes vete do t'i zgjidhin në atë mënyrë. Pra, rezultati i ndërmjetësimit nuk është i obligueshëm për palët, përveç nëse ekziston marrëveshje paraprake apo ndërkohë lidhet marrëveshje në mes palëve në kontest. Në praktikë shpesh herë ndodh që shtete në konflikt ndërkombëtarë të mos mund t'o shfrytëzojnë bisedimet diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë, për shkak se nuk kanë kontakte të drejtëpërdrejta diplomatike, se vështirë mund të zhvillojë biseda të drejtëpërdrejta për shkak të marrëdhënieve të këqija që kanë, se bisedimet diplomatike kanë dështuar. Se janë nën presionin e opinionit të vet public etj. E drejta ndërkombëtare për këto rastesh ka parashikuar që një palë të tretë që ka ndikim moral mbi palët tu ndihmojnë shteteve në konflikt, për gjetjen e zgjidhjes. Në këtë grup të mjeteve hyjnë shërbimet e mira dhe ndërmjetësimi midis të cilave vështirë që mund të tërhiqet kufiri i saktë. Megjithatë, shumë autorë bëjnë dallimin midis shërbimeve të mira dhe ndërmjetësimit.⁷⁴

⁷⁴ Zejnulla Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003, fq.417

Ndërmjetësimi konsiston në aksionin e një shteti të tretë, të një grupi të shteteve ose të ndonjë personi autoritativ. Shteti i tretë që në cilësinë e ndërmjetësuesit, merr pjesë në bisedime midis palëve në konflikt ose zhvillon bisedime me to, përpiket t'u japë në bisedime midis palëve në konflikt ose zhvillon bisedimet me to, përpiket t'u japë atyre kontakteve kahe për zgjidhjen paqësore, jep këshilla, sugjerime, i përcjell kërkesat dhe përgjigjet nga njëra palë te tjetra, ndërhyt që t'i pajtojë qëndrimet e kundërta etj. Ndërmjetësim mund të ofrohet nga një shtet i tretë ose mund të kërkohet nga palët e interesuara. Pjesa më e madhe në zgjidhjen e konflikteve përdorin një palë të tretë, roli i secilës është ndërmjetësimi, midis dy palëve kështu që janë në konflikt. Roli i ndërmjetësuesit konsiston në zgjidhjen e pretendimeve të kundërta dhe në zbutjen e pakënaqësive që mund të kenë lindur mes shteteve që kanë mosmarrëveshje. Nuk ka asnjë përkufizim standard i ndërmjetësimit por ajo është megjithatë dallohet zakonisht nga pajtimet. Në parim, ndërmjetësimi përfshin sjelljen e drejtpërdrejtë të negociatave mbi bazën e propozimeve të bëra nga ndërmjetësi. Shumica e konflikteve të sotme ndërkombëtare kanë një ose më shumë palë ndërmjetëse që punojnë rregullisht për të zgjidhur konfliktet pa dhunë. Nuk ekziston ndonjë rregull i pandryshueshëm i cili të përcaktojë se çfarë lloji palësh të treta duhet të ndërmjetësojnë këtë apo atë lloj konflikti.

Në rast mosmarrëveshjeje serioze ose konflikti, para se t'i drejtohen gjykatës, shtetet kontraktuese bien dakord që kanë të drejtë, aq sa e lejojnë rrethanat, t'i drejtohen palëve të treta ose ndërmjetësimit të një ose më shumë shteteve mike. Pavarësisht nga kjo e drejtë, shtetet kontraktuese konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme që një ose më shumë shtete, jo palë në konflikt, duhet, me iniciativën e tyre dhe aq sa e lejojnë rrethanat, të ofrojnë ndihmën e tyre apo ndërmjetësimin për shtetet që janë në mosmarrëveshje. Shtetet që nuk janë pjesë e konfliktit kanë të drejtë të ofrojnë ndihmën e tyre apo të ndërmjetësojnë edhe gjatë gjendjes së

luftës. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund të konsiderohet nga asnjëra prej palëve në mosmarrëveshje, si një akt armiqësor. Ndërmjetesuesja më e rëndësishme në skenën botërore sot është OKB-ja. Megjithatë për disa konflikte të tjera rajonale kanë ndërmjetësuar organizata rajonale, si psh Bashkimi Europian ose Organizata e Shteteve Amerikane. Në këto raste ndërmjetësues mund të jetë një shtet i caktuar ose edhe një individ i veçantë. Raste të kësaj të fundit ka shume, mjafton të kujtojmë ish- Presidentin e Kosta Rikes, Oskar Aria, i cili fitoi çmimin Nobel për paqë (1987) për ndërmjetësimin që bëri midis disa presidenteve të Amerikës Qendrore, çka shënoi edhe fundin e luftërave të ashpra në Rajon. Një president tjetër me një rol të fuqishëm në ndërmjetësim ishte edhe Xhimi Karter, i cili doli si ndërmjetësues i konflikteve ndërkombëtare. Ai arriti të bëjë marrëveshje me Korëne e Veriut në lidhje me përhapjen e armëve bërthamore, në Haiti në lidhje me tranzicionin demokratik, si dhe në Bosnjë e Sudan për armëpushim. Megjithatë secila marrëveshje u kritikua. Sepse, marrëveshja e Korëse së Veriut i dha kohë asaj që të zhvillonte programin bërthamor, marrëveshja për Haitin funksionoi vetëm për shkak të një kërcënimi të hapur për përdorim forcash ushtarake, ndërsa armëpushimi në Bosnjë zgjati vetëm një dimër kur sidoqoftë bora parandaloi shumë luftime.

Ndërmjetësimi mund të jetë i larmishëm. Praktika moderne përmban një shembull të rëndësishëm të një ndërmjetësimi efektiv. Kjo ishte Ndërmjetësimi i Papës në vitet 1978-1984 në mes të Kilit dhe Argentinës. Dy shtetet pranuan zyrtarisht ndërmjetësimin e Selisë së Shenjtë në Marrëveshjen e nënshkruar më 8 janar 1978. Ndërmjetësimi zgjati pesë vjet dhe rezultoi në një perfundim si Traktati i Paqes dhe Miqësisë, nënshkruar më 29 nëntor të 1984. Shembuj të tjerë modernë të ndërmjetësimit ekzistojnë. Ato përfshijnë ndërmjetësimin e Bashkimit Sovjetik në mes të Indisë dhe Pakistanit mbi Ranin e Kutcin në 1961-‘67 dhe ndërmjetësimin e Algjerisë mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me krizën e pengjeve në 1980-1981.

d) Komisionet anketuese

Shpesh herë ndosh që bisedimet të arrijë në pikën e vdekur për shkak se dy shtete nuk pajtohen në lidhje më përshkrimin dhe vlerësimin e ndonjë ngjarje që janë shkak i mosëmarrëveshjes. Duke u nisur nga kjo, Konventa e Hagës mbi zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjes ndërkombëtare ka parashikuar që në secilin rast të mosmarrëveshjes ndërkombëtarë nuk prek nderin dhe interes vitale të shtetit, dhe që është rezultati i mospajtimit lidhur me vlerësimin e gjendjes faktike, do të krijohet një komision hetues po që se pajtimi nuk është arritur me anë diplomatike, me detyrën që të lehtësojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke i ndriçuar faktet me hetime asnjënjëse dhe të ndërgjegjshme.

Komisioni i anketës mund të krijojë nëse ndryshe nuk është parashikuar krijohet si gjygi i arbitrazhit. Në fillimi krijoheshin nga një numër i njëjtë përfaqësuesish të shteteve në konflikt. Komisioni i anketës ka për detyrë të shqyrtojë të konstatojë dhe të parashtojë mendimin e vet mbi gjendjen faktike. Për këtë qëllim Komisioni i ftonë palët që të parashtojnë qëndrimin e vet në lidhje me ngjarjen, t'i dorëzojë dokumentacioni përkatës mund të ftojë dëshmitarë dhe ekspertë, mund të bëjë ekspertizë dhe ekzaminime nëse është nevoja.⁷⁵ Komisioni anketues po ashtu parashihet nga Konventat e Hagës për zgjidhjen e kontesteve në mënyrë paqësore. Gjatë bisedimeve mund të ndodhë që palët një gjendje faktike ta trajtojnë diametralisht ndryshe njëra prej tjetrës. Në këtë rast parashtrohet nevoja e konstatimit të gjendjes së vërtetë faktike, me qëllim të eliminimit të dallimeve në mes palëve në konflikt. Kështu, komisioni anketues, me qëllim të zbardhjes së të vërtetës mund të dëgjojë palët apo dëshmitarët, por mund të caktojë edhe ekspertë për shqyrtimin e gjendjes faktike. Në bazë të rezultateve konkrete komisioni harton

⁷⁵ Zejnulla Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003, fq.418

raport, të cilin ua prezenton palëve.⁷⁶Në marrëveshjet e Brianit, parashihte që palët në kontest të përm-bahen nga përdorimi i forcës përderisa nuk është shpallur raporti i komisionit anketues.Komisione të tilla janë formuar për shembull, në rastin e Hungarisë në vitin 1956, Palestinës, Koresë, Afrikës Jugore, Izraelit, etj.

Shpesh-herë, Kombet e Bashkuara kanë dërguar ekipe hulumtimi në shtete të ndryshme në rast të indikacioneve se janë bërë shkelje të të drejtave njerëzore.Këtu është fjala për komisione anketuese të cilat kanë pasur për qëllim zgjidhjen e kontesteve në sferën e të drejtave njerëzore në mes shtetit përkatës dhe OKB-së.Karta e Kombeve të Bashkuara (neni 33/1), si mjet për zgjidhjen e konflikteve parasheh edhe komisionet anketuese.Po ashtu këtë formë të ndihmesës për zgjidhjen e problemeve e parashohin edhe disa organizata ndërkombëtare.⁷⁷Edhe për formimin e komisionit anketues vlejnë rregulla të ngja-shme si të shërbimit të mirë dhe ndërmjetësimit.Raporti i komisionit nuk ka karakter obligativ, përveç nëse parashihet me marrëveshje që të ketë karakter të tillë.

e) Pajtimi

Pajtimi është mënyrë paqësore e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga një komision i zgjedhur, i cili ka për detyrë t'i shqyrtojë dhe t'i ndriçojë të gjitha aspektet e mosmarrëveshjeve; t'i ndriçojë faktet lidhur me mosmarrëveshjen të bëjë raport të hollësishëm për këtë dhe t'u propozojë zgjidhjen e shteteve në konflikt.Sipas kësaj, kjo mënyrë e zgjidhjes paqësore ka elemente të anketës dhe të ndërmjetësimit.Pajtimi si mënyrë paqësore e zgjidhjes së

⁷⁶Shih, Broënlie I, Principles of Public International Law, Clarendon Press, Oxford, 1990, pp. 645-646.

⁷⁷Collier and Loëe, The Settlement of Disputes in International Law, Oxford, 1999, pp. 26-27.

mosmarrëveshjes ndërkombëtare është paraqitur relativishtë vonë. Kjo mënyrë nuk parashikohej me rregullat e Konventës së Hagës.⁷⁸

Komisionet e pajtimit kanë mundësi që në bazë të rezultateve nga format e ndryshme të anketimit, të formulojnë për palët në konflikt propozime konkrete për tejkalimin e situatës. Në këtë rast, zakonisht ata caktojnë edhe afat brenda të cilit edhe presin përgjigje nga palët në konflikt. Propozimi nga komisioni po ashtu nuk ka karakter obligativ. Disa nga marrëveshjet që SHBA-të i kishin lidhur me shtetet tjera, përmbanin karakteristikat e marrëveshjeve të Brianit.⁷⁹

Nga marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat pajtimin e parashohin si formë dhe mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund të përmendim –Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit (1965); Paktin mbi të drejtat qytetare dhe politike (1966); Konventën mbi të drejtën kontraktuese (1969); Konventën për mbrojtjen e rrethit ozonik (1985), etj. Komisioni i pajtimit përbëhet nga tre apo pesë anëtarë. Palët zgjedhin nga një anëtar, kurse të tretin apo tre të tjerët i zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Pra, për nga përbërja, komisioni i pajtimit është i ngjashëm me arbitrazhin, por dallimi është se vendimet e këtij komisioni nuk kanë karakter obligativ për palët, përveç nëse me marrëveshje të përbashkët përcaktohet që vendimi i marrnga komisioni pajtues të ketë karakter obligativ për palët.

⁷⁸ Zejnulla Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003, fq.418

⁷⁹ Briani ka qenë sekretar shtetëror për punë të jashtme i SHBA. Disa marrëveshje që SHBA-të i lidhnin me shtete tjera parashihnin që të gjitha kontestet të cilat nuk kanë mundur të zgjidhen me mjete diplomatike, të mund të zgjidhen përmes pajtimit.

f) Arbitrazhi

Arbitrazhi paraqet formë të zgjidhjes së kontesteve midis shteteve nga gjyqtarë të cilët zgjidhen nga vet palët, në bazë të Konventës së Hagës për zgjidhjen e kontesteve (1907). Kjo formë e gjykatës, më së tepërmi ka zgjidhur kontestet juridike mes shteteve lidhur me interpretimin dhe aplikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Konventat e Hagës (1907), patën ndikim të fuqishëm në rolin dhe funksionimin e arbitrazheve. Në bazë të tyre u patën lidhur shumë marrëveshje bilaterale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes arbitrazheve. Marrëveshja mbi arbitrazhin ndër-amerikan (1929), parashihte që shtetet anëtare t'i zgjidhin të gjitha problemet përmes arbitrazhit, nëse paraprakisht të njëjtit nuk kanë mundur t'i zgjidhin përmes mënyrave diplomatike. Historikisht, arbitrazhi është institucion shumë i vjetër. Në forma të ndryshme, ai është i njohur edhe në kohën antike edhe në Mesjetë. Kurse, arbitrazhi modern paraqitet në shekullin XVIII, në marrëveshjet për miqësi, tregti dhe lundrim në mes SHBA-së dhe Britanisë së Madhe.⁸⁰ Sipas këtyre marrëveshjeve, të dy palët kanë mundur të zgjedhin numër të njëjtë të arbitrave në rast kontesti. Më vonë konstituimi i arbitrazhit pëson ndryshime, kështu që, zakonisht përbëhet nga tre apo pesë gjyqtarë (numri i gjyqtarëve duhet të jetë tek), prej të cilëve palët zgjedhin nga një gjykatës, kurse zgjedhjen e të tretit apo të tre të tjerëve (arbitrave neutral) e bëjnë bashkërisht një grup shtetesh tjera për të cilat palët dakordohen.⁸¹

Nëse palët nuk mund të pajtohen brenda tre muajve rreth zgjedhjes së arbitrit apo arbitrave neutralë, atëherë Komisioni për të drejtën ndërkombëtare, parasheh që emërimin e arbitrave neutralë ta bëjë kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Arbitrazhi ka karakter të

⁸⁰ Jay Treaty, 1794.

⁸¹ Në kontestin "Alabama" mes SHBA-ve dhe Britanisë, tre anëtarët tjerë të arbitrazhit u janë besuar Zvicrës, Brazilit dhe Italisë. Në të kaluarën si arbitër zakonisht zgjidhej Papa apo mbret i ndonjë shteti.

institucionit i cili formohet me marrëveshje në mes palëve në konflikt. Palët merren vesh edhe rreth së drejtës e cila duhet të aplikohet në rastin kontestues konkret. Po ashtu edhe kompetencat e tij përcaktohen me marrëveshje në mes palëve. Këto marrëveshje që kanë të bëjnë me -formimin e arbitrazhit, me aplikimin e së drejtës, si dhe me përcaktimin e kompetencave të arbitrazhit quhen –kompromise. Përparësitë kryesore të arbitrazhit janë:

a) Palët më lehtë përcaktohen që kontestin e tyre ta nxjerrin para arbitrazhit, se sa para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pasi këtu nuk i nënshtrohen shumë presionit të opinionit;

b) Në besimin më të madh të palëve, pasi te arbitrazhi ata kanë edhe arbitërit e tyre;

c) Se këtu nuk ka përfshirje të palës së tretë si të interesuar; dhe

ç) Është më ekonomik (pra me shpenzime më të vogla).

Me qëllim të përparimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, në vitin 1996 miratohen rregulla fakultative për arbitrazhet, të cilat përfshijnë edhe organizatat ndërkombëtare edhe shtetet. Pas trazirave të shumta që nga viti 1870 e deri në përfundim të luftërave ballkanike, erdhi deri te një qetësim i situatës, deri në vitet kur zhvillohej Lufta e Parë Botërore. Kjo periudhë ndërlidhet dhe përkon me pjesën e cila është edhe burimi i këtij konflikti, kohën e shpalljes së Republikës Popullore të Maqedonisë nga ana e kryetarit të Jugosllavisë së asaj kohe Josip Broz Tito. Si pikë të rëndësishme, mund të marrim edhe faktin se Greqia është dashur të reagojë gjatë viteve 1945-1990, ose edhe më parë kur Tito e shpall Maqedoninë republikë, në suaza të Jugosllavisë, duke shpalosur dhe duke mbrojtur argumentin se sipas palës greke ky emër i ka takuar Greqisë që 3500 vjet më parë dhe të tentojë në ruajtjen e këtij emri, mirëpo grekët në këtë kohë ishin tejet pasiv, ndërsa reagimi i tyre më i madh do të vijë pas shpalljes së Maqedonisë shtet i pavarur dhe sovran më 8 shtator të vitit

1991. Edhe pse Republika e Greqisë ka intensifikuar kampanjën për përvetësimin e histories së kaluar antike të Maqedonisë që nga viti 1988 kur provincën e saj veriore e emëron me emrin Maqedoni, gjithashtu edhe universitetin në Selanik e emëron me po të njëjtin emër, vendos fytyrën e Aleksandrit të III të Maqedonisë (Lekës së Madh) në paratë e tyre si dhe shumë e shumë ngjarje të tjera të cilat do të dalin në pah, sidomos pas pavarësimit të Maqedonisë, po edhe më vonë gjatë viteve të fundit.⁸²

Me shpalljen e pavarësisë, Maqedonia ka rihapur diskutimin mbi argumentin, përderisa në njohjen e shtetit të ri, Bullgaria ka afirmuar se ekzistojnë “disa vende dhe vetëm një komb”, duke nënvizuar kështu se maqedonasit duhet të konsiderohen etni bullgare. Por, edhe pse polemika me Sofjen ka pasur efekte të limituara, shumë më të theksuara dhe më evidente kanë qenë pasojat e kundërshtimeve nga Greqia. Edhe pse duke respektuar kriteret e përcaktuara nga “Komisioni i Arbitrimit” i drejtuar nga Robert Badint Maqedonia në vitin 1992 nuk njihet nga Komuniteti Evropian, që pas kërkesës greke, i kërkon Shkupit zyrtar të fshijë disa dispozita të shkruara në Kushtetutën e saj, që nga Greqia konsideroheshin si ndërhyrje në marrëdhëniet e brendshme të vendeve fqinje. Sipas Athinës, emri “Republika e Maqedonisë” jo vetëm që përfaqëson uzurpimin e një emri dhe një simboli të historisë helene, por edhe një kërkesë të heshtur territorial përballë homonimit të rajonit grek.⁸³

Për njohjen, qeveria e kryeministrit Mitsotakis i kërkon Shkupit zyrtar të pranojë tre kërkesa, heqje dorë nga çdo kërkesë territoriale, një deklaratë që mohon ekzistencën e një pakice maqedonase në Greqi dhe ndryshim të emërimit të shtetit, kjo e fundit refuzohet nga liderët

⁸² Спортот за името меѓу Грција и Македонија, ЈП службен весник на РМ, Скопје, 2008

⁸³ Interim accord between Macedonia and Greece, Neë York, 13/09/1995.

maqedonas që afirmojnë idenë se pikërisht emri përfaqëson simbolin e identitetit kombëtar maqedonas.⁸⁴

Pasi që u shfaq kontesti , u shfaqën edhe dilemat rreth teknikës së mundshme për të cilat do të përcaktohen palët për zgjedhjen e kontestit. Shumë e më shumë rriteshin tensionet lidhur me këtë çështje, ashtu që kishte edhe propozime që nga viti 1993 që kontesti të zgjidhet përmes arbitrazhit, por ai propozim nga ana e Qeverisë shikohej si rruga më e vështirë përmes së cilës mund të zgjidhet kontesti. Por , prap se prapë R.M zgjodhi ndërmjetësimin si teknikë më e përshtatshme për ta zgjidhur të njëjtin. Ndërmjetësimi shihej si metodë nga e cila të dy palët kanë kontroll të plotë ndaj kontestit ,por edhe mundësi për ta ndërpre kurdo që palët ta vlersojnë si të panevojshme. Procedura fleksibile e ndërmjetësimit gjithashtu në këtë contest më shumë u ka konvencuar palëve , në kuadër të cilit fleksibiliteti i ndërmjetësuesit mund të gjej zgjidhje creative dhe palët mund të pajtohen me vendimin jashtë qëndrimeve dhe pikave parrësore të palëve .Përfshirja e historisë së kontestimeve ndaj Maqedonisë u bë për një arsye të thjeshtë: Për të kuptuar më mirë qëndrimet e maqedonisë për çështjen e emrit: Për të zbuluar disa rëndësinë e emrit Maqedoni për shtetin që sot quhet kështu. Çështja e emrit të Maqedonisë mbeti e pa debatuar nga pala greke për aq kohë sa republika fqinje ishte pjesë e IRFJ. Kontesti politiko-semantik mes dy vendeve nisi në vitin 1991, kur Maqedonia u shkëput përfundimisht nga IRFJ dhe shpalli pavarësinë duke marrë emrin kushtetues: Republika e Maqedonisë, me lindjen e problematikës së emrit, këto dy vende i kontestojnë pa rreshtur historinë njëri-tjetrit, por siç dihet historia prek të gjitha dimensionet duke përfshirë identitetin apo përkatësinë territoriale.

⁸⁴Dr. Alban Daci, “Një bashkëjetesë e “detyruar” mes Sllavo-maqedonasve dhe SCqiptarëve”, <http://ëëë.forumivirtual.com/analiza/21868-ceshtja-e-maqedonise.html>

Për maqedonasit e sotëm emri Maqedoni i përket vendit dhe njerëzve dhe heqja e këtij emri do të thotë për ta vetëm mohim identiteti. “Po të humbasim këtë emër ne humbasim identitetin tonë...Nëse mbetemi pa emër, pra pa identitet do të ringjallen orekset e vjetra”. Cështja për emrin ka rrënjë të thella që lidhen me Maqedoninë antike, identifikimin e maqedonasve të sotëm me historinë antike të Maqedoisë gjeografike. Të gjitha këto lidhen me frikën e ngjalljes së aspiratave sllave për Greqinë Veriore dhe daljen në ujërat e ngrohta të Mesdheut, të cilat u mbështetën në Paqen e Shën Stefanit. Nëse pala greke do të pranonte emrin ‘Maqedoni’, ajo do të legjitimonte kontestin më të madh me vendin fqinj, duke pranuar kështu se trashëgimia antike e Maqedonisë do t’i takonte Maqedonisë aktuale politike. Sipas Prevalakis, Maqedonia ishte epopeja e Aleksandrit të Madh dhe qytetërimit helen. Grekët e konsiderojnë këtë periudhë si një ndër kapitujt më të rëndësishëm të historisë së tyre. Krijimi i një vendi të ri që mban emrin Maqedoni perceptohet si uzurpim i kësaj trashëgimie historike. Motivet e sipër përmendura bëjnë që grekët të kenë një ndjeshmëri lidhur me këtë çështje. Ata e konsiderojnë përdorimin e emrit Maqedoni nga IRJM si mohim të identitetit grek, sipas grekëve maqedonishtja është një ‘idiomë e Shkupit’, dialekt i deformuar dhe i vjetër i bullgarishtes. Greqia kundërshton ekzistencën e minoritetit maqedonas në Greqi bashkë më të, ata e konsiderojnë popullin maqedonas antik si popull grek. Emri ‘makedonia’ nga rrjedh emri Maqedoni është fjalë greke, nëse do t’i referoheshim Homerit, por nga ana tjetër është vetë Homeri ai që do t’i ‘tradhëtojë’ grekët dhe tezën e tyre. Raportet midis Maqedonisë me Greqinë 20 vitet e fundit janë në përkeqësim e sipër. edhe përkundër presioneve diplomatike, këto dy shtete nuk po lëshojnë pe në qëndrimet e tyre dhe po mundohen që të i bëjnë probleme njëri-tjetrit. Me 7 prill të vitit 1993 Greqia e bllokoi Maqedoninë për anëtarësimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara⁸⁵, atëherë Greqia e akuzoi Maqedoninë për pretendime

⁸⁵1993 Maqedonia u antarsua në OKB.

territoriale ndaj Greqisë dhe se me emrin e saj kushtetues Maqedonia do të rrëronte suveranitetin e shtetit grek, dhe nën presionin ndërkombëtar, shtetet e OKB u morën vesh që ta pranojnë Maqedoninë në OKB me referencën IRJM- ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, menjëherë pas pranimit të Maqedonisë në OKB, shtetin Grek e kapi një krizë të rëndë politike. Prej qeverie bie Demokracia e Re, dhe vjen në fron partia PASOK e Andreas Papanderut, Kryeministri i ri grek i prishi marrëdhëniet diplomatike me Maqedoninë duke i venduar embargo tregtare. Dhe me 13 shtator të vitit 1995 u nënshkrua një marrëveshje e re midis Greqisë dhe Maqedonisë, ku Maqedonia e ndërroi flamurin e saj shtetëror dhe shtoi në preambulën e Kushtetutës se nuk ka asnjë pretendim territorial ndaj shteteve fqinjë. Ndërsa Greqia sipas kësaj marrëveshjeje detyrohej që të mos pengoj Maqedoninë për kyçe nëpër instanca ndërkombëtare. Me 10 dhjetor të vitit 2001 për të parën herë lindi ideja e një shtese gjeografike mbi emrin e Republikës së Maqedonisë. Edhe pse marrëveshjet vazhdojnë, ideja thellohet për ndryshimin e emrit kushtetues të Maqedonisë. Jepen shumë propozime dhe ide. Me 9 nëntor të vitit 2005, ndërmjetësuesi në kontest Metju Nimic jep propozimin më serioz deri më tani, ai sjell formulën e dyfishtë që Maqedonia në nivel ndërkombëtar të njihet si Republic of Macedonia, ndërsa qytetarët e saj si qytetar të Republica Macedonia-Skopje (Shkupi).

Ky propozim u pranua nga ana e palës maqedonase, ndërsa e refuzuan pala greke, qysh prej vitit 2005 e këndej ka edhe një mori aktivitete dhe takimesh midis dy palëve për zgjidhjen e kontestit rreth emrit kushtetues. Maqedonia u bllokua për anëtarësim në NATO në samitin e Bukureshtit nga ana e palës greke. Bisedimet rreth dy palëve shpesh herë ishin edhe indirekte duke e provokuar njëra tjetrën përmes metodave dhe mënyrave të ndryshme, garnitura udhëheqëse politike në vend e provokoi Greqinë duke e ndërruar emrin e aerodromit të Shkupit në Aleksandri i Madh, ndërsa mediumet në Greqi vazhduan dezinformimet dhe shantazhet rreth

Maqedonisë. Në takimin e fundit në Shkup, me 24 shkurt 2010, ndërmjetësuesi **Mjetu Nimicë** ndërmjet tjerash tha: ⁸⁶“ Këto diskutime u karakterizuan si shumë serioze dhe konstruktive. Njashtu ka një vullnet të madh për zgjidhjen e problemit. Ekziston një mentalitet tjetër dhe një dëshirë të flaktë për zgjidhjen e këtij problem, shpresoj se mbi baza të kësaj dhe diskutimeve në Athinë, ne do të mundemi që të përshpejtojmë procesin i cili është shumë i ngadalshëm në muajt e fundit dhe të shohim se a ka ndonjë mundësi për tejkalimin e këtij kontesti që është në agjendën ndërkombëtare për një periudhë të gjatë”. 1. 8 shtator 1991 - Maqedonia shpallet shtet i pavarur dhe sovran, ndërsa Republika e Greqisë intensifikon kampanjat për përvetësimin e historisë antike maqedonase;⁸⁷ Në prill të vitit 1992, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë vendos të parashtrojë **Kërkesë për pranimin e Republikës së Maqedonisë në OKB**. Ndërsa, në po të njëjtin vit, më 27 qershor, Greqia me pozitën e saj në BE arrin që të ndikojë në të a.q. Deklaratën e Lisbonës, në të cilën thuhej se BE-ja do ta pranojë Maqedoninë por,... me emër i cili nuk do ta përmbajë fjalën “Makedonija” (Maqedoni); Më 8 prill 1993 **sillet Vendimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së** me të cilin shteti pranohet në OKB, me referencën “The Former Yugoslav Republic of Macedonia” (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë); 16 shkurt 1994 - embargoja greke ndaj Maqedonisë me arsyetimin se fqinji I saj verior refuzon të ndërrojë emrin, flamurin dhe kushtetutën, si dhe atë se vendi fqinj ka pretendime territoriale ndaj provincave të saj veriore; Më 13 gusht 1995, nën patronazhin e sekretarit gjeneral të OKB-së u nënshkrua **“Marrëveshja e përkohshme”**⁸⁸ mes Maqedonisë dhe Greqisë, me të cilën të dy palët u pajtuan: ... t’i vazhdojnë bisedimet nën patronazhin e Sekretarit gjeneral të OKB-së, sipas Rezolutës 845 të Këshillit të Sigurimit (1993) me qëllim që të arrihet marrëveshje mbi

⁸⁶ Ndërmjetësuesi i kontestit Maqedoni-Greqi Mjetu Nimicë..

⁸⁷ Më 8 shtator 1991 - Maqedonia shpallet shtet i pavarur dhe sovran...

⁸⁸ 3 Kjo marrëveshje është e nënshkruar nga Ministri i atëhershëm i punëve të jashtme të R. së Maqedonisë z.Stevo Crvenkovski dhe z. Karlos Papuljas, ministër i atëhershëm i punëve të jashtme të R. së Greqisë.

dallimet për emrin, të përcaktuara në atë Rezolutë, si dhe në Rezolutën 817 të Këshillit të sigurimit (1993). Është e rëndësishme të theksohet se kjo Marrëveshje pas ratifikimit nga Kuvendi i Maqedonisë më 9 tetor 1995, ishte e sfiduar në Gjykatën Kushtetuese nga partia e atëhershme opozitare VMRO-DPMNE, me arsyetimin se kjo marrëveshje qenka nënshkruar nga përfaqësues i shtetit të Greqisë dhe personit privat nga Maqedonia, sepse z. Stevo Červenkovski në atë kohë paska qenë vetëm ushtrues detyre i ministrit të punëve të jashtme dhe se këtë gjë, sipas Kushtetutës së R. së Maqedonisë është dashur ta bëjë Qeveria e RM-së (kryeministri) ose kryetari i shtetit. Në nëntor të vitit 2004, **SHBA-të e pranojnë R. e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues.**⁸⁹ Komisioni evropian i BE-së në **Raportin për statusin e kandidatit për Maqedoninë**, nga nëntori i vitit 2005 konkludon se: "... kontesti me emrin mbetet i hapur (...) dhe se ... përpjekjet për zgjidhjen e tij duhet të përforcohen me një qasje konstruktive, që të mund më shpejtë të gjendet një zgjidhje reciprokisht e pranueshme në korniza të Rezolutave të OKB-së dhe në interes të bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore..."

8. Moment tjetër i rëndësishëm për t'u shënuar në marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe Greqisë në pjesën e emrit, është i ashtuquajti **Memorandumi I intelektualëve grekë për refuzimin (hedhjen) e emrit FYROM, i datës 9 mars 2006.** 56 intelektualë vendosin që fqinjin e tyre verior ta quajnë me emrin e saj kushtetues, pa marrë parasysh qëndrimet e Athinës zyrtare.

9. Ngjarje tjetër e marrëdhënieve mes këtyre dy shteteve fqinje është edhe hapi I qeverisë maqedonase kur kah fundi i vitit 2006 dhe fillimi i vitit 2007, vendos që aeroportin më të madh në Maqedoni ta riemërojë me emrin **"Aleksandri i Maqedonisë"** që më vonë pas reagimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë vendos që ta ndryshojë emrin në **"Aleksandar Veliki"**, me pretekstin se kinse e paska lehtësuar përkthimin në anglisht. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkohshme mes Maqedonisë dhe Greqisë dhe me ndërmjetësimin e faktorit

⁸⁹ Hap ky që e stimulon Republikën e Maqedonisë që të mbajë qëndrim të fortë për mosndryshimin e emrit.

ndërkombëtar, përfaqësuesin special të Sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara, hapet një kapitull i ri i zhvillimeve rreth këtij kontesti. Kjo marrëveshje nënshkruhet me qëllim që Maqedonisë t'i Ciqet embarPoja Preke të cilën ajo e kishte vendosur ndaj saj, për shkak të refuzimit të saj që t'ipranojë ndryshimet e propozuara nga ana e Greqisë, mirëpo me kalimin e kohës Maqedonia pranon disa nga kushtet, ku ndërron flamurin e saj, pra heq diellin e Vergjinës si dhe bën ndryshimet kushtetuese, ndërsa konflikti i emrit vazhdon edhe më tutje sepse pala maqedonase mendon se me ndryshimin e emrit të shtetit ata do të humbasin edhe identitetin, por edhe gjuhën, që me një fjalë do të thotë se nuk do të ekzistojë as kombi maqedonas e as gjuha maqedonase. Lidhur me sjelljen e palëve në këtë konflikt jemi të mendimit se ata kanë qëndrim indiferent, për faktin se palët në fjalë, duke këmbëngulur në mbrojtjen e argumenteve të tyre, nuk lëshojnë pe, e me këtë konflikti edhe më tej vazhdon të ngelet peng dhe i pazgjidhur.

a) Reagimi i opinionit të brendshëm dhe të jashtëm

Kemi disa raste ku reagimi i opinionit të brendshëm (pjesës dërmuese të qytetarëve të RM-së) lidhur me këtë çështje është i prerë dhe i pandryshueshëm. Këtë më së miri e dëshmon përkrahja e politikës së garniturës së pushtetit aktual nga ana e qytetarëve, por nga ana tjetër edhe një pjesë e opozitës insiston me ngul që kjo çështje të gjejë zgjidhjen e saj. Në disa anketa lidhur me këtë çështje të realizuara pak kohë më parë nga sektori civil dhe OJQ-të rezulton senga 1110 qytetarë të anketuar në fillim të muajit korrik të vitit 2014, shumica e qytetarëve mendojnë se çështje më e rëndësishme politike është ruajtja e emrit kushtetues. Pasqyruar në përqindje, del se 66, 5 % të qytetarëve të RM-së janë për ruajtjen e emrit kushtetues, ndërsa për sa i përket të njëjtës anketë, kemi dallime diametralisht të kundërta në mes të qytetarëve shqiptarë dhe atyre

maqedonas ku 78% e qytetarëve shqiptarë si më të rëndësishme i vlerësojnë eurointegrimet, ndërsa 82% e qytetarëve maqedonas janë për ruajtjen emrit kushtetues dhe jo për eurointegrimet.⁹⁰ Në një tërësi ndër anketat thuhet se qytetarët nuk e japin emrin për anëtarësim në NATO dhe BE. Kjo gjë vërehet në anketën e Institutit Pavel Shatev, e cila tregon se nëse nesër do të ishte organizuar referendum për ndërrimin e emrit me arsyetimin për anëtarësim në NATO dhe BE “PËR”do të kishin votuar 30,7 %, ndërsa 57,4% do të votonin “KUNDËR”. Në këtë pyetje nuk janë përgjigjur 12 % e të anketuarve. Referendumin do ta kishin përkrahur një përqindje e madhe e shqiptarëve, në krahasim me maqedonasit të cilët shumica do të votonin kundër.⁹¹

Për të ardhur deri te parandalimi i kontestit, kuptohet se rolin parësor e kanë institucionet vendore, por edhe ato ndërkombëtare. Sa i përket të parëve, tek ato kohëve të fundit, por edhe më herët, parë në këndvështrimin e sotëm dhe perspektivën e afërt, vërehet një indiferencë që shkon në favortë moszgjidhjes së shpejtë të këtij kontesti, për faktin se nomenklatura qeverisëse në pushtet duke mbuluar interesat e veta të ngushta, ngathtësojnë veprimet në këtë drejtim dhe orientojnë shtetin në drejtim të gabuar gjithnjë duke pasur drojë nga populli dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Përderisa opozita në vazhdimësi zëshëm kritikon rrjedhën e ngjarjeve lidhur me këtë duke thënë se barrierë e vetme për mosintegrimin dhe ngecjen e shtetit në strukturat euroatlantike, nuk është vetëm kontesti i emrit, por këtu me këtë bashkërendojnë edhe politikat keq qeverisëse të pushtetit në çdo rrafsh që prek shoqërinë e vendit. Të njëjtën e cekin edhe përfaqësitë diplomatike në vend, por edhe institucione relevante në BE. Në vazhdim disa deklarata të tyre dhënë për mediat në vend. Përfaqësuesit diplomatik të akredituar në RM, duke filluar nga ambasadori i SHBA-së Jess Bailey, i BE-së Aivo Orav, si dhe disa eurodeputetë

⁹⁰ Sitel.com.mk, 12/07/2010

⁹¹ Sitel.com.mk, 28/07/2010

mendojnëse moszgjidhja e emrit do të sjellë regresin e Republikës së Maqedonisë dhe në këtë mënyrë vendi do të kthehet disa hapa mbrapa. Njëra ndër deklaratat e përfaqësuesit të BE-së në Maqedoni, Aivo Orav u drejtohet dy kryeministrave për zgjidhje sa më të shpejtë të emrit duke thënë që edhe pse është një çështje që ndoshta në fillim do të hasë në moskuptime, është patjetër të arrihet një zgjidhje. Në vazhdim edhe deklarata në tërësi: “kështu e emrit është si një re e errët që qëndronvarur jo vetëm mbi qiellin e Maqedonisë, por edhe mbi qiellin grek, e mund të thuhet edhe mbi qiellin e Ballkanit Perëndimor. Mendojse ekziston një përgjegjësi e madhe tek liderët e përfshirë në këtë proces, kryeministri juaj si dhe kryeministri grek për zgjidhjen e kësaj çështjeje njëherë e përgjithmonë. Kjo është një zgjidhje e vështirë që duhet të bëhet, dhe që do të dhembë në fillim, por duhet të zgjidhet dhe vërtetë shpresoj se dy kryeministrat do të gjejnë guxim dhe vullnet politik për të gjetur një zgjidhje. Konsideroj se, para së gjithash, kjo nuk është përgjegjësi e BE-së, por përgjegjësi e të dy vendeve, ndërsa të gjithë janë të gatshëm që ta mbështetnin vendimin që do të merret”. Në një tjetër deklaratë po kjo ambasadore deklaroi se vullneti politik i të dyja palëve është i domosdoshëm për arritjen e një përfundimi të mirë dhe deri te një zgjidhje e pranueshme.⁹² Pas shumë propozimeve, të cilat qeveria e Maqedonisë i ka refuzuar si p.sh.: REPUBLIKA MAKEDONIJA shkruar në latinisht, MAQEDONIA E EPËRME, REPUBLIKADEMOKRATIKE E MAQEDONISË, REPUBLIKA E PAVARUR E MAQEDONISË, REPUBLIKA MAQEDONIA E RE, REPUBLIKA E MAQEDONISË (SHKUPI).⁹³ ose edhe shumë propozime të tjera kanë mundur të jenë të pranueshme dhe të mos e prekin identitetin, siç është për shembull emri Republika Demokratike e Maqedonisë, me të cilin emër populli që jeton në Maqedoni nuk do të mund të quhej maqedonas demokrat apo edhe maqedonas të pavarur sipas propozimit Republika e Pavarur e Maqedonisë. Edhe pse insistohet

⁹²Deklaratë dhënë për televizionin kombëtar Alsat-m me datë 06/04/2010, www.alsat-m.tv

⁹³Спортот за името меѓу Грција и Македонија, ЈП службен весник на РМ, Скопје, 2008

që Maqedonia të ndërrojë emrin kushtetues si kusht për integritet euroatlantike, vlerësojmë se ky veprim është i padrejtë ndaj Maqedonisë e cila gjatë procesit të integritet euroatlantike vepronte sipas Marrëveshjes së Përkohshme të nënshkruar në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, ku në nenin 11 thuhet se pala e parë (Greqia) nuk do ta pengojë palën e dytë (Maqedoninë) në anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare në të cilat Greqia veç më është anëtare. Të njëjtën gjë Maqedonia e bënte edhe gjatë periudhës pas Samitit të Bukureshtit. Mirëpo, me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të Maqedonisë, të miratuar më 5 dhjetor të vitit 2011, ndër të tjera thuhet: -Duke kundërshtuar anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO, në periudhën para samitit të NATO-s në Bukuresht, nga viti 2008, Greqia ka shkelur marrëveshjen e përkohshme të vitit 1995-Maqedonia edhe më tej mund ta përdor emrin e saj kushtetues edhe në marrëdhëniet me Greqinë, por edhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare; -Të gjitha qëndrimet e Greqisë se Maqedonia ka thyer marrëveshjen e përkohshme, refuzohen kategorikisht. Sipas kësaj, GJND-ja në mënyrë eksplicite vendosi se Maqedonia ka të drejtë që veten e saj ta emërojë me emrin e saj kushtetues në marrëdhëniet e saj me Greqinë, si dhe Greqia nuk mund ta kundërshtojë anëtarësimin e plotë të Republikës së Maqedonisë në NATO ose në organizata tjera ndërkombëtare në bazë të “qëllimit” të Maqedonisë që veten e saj ta emërojë me emrin e saj kushtetues në organizatat ndërkombëtare. Gjykata ka vendosur se kundërshtimi nga ana e Greqisë para dhe gjatë samitit të NATO-s në Bukuresht paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Nga ana tjetër nga Greqia pritet që në të ardhmen mos ta shkelë marrëveshjen përsëri, duke pasur parasysh se një shkelje tjetër do të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe do të nënkuptonte mosrespektimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Aktvendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i datës 5 dhjetor 2011 është i obligueshëm për palët dhe kundër të

njëtit nuk janë të lejuara norma tjera ligjore. Edhe me rënien e Qeverisë së Papandreut, si dhe me problemet e shumta që Greqia pati me krizën e thellë ekonomike e financiare, edhe përkundër insistimit mjegullues dhe tejet indiferent të palës maqedonase, çështja e emrit mbeti pezull dhe e pazgjidhur. i arsye për këtë palët edhe më tej akuzojnë njëra tjetrën me akuzat e cekura më lartë, por duket se problemet e brendshme të Maqedonisë dhe Greqisë, probleme këto që prekin pothuajse të gjitha sferat e jetës shoqërore, duke përfshirë këtu edhe krizën ekonomike dhe financiare (sa i përket Greqisë) dhe administrimi i gabuar i politikave të përgjithshme të qeverisë së Maqedonisë, ku përfshihen të gjitha segmentet, shpie deri te mjegullimi, mospasja e idesë dhe stërzgjatja e gjetjes të një propozimi konkret për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar rreth emrit. Duke qenë të vetëdijshëm se kjo çështje, apo zgjidhja e sa mëhershme e këtij kontesti do të ishte në dobi të të dyja palëve, e sidomos të asaj maqedonase, për shkak se i njëjti, ngadalëson shumë procese të rëndësishme, e posaçërisht ato eurointegruese dhe në këtë situatë dhe pozitë në të cilën gjenden shtetet, palët, qeveritë dhe organet përkatëse të përfshira në këtë problematikë, do të gjejnë elementet dhe mekanizmat e duhura për të ardhur shumë shpejtë deri te një propozim i pranueshëm si për Republikën e Greqisë po ashtu edhe për republikën e Maqedonisë, propozim ky i cili do të hedhet në tavolinën negociuese nga ndërmjetësi ndërkombëtar dhe i cili propozim do të miratohej nga të gjithë aktorët e kyçur në këtë problematikë, do të hapte perspektiva frytdhënëse të cilat do të ishin në favor të të dy shteteve të konfrontuara rreth kësaj çështje që daton tashmë 24 vite me radhë.⁹⁴ Rëndësia e madhe e bisedimeve, si pjesë përbërëse e çdo marrëdhënie ndërkombëtare dhe çdo teknikë për zgjidhje e kontesteve eventuale që do të dalin përmes bisedimeve. Respektivisht, në tështë e potencuar që secili lloj i mosmarrëveshjeve që

⁹⁴Rexhail Ramadani, Thelbi i kontestit Greqi - Maqedoni, Monday, 21 June 2010 13:56 <http://ëëë.lajmifundit.com/lajmet/editoriale/komente/8227-thelbi-i-kontestit-greqi-maqedoni/lajmet/editoriale/komente/8227-thelbi-i-kontestit-greqi-maqedoni?format=pdf>

mund të dalin nga mosrespektimi i të drejtave bushjes së detyrimeve, palët mosmarrëveshjet mund t'i zgjidhin përmes bisedimeve. Për shëmbull neni 85 i Marrëveshjes për ndihmën e ndërsjelltë juridike nga viti 1957 mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë parasheh:” Të gjitha çështjet kontenstuese, lidhur me përmbushjen e marrëveshjes, shtett nënshkruese do t'i zgjidhin përmes rrugës diplomatike.⁹⁵Ose në marrëveshjen Interamerikae për ndihmën reciproke nga viti 1949, është e potencuara që palët janë të obliguara që të kosnulltohen në raste të caktuara.Në zgjidhjen e mosmarveshjeve dhe dallimeve eventuale në këtë rast me kosnultime referohen bisedimet.⁹⁶Këta shembuj i referohen përodrimit të bisedimeve si teknikë për zgjidhjen e kontesteve që eventualisht në të ardhmen mund të paraqiten dhe kjo është e paraparë marrëveshjeje duhet të jetë paraprakisht e akorduar.Mund po e njëjta teknike e cila është e përdorur edhe pasi që tash më kontesti ekziston. Në këto raste bisedimet më nuk kanë vetëm rëndësinë teknike për zgjidhjen konkrete të kontestiti por edhe rëndësi të madhe politike, pasi që bisedimet e palëve ndihmojnë që të asgjësojnë përdorimin e dhunës dhe analizën e kontestit në frymën positive me shpresë të gjetjes së zgjidhjes e jo në frymën e themellimit me të madh të kontestiti duke mos lënë hapësirë për shpaloosjen e drejtëpërdrejtën të kontestit. Për dallim nga rastet kur biseidmet janë të potencuar si mjet i obligueshëm për zgjidhjen e kontesteve të mundshme, që mund të paraqiten në të ardhmen ka situatë kur marrëveshja mes palëve përmban klauzolën pactum de contrahendo. Me inkorporimin e kësaj klauzole jepet mundësia që palët të lidhin marrëveshje duke u bazuar në pikat, për të cilat akordohet por pikat tjera për të cilat ende nuk janë akorduar ose që janë kontestuese do të bisedojnë në frymë të mirë dhe me qëllim të lidhjes përfundimtare të marrëveshjes.⁹⁷pornë bazë të së drejtë ndërkombëtare në qoftë se mungon deklarimi për obiligimin e palëve për aplikimin e bisedimeve në këtë rast bisedimet nuk

⁹⁵ J.G, Merillis, International Dispute Settlement, 4th edition, 2005, fq.24

⁹⁶ Smila Avramov dhe Milenko Kreca, Medunarodno pravo, Beograd, 1996, fq.524

⁹⁷ V.D Degan, Sources of International Laë, Martinus Nijhoff Publishers, 1997, fq.731

mund të imponohen si të patjetërsueshme. Respektivisht asnjëra palë nuk është në gjendje që t'ia imponojë palës tjetër bisedimeve si mejt i obligueshëm. Deklarata e manilës për zgjidhjen paqësore të kontesteve e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më vitin 1982 parasheh :”Në raste kur palët kontestuese nuk arrijnë zgjidhje të shpejtë të kontestitit përmes teknikave të ndryshme ata duhet të këmbëngulin në gjetjen e zgjidhjes së ndërsjelltë të kontestitit dhe pa mos e zgjatur të konsultohen për të gjetur zgjidhje të ndërsjelltë për zgjidhjen e kontestitit të tyre...”⁹⁸. Edhe nga ky document që ka obligueshmëri politike, mund qartë të shohim që edhe në raste kur bisedimet dështojnë si teknikë për zgjidhjen e kontestitit prapë se prapë insistohet që përmes bisedimeve dështojnë si teknikë për zgjidhjen e kontestitit prapë se prapë insistohet që përmes bisedimeve të gjendet zgjidhja e teknikës më të përshtatshme të mundshme për të. Në çështjen e emrit të Maqedonisë, konflikti në mes të Grekëve dhe Maqedonasve është më i thellë sepse preken çështje egzistenciale të dy këtyre kombeve. Maqedonia politike që u shfaq në hartat e VMRO-s në fillim shekullin e XX është ajo që e frigëson Greqinë andaj çdo konotacion nacional i emrit Maqedoni është i papranueshëm për Greqinë ndërsa “maqedonasit “ kombin e kanë të lidhur me emrin për shkak të kohezionit nacional , emri Maqedoni ka rëndësi egzistenciale sepse mbi këtë emer kombëtar dhe shtetëror deshirojnë të mbajnë ekskluzivitetin etnik në këtë shtet. Në esence kemi kontest në mes dy shteteve që janë krijuar mbilogjikën Staliniste të komb formimit kur shteti ka formuar kombin. Pikërisht defektetë tyre janë të karakterit historik serbët formuan shtetin e tyre prej pashallëkut të Beogradit duke u marrë territore Hungarezeve, Bullgarëve dhe Shqiptarëve. Grekët u bënë shtet mbi modelin e Bizantit me një popullsi të përzier sllavobullgare, arvanite, çame , vllehe munduan të zbatojnë ideologjinë heleno-greke mbipopullatën e përzier përmes represionit ndërsa kombi maqedon u bë një krijim kominternian mbi logjikën staliniste të kombeve me involvimin e interesit serb.

⁹⁸ I/7 nga Deklarata e Manilës për zgjidhjen paqësore të kontesteve nga viti 1982.

Gjithashtu duhet potencuar që bisedimet mund të përfundojnë me zgjidhje ose mos zgjidhje të kontestit. Me zgjidhje të kontestit do të përfundojnë bisedimet atëherë kur vijnë deri tek kompromisi, respektivisht në bazë të veprimit të ndërsjelltë ose me pranimin e njërës palë të kërkesave të palës tjetër të kontestit. Por nëse bisedimet përfundojnë me mospasurë kërkimin e zgjidhjes duhet vazhduar ose me vazhdimin e bisedimeve ose përmes rrugës së teknikave tjera për zgjidhjen paqësore të kontesteve. Por në fund duhet potencuar që bisedimet që të kenë rezultat duhet të zhvillohen në frymën positive. Në pajtim me këtë palët janë të detyruara që bisedimet të zhvillojnë që ato të kenë ndonjë kuptim gjë që nuk është në rastet e njërës palë insiston në qëndrimin e vet, pa mos menduar që të njëjtin ta ndryshojnë. Nga kjo mund të nxjerrim përfundimin që detyrimi në bisedime nuk nënkupton vetvetiu edhe detyrimin për arritjen e marrëveshjes. Kjo gjithsesi nuk duhet të nënkuptojë që bisedimet nuk kanë ndonjë bazë ose puna e tyre të kufizohet si përpjekje për të gjetur zgjidhje në kontestin.

4.3 Ndryshimi i kushtetutës

Me 81 vota pro, asnjë kundër dhe të përmbajtur Kuvendi miratoi ndryshimet kushtetuese në përputhje me Marrëveshjen e Prespës, duke ndërruar emrin kushtetues të vendit nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Kryeministri Zoran Zaev në fjalimin e tij tha se bëhet fjalë për një vendim të rëndë, por me përgjegjësi të madhe. “Po është e vërtetë, unë kam ndryshuar qëndrimin rreth çështjes së ndrrimit të emrit kushtetues, por ndërrimi i qëndrimeve sjellë progress edhe me çmimin e karrierës politike”. Ai tha se VMRO-DPMNE si partia më e madhe opozitare e ka të qartë se vështirë do të ishte arritur një marrëveshje më e mirë dhe se pa Greqinë nuk do të ishte e mundur vazhdimi i rrugës drejt BE dhe NATO. Me vendimin e sotëm,

Kuvendi ndërroi emrin kushtetues të vendit dhe çështje tjera në kuadër të Kushtetutës, përmes amendamenteve, të cilat janë dakorduar edhe me partitë shqiptare të opozitës dhe grupit parlamentar të tetë deputetëve të larguar nga VMRO-DPMNE, të cilët siguruan shumicën absolute. Fillimisht gjatë debatit janë miratuar amendamentet e propozuara kushtetuese nga ana e Qeverisë, por të plotësuara më pas nga negociatat me Aleancën për Shqiptarët dhe Lëvizjen BESA.

Amandamenti 33: Në Kushtetutë fjalët “Republika e Maqedonisë” ndërrohen me fjalët “Republika e Maqedonisë së Veriut”, ndërsa fjala “Maqedoni” me “Maqedonia e Veriut”, përveç se në nenin 36 të Kushtetutës.

Amandamenti 34: Fjalët “që jetojnë në kufijt e tyre” ndërrohen me fjalët “si dhe qytetarët që jetojnë në kufijt e tyre, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si pjesë të popullit shqiptar, popullit turq.....”

Amandamenti 35: “Republika respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike nga vendet fqinje” duke plotësuar nenin 3 të Kushtetutës.

Amandamenti 36: “Republika mbron, garanton dhe përkujdeset për trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas; ... mbron të drejtat dhe intereset e shtetasve të saj që jetojnë dhe qëndrojnë jashtë vendit; Me ndryshimet e reja teksti ndryshon dhe thuhet: Republika përkujdeset për diasporën e popullit maqedonas dhe për pjesën e popullit shqiptar, pjesën e popullit turq, vllleh, serb dhe përparon lidhjet e tyre me atdheun. Në bazë të nenit 131 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, miratoi

4.2.1 VENDIM PËR SHPALLJEN E AMENDAMENTEVE XXXIII, XXXIV, XXXV DHE XXXVI TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shpallen amendamentet XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i miratoi në seancën e mbajtur më 11 janar 2019.

Amendamentet XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hynë në fuqi në Marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit për Siguri të Kombeve të Bashkuara, për pushimin e vlefshmërisë së Marrëveshjes së përkohshme nga viti 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve dhe ratifikimi i Protokollit për aderim në NATO nga Faqja e parë e Marrëveshjes përfundimtare.

AMENDAMENTET XXXIII, XXXIV, XXXV DHE XXXVI TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Këto amendamente janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hynë në fuqi në Marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit për Siguri të Kombeve të Bashkuara, për pushimin e vlefshmërisë së Marrëveshjes së përkohshme nga viti 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve dhe ratifikimi i Protokollit për aderim në NATO nga Faqja e parë e Marrëveshjes përfundimtare.

AMENDAMENTI XXXIII

1. Në Kushtetutë fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”, kurse fjala “Maqedoni” zëvendësohet me fjalët: “Maqedonisë së Veriut”, përveç në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXIV

1. Në Preambulë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë shlyhen fjalët: “si dhe qytetarët të cilët jetojnë në kufijtë e sajë të cilët janë”, “vendimet e KAÇKM” zëvendësohen me fjalët: “vendimet juridike të cilat janë theksuar në Shpalljen nga Mbledhja e parë e KAÇKM për popullin maqedonas për mbledhjen e mbajtur të KAÇKM”, pas fjalës “vit” shtohen fjalët: “në të cilat u shpreh vullneti për krijimin e shtetit të pavarur sovran dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit”, kurse shlyhen fjalët: “vendosën të”.

2. Me këtë amendament bëhen ndryshime në Preambulën - Amendamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXV

1. Republika e respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje.

2. Me këtë amendament plotësohet neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

AMENDAMENTI XXXVI

1. Republika i mbron, garanton dhe kujdeset për veçoritë, trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas.

Republika i mbrohet të drejtat dhe interesat e shtetasve të vet të cilët jetojnë ose qëndrojnë jashtë vendit.

Republika kujdeset për diasporën e popullit maqedonas dhe për pjesë nga populli shqiptarë, populli turk, populli vllah, populli serb, populli rom, populli boshnjak dhe të tjerët, kujdeset dhe i avancohet lidhjet me atdheun.

Republika më pas nuk do të përzihet në të drejtat sovranë të shteteve tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

3. Me këtë amendament zëvendësohet neni 49 dhe Amendamenti II i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

4.3 Ratifikimi i protokollit

Maqedonia e Veriut ka bërë një hap të rëndësishëm përpara në procesin e anëtarësimit në NATO, pas firmosjes së protokollit për pranimin e vendit në Bruksel mëngjesin e të mërkurës. Por cilat janë përfitimet dhe detyrimet që tashmë do të ketë vendi. Pas anëtarësimit në NATO përfitimet për Maqedoninë e Veriut do të jenë përtej sferës së sigurisë. Me anëtarësimin në NATO, Maqedonia e Veriut konsiderohet si një vend i sigurt dhe me ekonomi të konsoliduar. Nisur nga kjo, investitorët e huaj do të kthejnë sytë nga vendi për të investuar. Për të vërtetuar këtë ide, analistët kanë marrë shpeshherë si rast shembullin e Çekisë, e cila, pasi u anëtarësua në NATO, pati një bum investimesh, të cilat kapën shifrën e 9 miliardë eurove. Me hyrjen në NATO forcohet edhe roli i vendit në arenën ndërkombëtare dhe Maqedonia e Veriut fiton një peshë lobingu. Por veç përfitimeve, anëtarësimi në NATO do të sjellë edhe disa detyrime për vendin.

Hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO e detyron politikën të ndërtojë një demokraci funksionale, të krijojë shtetin ligjor dhe të forcojë institucionet, tre elemente këto shumë të rëndësishëm, nga të cilat ka vuajtur politika në këto vite të tranzicionit të vështirë. Gjithashtu vendi duhet të rrisë investimet në ushtri duke realizuar reformat e domosdoshme sipas standardeve euroatlantike duke u pajisur edhe me armatime moderne. Ndërkohë që Maqedonia e Veriut do të ketë dhe një detyrim të përvitshëm për të derdhur në arkën e NATO-s një shumë të caktuar, në varësi të buxhetit të vendit dhe mesatares së vendeve anëtare. Ndër përfitimet pas anëtarësimit në NATO renditen të qënurit pjesë e aleancës më të suksesshme të kohëve moderne, forcimi i rolit të vendit në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu reformat për NATO-n afrojnë vendin më shumë me BE-në.⁹⁹

⁹⁹ abcnews.al

KAPITULLI I PESTË

5. Përfundimi

Maqedonia është vend të cilën e zbukurojnë shumë bukuri natyrore. Është e pasur më: pyje, livadhe, fusha pjellore, liqenj dhe lumenj, shpella, ujëvare, monumente kulturore-historike... Është e pasur me botë bimore dhe shtazore të ndryshme. Ajo është djep i diturisë ku krijojnë dijetarë të njohur. Republika e Maqedonisë në veri kufizohet me Republikën e Serbisë, me kryeqytetin e saj Beogradin. Republika e Serbisë nuk ka dalje në det. Relievi në Serbi është i llojllojshëm. Klima kryesisht është mesatare-kontinentale. Atdheu ynë në jug kufizohet me Republikën e Greqisë. Kryeqyteti është Athina. Greqia është shtet ishullor dhe gadishullor. Është anëtare e Unionit Evropian. Ka dalje në Detin Egje, Detin Jon dhe Detin Mesdhe. Relievi në Greqi është kryesisht malor. Klima është mesdhetare dhe malore. Republika e Maqedonisë në lindje kufizohet me Republikën e Bullgarisë, me kryeqytetin Sofja. Bullgaria është anëtare e Unionit Evropian. Nëpër Bullgari kalon njëri nga koridoret më të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik. Bullgaria ka dalje në Detin e Zi. Klima është bregdetare, mesatare-kontinentale dhe malore. Pjesa më e madhe e relievit është malor. Maqedonia në perëndim kufizohet me Republikën e Shqipërisë, me kryeqytetin Tirana. Shqipëria është vend ballkanik dhe mesdhetar. Ka dalje në Detin Adriatik dhe në Detin Jon. Klima në Republikën e Shqipërisë është mesdhetare dhe mesatare-kontinentale. Relievi kryesisht është malor. Në veriperëndim kufizohet me Republikën e Kosovës me kryeqytetin Prishtina. Relievi i Republikës së Kosovës është i llojllojshëm. Klima është kontinentale me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë dhe me borë.

Si përfundim, ate çka dëshiroj dhe do të mundohem ta sqaroj në këtë punim magjistrature, duke ndërthurë mendime dhe studime të aktorëve të ndryshëm të fushës së historisë, politikës, sociologjisë, ekonomisë, kulturës etj. Nëpërmjet studimeve apo analizave të aktorëve të ndryshëm të shkencës së historisë dhe politikologjisë dhe shkencave tjera shoqerore synohet që të shohim

realitetin e krijuar në shekullin e kaluar dhe pasojat me të cilat u përballëm në kohërat e sotme. Ky është dhe qëllimi i këtij punimi, të krijojë një hulumtim shkencor për të parë se ç'probleme dhe zhvillim ka pasur RMV dhe, cilat probleme dhe zhvillime paraqiten sot dhe cilat zhvillime do të paraqiten në të ardhmen. Duke parë problematikën ekzistuese të RMV dhe duke bërë qasje me përvojën e autorëve të huaj dhe nga rajoni mendojmë se do t'i vijmë në ndihmë kërkimit shkencor duke dhënë fakte, analiza , kërkime dhe dokumente të reja. Republika e Maqedonisë në veri kufizohet me Republikën e Serbisë, me kryeqytetin e saj Beogradin. Republika e Serbisë nuk ka dalje në det. Relievi në Serbi është i llojllojshëm. Klima kryesisht është mesatare-kontinentale. Atdheu ynë në jug kufizohet me Republikën e Greqisë. Kryeqyteti është Athina. Greqia është shtet ishullor dhe gadishullor. Është anëtare e Unionit Evropian. Ka dalje në Detin Egje, Detin Jon dhe Detin Mesdhe. Relievi në Greqi është kryesisht malor. Klima është mesdhetare dhe malore. Republika e Maqedonisë në lindje kufizohet me Republikën e Bullgarisë, me kryeqytetin Sofja. Bullgaria është anëtare e Unionit Evropian. Nëpër Bullgari kalon njëri nga koridoret më të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik. Bullgaria ka dalje në Detin e Zi. Klima është bregdetare, mesatare-kontinentale dhe malore. Pjesa më e madhe e relievit është malor. Maqedonia në perëndim kufizohet me Republikën e Shqipërisë, me kryeqytetin Tirana. Shqipëria është vend ballkanik dhe mesdhetar. Ka dalje në Detin Adriatik dhe në Detin Jon. Klima në Republikën e Shqipërisë është mesdhetare dhe mesatare-kontinentale. Relievi kryesisht është malor. Në veriperëndim kufizohet me Republikën e Kosovës me kryeqytetin Prishtina. Relievi i Republikës së Kosovës është i llojllojshëm. Klima është kontinentale me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë dhe me borë. Në shek. VIII para erës së re ka filluar me bashkimin e fiseve maqedonase në një shtet të vetëm. Në krye të shtetit ka qendruar mbreti. Për themelues të shtetit maqedonas llogaritet mbreti Perdika. Trashigimtarët e

Perdikës kanë tentuar që ta forcojnë dhe zgjerojnë shtrirjen e shtetit. Ekspanzion më të madhë shteti maqedonas ka pasur në kohën kur kanë sunduar mbretërit Filipi i II dhe Aleksandri i III. Atëherë Maqedonia është ngritur në shtet të fuqishëm botëror – “Zotëreshë e botës”, siç e kanë quajtur autorët e antikës. Me ardhjen dhe shpërnguljen e fiseve maqedonase në shek. VI dhe më përzierjen e tyre banorët maqedonas antikë, më në fund në shek. X dhe XI bëhet formimi i popullit modern maqedonas, i cili deri më sot është shumicë në territorin e Maqedonisë. Nga fundi i shekullit VI dhe fillimi i shekullit VII në territorin e Maqedonisë kanë ardhur sllavët. Paraatdheu i tyre ka qenë pas Karpateve, mirëpo për shkaqet e këqia të jetesës, si edhe sulmet nga fqinjët, ata filluan të shpërngulen. Duke kërkuar kushte më të mira për jetesë janë drejtuar në tri drejtime: në lindje, në perëndim dhe në jug. Ata, të cilët u nisën për në jug, quhen sllavë të jugut. Në atdheun e tyre sllavët nuk kanë pasur shkrim, një kohë të gjatë me vija dhe vijëza “lexonin dhe hidhnin fall”. Kur kanë ardhur në Ballkan dhe janë krishterizuar, fjalët sllave i kanë shkruajtur me shkronja romake dhe greke, pa rregulla. Me shkrim të tillë nuk ka qenë e mundur të shkruhen shumë fjalë sllave. Në alfabetin grek nuk ka pasur shkronja për shumë tinguj sllavë. “Më pas shën Konstantin-Qiril ka krijuar 38 shkronja, disa sipas shkronjave greke, të tjerat sipas nevojës së gjuhës sllave”. Vëllezërit Qiril dhe Metodij kanë qenë shumë të ditur. Ata e kanë krijuar alfabetin e parë sllav – glagolicën, ndërsa nxënësit e tyre Klimenti dhe Naumi e kanë falur dhe shkrimin e ri e kanë quajtur kirilicë. Me krijimin dhe zgjerimin e shkrimit dhe letërsisë sllave Maqedonia ka dhënë kontribut në kulturën botërore. Në mesin e shekullit X ka qenë i krijuar shteti mesjatar maqedonas. Në krye të shtetit ka qenë Car Samoili. Ai ka pasur ushtri të fuqishme. Me luftërat fituese, që i ka udhëhequr, e ka zgjeruar shtetin në veri deri te Dunabi dhe Sava, në jug deri në Thesali, në perëndim deri te Deti Adriatik dhe në lindje deri te Deti i Zi. Në luftë në Belasicë (viti 1014), me Bizantin, car Samoili ka pësuar disfatë, ndërsa 14000 ushtarët e

tij i kanë verbuar. Pas asaj ndodhie car Samoili ka ndërruar jetë. Shteti mesjatar maqedonas ka ekzistuar deri në vitin 1018, kur është përfshirë në kuadër të shtetit Bizantin. Në fund të shek. XIV Maqedonia ka qenë e sunduar nga turqit – osmanllinjë dhe është futur në përbërjen e Imperisë otomane. Populli maqedonas shpesh është ngritur në kryengritje. Forma më e vjetër e armatosur e rezistencës ka qenë hajdutëria. Kryengritja e madhe e parë në Maqedoni ka ndodhur në vitin 1689 nën udhëheqjen e Karposhit. Në format e rezistencës kundër Imperisë otomane ka marrë pjesë edhe biskupi shkupjan Pjeter Bogdani. Lëvizja e çlirimit në Maqedoni është përforcuar në shek. XIX. Atëherë kanë ndodhur më shumë kryengritje (e Negushit, e Razllovecit dhe e Kresnenit). Shteti bashkëkohor maqedonas është krijuar gjatë luftës katërvjeçare antifashiste dhe nacionalçlirimtare (1941-1944). Lufta e Dytë botërore për Maqedoninë ka qenë ndarje e re e teritorit kombëtar, asimilimit kombëtar dhe eksploatimit ekonomik. Duke qëndruar në anën e koalicionit antifashist, populli maqedonas është nisur në luftë të armatosur për realizimin e idealeve dhe të aspiratave shekullore – lirim dhe krijim të shtetit të tyre kombëtar. Rezistenca antifashiste ka qenë e organizuar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) në krye me Jusip Broz Tito, respektivisht të Partisë Komuniste të Maqedonisë (PKM). Lufta për çlirim në Maqedoni ka filluar më 11 Tetor të vitit 1941. Atëherë janë shtënë pushkat e parë në Prilep dhe Kumanovë. Për këtë arsye 11 Tetori festohet si festë e kryengritjes së popullit maqedonas. Nga këto qytete lufta është transferuar në gjithë vendin. Luftën e kanë udhëhequr partizanët. Në luftën Maqedonia ka dhënë shumë viktima mes të cilëve janë edhe heronjtë kombëtarë: Strasho Pinxhur, Ibe Palikuqa, Mirçe Acev, Cvetan Dimov, Kuzman Josifovski-Pitu, Vera Ciriviri – Trena, Liman Kaba, Bajram Shabani etj. Në 2 gusht të vitit 1944 në manastirin Prohor Pçinski është mbajtur mbledhja e parë e ASNOMIT. Në këtë mbledhje janë sjellë shumë vendime, me të cilat është deklaruar krijimi i shtetit maqedonas dhe janë miratuar organet

e saja më të larta. Kryetar i parë është zgjedhur Metodija Antonov – Çento. Për Maqedonin ASNOM ka rëndësi tepër të madhe: Maqedonia është deklaruar si shtet; gjuha maqedone është e pranuar si gjuhë zyrtare, qytetarët të cilët jetojnë në Maqedoni, pa dallim religjioni, kombi apo gjinie janë qytetarë të barabartë... Pas luftës së dytë botërore Maqedonia është në përbërje të Federatës së Jugosllavisë (RSFJ) si Republikë e barabartë. Pas luftës Maqedonia është e shkatërruar dhe vend i pazhvilluar. Pasuritë natyrore dhe pjesëmarrja e popullit në ndërtimin dhe rinovimin e shtetit sjellin zhvillim të shpejtë ekonomik. Maqedonia ndërtohet dhe përparon, bëhet eletrifikim në fshatrat, ndërtohen rrugë moderne, hekurudha, fabrika, hidrocentrale, institucione shëndetësore, kulturore dhe arsimore. Republika e Maqedonisë morri kandidaturën për anëtarësimin në BE. Procesi i integritetit është proces i gjatë dhe i rëndë. Për t'u afruar deri te vlerat e BE-së, Maqedonia ka dhënë mund të madh për realizimin e shumë reformave. Republika e Maqedonisë duhet t'i përmbushë edhe disa obligime për t'u bërë anëtare në Union: - Të vendosë rend dhe paqë në territorin e saj; - Të mundësojë qeverisjen e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut; - Të forcojë demokracinë; - Të mundësojë mbrojtje sociale më të madhe të qytetarëve; - Të rrisë zhvillimin ekonomik; - Të zvogëlojë papunësinë; - Të zvogëlojë ndotjen e ambientit jetësor. Republika e Maqedonisë me mbështetjen e qytetarëve, hapëron drejt evrointegritimeve. Sulmet terroriste shkaktojnë frikë, viktima dhe dëmtime të mëdha materiale. Republika e Maqedonisë e jep kontributin e saj për ruajtjen e paqes botërore, sigurinë lufta kundër terrorizmi me pjesëmarrjen aktive të njësive ushtarake të ARM-së në forca paqësore. Veçanërisht duhet të theksohet bashkëpunimi i Republikës së Maqedonisë në suaza të Këshillit partner Evroatlantik dhe Partneriteti për paqe, si edhe bashkëpunimi me NATOshtetet në përforcimin e sigurisë së përbashkët dhe paqen në botë. Hulumtimet në temën afrimi i Maqedonisë në NATO e kanë rëndësinë e tyre teorike shkencore për formimin e qëndrimit shkencor për arsyetimin e proceseve

integruese euroatlantike, të cilat e çojnë vendin në anëtarësimin e plotë në NATO. Në këtë punim janë hulumtuar mundësitë për afrimin e Maqedonisë në NATO, me theks të posaçëm në implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit duke i respektuar normat, vlerat dhe standardet të cilat në masë të madhe e stimulojnë stabilitetin e brendshëm politik dhe ekonomik dhe po aq nxisin projekte për bashkëpunim regjional. Në parashtrimin e këtij fenomeni shoqëror janë marrë në konsideratë botëkuptimet bashkëkohore për politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, proceset demokratike dhe respektimi i të drejtave të njeriut, bashkëpunimi regjional dhe stabiliteti i qëndrueshëm i brendshëm dhe regjional, si dhe botëkuptimet e qarta për integrimet euroatlantike si projekt real për integrimin e Maqedonisë në NATO. Është fakt se në proceset integruese euroatlantike janë të pranishme marrëdhëniet konkurruese ndërmjet shteteve për anëtarësimin e tyre që megjithatë janë të detyruara të bashkëpunojnë për ndërtimin e marrëdhënieve ndërshtetërore të mirëbesimit reciprok të bazuar në standardet që ofrohen nga NATO. Në konceptin bashkëkohor për zbatueshmërinë e integritimeve me rëndësi të veçantë është kuptimi për rolin "ndërvarësisë në marrëdhëniet ndërkombëtare" që paraqet ndikim fundamental edhe për NATO-n dhe për proceset integruese. Për jetësimin e interesave strategjike për anëtarësimin e saj në strukturat euroatlantike në NATO dhe BE, Republika e Maqedonisë i definon vlerat për bashkëpunim regjional, si dhe për bashkëpunim me fqinjët, kjo si nxitje themelore e bashkëpunimit regjional, që mundet të arrihet përmes bashkëpunimit politik, ekonomik, kulturor, arsimor dhe përmes llojeve të tjera të bashkëpunimit, si të atij bilateral dhe regjional. Me këtë do të vendosej dialogu në disa nivele dhe do të krijoheshin më tepër mundësi për besimin më të madh në ofrimin e popujve që jetojnë në shtetet e Europës Juglindore. Nëse veprimet konkrete të Qeverisë së Maqedonisë janë të mirëfillta për procesin që çon drejt integritit të Maqedonisë në NATO dhe BE, ato mund të kuptohen edhe si sinjale për jetësimin e

një integrimi politik të brendshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përmbajtje politike dhe ekonomike dhe për një paqe të qëndrueshme nëse implementohet Marrëveshja e Ohrit sipas dinamikës së paraparë. Atëherë mund të konstatohet se mosmarrëveshjet shqiptaromaqedonase që kanë mbretëruar me vite tani nuk heshten, por zgjidhen. Pastaj, sa ekziston besimi i mirëfilltë dhe si prezantohet kjo politikë integruese para qytetarëve dhe në vetë elektoratin, sepse kjo komponentë është mjaft me rëndësi sidomos në shtetet shumë nacionale?! Një veprim i tillë i konkretizuar jep shpresë se shumë pak do të ketë hapësirë për situata konfliktuale ose edhe të nivelit të konfliktit ndërnacional. Megjithatë pastaj mund të bëhet fjalë për destabilizim eventual krejt nga një problematikë tjetër që mund t'i prekë njësoj interesat e qytetarëve, probleme me të cilat ballafaqohet bota e sotme. Në raportet politike të analizuar në këtë periudhë, në këto katërmëdhjetë vitet e kaluara, me fitues dhe humbës, vështirë arrihen qëllimet strategjike për stabilitet ndërnacional, ekonomik, politik, social dhe të sigurisë së shtetit. Këto rrethana të kontradiktave politike dhe më të ndjeshme bëhen nëse nga cila do palë paraqiten politikanë me moral të dyfishtë, herë në rolet e radikalëve e herë-herë si politikanë të moderuar. Të gjithë ata politikanë dhe njerëz me influence politike duhet të kenë mirëkuptim që në paraqitjet e tyre publike, të jenë të kujdesshëm dhe me siguri ky veprim i tyre do të jetë pjesë e kontributit të tyre në tejkalimin e kësaj situatë të krizës. Sjelljet e politikanëve me moral të dyfishtë në disa momente edhe më shumë i penguan proceset integruese brenda shtetit, e penguan afrimin e interesave të përbashkëta midis maqedonasve dhe shqiptarëve në ndërtimin e rendit demokratik dhe të barazisë kushtetuese ndërmjet këtyre dy etnive. Tani paraqitet arsyeja e pakontestueshme e implementimit të plotë e Marrëveshjes së Ohrit. Këtë e kërkojnë pjesa dërrmuese e qytetarëve të Maqedonisë. Këtë e kërkojnë diplomatët më me ndikim në qendrat e vendosjes në Uashington, Bruksel, Londër e Berlin. Këtë e kërkon edhe kreu udhëheqës i NATO-s. Këtë e kërkojnë miqtë

e shqiptarëve dhe të maqedonasve. Nga përvojat e shteteve në tranzicion, por edhe nga përvojat me të cilat u ballafaqua Republika e Maqedonisë, në katërmëdhjetë vitet e fundit u dëshmuua fakti se për stabilitetin e shtetit dhe për sigurinë e tij nuk janë vendimtare forcat represive, ushtria e fortë dhe policia, por për ndikimin për krijimin e një shoqërie stabile me një siguri të qëndrueshme janë disa parametra të tjerë, si: ngritja e nivelit të demokracisë, respektimi i të drejtave të njeriut, kultivimi i raporteve të mira ndëretnike, mirëqenia ekonomike dhe sociale etj. Veprimet e politikanëve që janë të prirë të nxisin procese pozitive, duke iu përkushtuar paraqitjeve publike që mund të jenë ndikuese, krijojnë hapësirë për implementimin e konstelacionit të ri të forcave politike për koalicione të afrimit dhe afirmimit të qëndrimeve që i afrojnë njerëzit. Potenciali politik kadrovik që e kanë shqiptarët dhe maqedonasit në Republikën e Maqedonisë duhet të jetë në shërbim të afrimit të pozicioneve të interesit shtetëror për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE. Në RM, nga strukturat politike të pushtetit dhe ato opozitare, duhet të krijohen kushte reale për harmonizimin e aktiviteteve politike, për krijimin e besimit të ndërsjellë ndëretnik dhe në të gjitha aktivitete integruese brenda shtetit, ato dallime të shndërrohen në luftë politike, duke e avancuar formën e dialogut të mirëfilltë për ruajtjen e vlerave të interesit të përbashkët që maqedonasit dhe shqiptarët e Maqedonisë e kanë në shtetin e përbashkët në Republikën e Maqedonisë.

5.1 Vlersime individuale

Për aktivitetet që duhet t'i ndërmarrë Maqedonia në mënyrë që ta tejkalojë këtë fazë të tranzicionit kuptohet se janë hartuar strategji edhe në nivelet më të larta të shtetit. Në këtë rast ne nuk do të zbulonim diçka të re, por do t'i theksonim ato që në këtë moment janë prioritare dhe shumë të rëndësishme. Integrimi ekonomik rajonal pati ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së shteteve anëtare të reja në BE. Njëra nga detyrat e para që duhet të ndërmerret në Maqedoni është zvogëlimi i papunësisë. Zbutja e këtij problemi më së miri do të realizohej nëse Maqedonia tërheq sa më shumë investime të drejtpërdrejta të huaja. Investimet e drejtpërdrejta të huaja (IDH) në vendin mikpritës – në Maqedoni - do të ndikonin për rritjen e numrit të të punësuarve në dy mënyra: 1. Rritja e drejtpërdrejtë e numrit të të punësuarve dhe 2. Rritja e tërthortë e numrit të të punësuarve. Në rritjen e drejtpërdrejtë të të punësuarve kemi rritjen e numrit të të punësuarve me rastin e ardhjes dhe funksionimit të kompanisë së huaj. Kompania e cila investon, krijon vende të lira të punës dhe e punëson një numër të nevojshëm të punëtorëve. Hyrja e IDH-së dhe zhvillimi i veprimtarisë së kompanisë investuese kërkon edhe furnizimin me materiale dhe logjistikë të cilën ajo e merr nga firmat vendase. Kështu edhe firmat vendase e rrisin numrin e punëtorëve në radhët e tyre. Në disa vende ka ndodhur që kjo rritje e punëtorëve në formë të tërthortë të jetë më e madhe sesa numri i punëtorëve të punësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pagat e të punësuarve në këtë kompani që investojnë në vendin mikpritës janë më të mëdha se pagat e punëtorëve në firmat vendore. Po ashtu puna është më e sigurt, sepse kompanitë multinacionale prodhojnë sasi të mëdha të prodhimit dhe kanë treg më të gjerë të plasmanit të prodhimeve të tyre. Punëtorët janë më të kënaqur edhe me kushtet e punës të cilat sigurohen nga kompanitë multinacionale. (MNC). Investimet e drejtpërdrejta të huaja kanë

rëndësi të madhe në zhvillimin e ecurive ekonomike të Maqedonisë. Ato kanë rëndësi edhe për sa i përket avancimit të procesit të prodhimit, transferimit të teknologjisë, shfrytëzimit optimal të kapaciteteve prodhuese, si dhe organizimit më të mirë të punës. Maqedonia qysh nga pavarësia e saj nuk mund të jetë e kënaqur sa i përket IDH-së. Ajo gjatë viteve të tranzicionit gjithmonë qëndronte në vendin e fundit për sa i përket investimeve të drejtpërdrejta të huaja. Sasinë më të madhe të IDH-së (449 milionë USD) e realizoi në vitin 2001, atëherë kur privatizoi telekomunikacionin. Në vitin 2003 IDH-ja nuk arriti më shumë se 80 milionë USD që në krahasim me vitin paraprak kishte një rritje të vogël prej 2.8 milionë USD. Në vitin 2004 IDH-ja u rrit në 157 milionë USD, por kjo nuk shënoi ndonjë sukses të madh. Investimet e drejtpërdrejta të huaja luajnë rol crucial në riformimin dhe rishtruktuirimin organizativ të ndërmarrjeve në këto kushte të ndryshimeve dinamike dhe në kontekst të tregut global të mallrave dhe shërbimeve. IDH-ja me siguri do të vazhdojë të luajë rol të madh në ekonominë botërore. Maqedonia do të ketë përfitime nga IDH-ja edhe në aspekt të përmirësimit të bilancit të pagesave. Kur bëhet fjalë për bilancin e pagesave të një vendi, duhet theksuar se shqetësim i përhershëm i vendit është që të mos ketë bilanc deficitar të pagesave. Vendi i cili në fund të vitit shënon bilanc deficitar të pagesave ka pasoja dhe reperkusione negative në zhvillimin e ekonomisë. Në rast se kompanitë multinacionale nëpërmjet degës së vet e rrisin sasinë e prodhimit të vendit mikpritës, atëherë rriten edhe mundësitë për zmadhimin e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe për rritjen e hyrjes së devizave në vend. Po ashtu përmirësimi i bilancit të pagesave të vendit mikpritës do të ndodhë nëse dega e kompanive multinacionale prodhon mallra ose ofron shërbime të cilat më parë janë importuar në vend. Kështu Maqedonia nuk do të ketë detyrime devizore ndaj shteteve furnizuese të mallit konkret. Përfitimi me rritjen e konkurrencës dhe shtimin ekonomik në vendin mikpritës - paraqet njërin nga përfitimet e vendit mikpritës nga IDH-ja. Prodhimi dhe ofrimi i

shërbimit të degës së MNC-së e rriti konkurrencën në vendin mikpritës. Duke e parë rrezikun nga konkurrenca e prodhuesit të jashtëm, prodhuesi vendor do të jetë i detyruar të angazhohet më tepër në mënyrë që të jetë konkurrues në treg. Konkurrenca e rrit kualitetin dhe kuantitetin e mallrave. Nëse oferta e prodhimeve rritet kur kërkesa është konstante, atëherë kemi zvogëlimin të çmimeve të mallrave dhe prodhimeve. Zvogëlimi i çmimeve është në favor të konsumatorëve dhe kjo njëherazi e rrit mirëqenien dhe standardin e qytetarëve. Shembull tipik të zvogëlimit të çmimeve në tregun e vendit e kemi zvogëlimin e çmimeve të shërbimeve të telekomunikimit. Në vendet në tranzicion me privatizimin e kompanive të telekomunikacionit çmimi i shërbimeve të telefonisë pësoi zvogëlim dhe rënie permanente. Aktivitet tjetër prioritar të cilin duhet ta realizojë Maqedonia është rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Kjo mund të arrihet njësoj si edhe me IDHnë duke u inkuadruar në integrimet ekonomike rajonale. Maqedonia në vitet e kaluara nuk mund të mburret me rezultatet e saj nga këmbimi ndërkombëtar. Edhe pse kohëve të fundit eksporti i mallrave shënon rritje të vazhdueshme, megjithatë bilanci tregtar negativ shënon rritje. Rajoni i Ballkanit Perëndimor para 15 viteve gjendej në një udhëkryq të madh. Sot, duke u inkuadruar në integrimet e ndryshme, rajoni duket shumë më stabil dhe ekonomisht shumë më i qëndrueshëm. Ballkani Perëndimor, përfshirë edhe Maqedoninë, integrohen gjithnjë e më tepër me shpresë se anëtarësimi në familjen e madhe europiane do të jetë më i shpejtë, ndërsa përfitimet nga ky anëtarësim do të jenë: rritja e vazhdueshme e shtimit ekonomik, rritja e standardit dhe mirëqenies njerëzore, zvogëlimi i numrit të papunëve, reduktimi i varfërisë, transferimi i teknologjisë, etj. Integrimi ekonomik i vendeve të Ballkanit Perëndimor ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik të tyre. Rritja dhe zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik para së gjithash bazohet në faktin se vendet e rajonit kanë nivel të zhvillimit ekonomik të njëjtë, andaj edhe ekonomia e tyre është komplementare. Normalisht, kur

kjo ekonomi është e integruar, ajo paraqet një ekonomi të plotë e cila është më efikase. Nga analizat e bëra del se Maqedonia me privilegjet dhe pozitën që e ka ndaj BE-së dukshëm e ka përmirësuar këmbimin tregtar, sidomos rritjen e eksportit. Me siguri se me rrumbullakimin e reformave ekonomike, me shtimin e prodhimit dhe liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare, Maqedonia do ta rrisë këmbimin tregtar si edhe bashkëpunimin dhe integrimin e saj në institucionet euroatlantike. Pa dyshim se inkuadrimi i Maqedonisë në integrimet rajonale është më se i domosdoshëm. Për realizimin e këtij synimi nuk duhet të angazhohen vetëm organet shtetërore të vendit, por gjithë popullata duhet ta japë kontributin e saj. Natyrisht përgjegjësia më e madhe është te qeveritarët të cilët duhet ta trasojnë rrugën më të lehtë dhe më të shkurtër që shpie në Europë, por edhe pjesa tjetër e popullatës i ka detyrat e saj në këtë drejtim. Inkuadrimi i Maqedonisë në tregtinë ndërkombëtare dhe shtimi permanent i eksportit të saj është njëri prej prioritetëve të politikës zhvillimore të vendit. Angazhimet dhe intensifikimi në këtë segment ekonomik paraqet shtyllën më të rëndësishme të zhvillimit dhe prosperitetit të vendit. Eksporti së bashku me faktorët e tjerë të zhvillimit ekonomik e siguron shtimin dinamik të GDP-së dhe rritjen e standardit dhe të mirëqenies të popullatës.

▪ Literatura e konsultuar

1. Balkan cultural commonality and ethnic diversity. Raymond Detrez (Ghent University, Belgium).
2. Balkan Social Science Review, Vol.4, December 2014, 295-323
3. Blerim Reka, Studime Europiane, UEJL, Tetovë, 2004
4. Brounbauer U. (2004). Historiography, Myths and the Nation in the Republic of Macedonia. In Brounbauer U and Kasser K. (ed), Historiography in Southeast Europe after Socialism. Graz: Lil verlae Munster.
5. Brownlie I, Principles of Public International Law, Claredon Press, Oxford, 1990
6. Brubaker, R. (1999). Citizenship and Nationhood in France and Germany. Harvard. Harvard Press.
7. Collier and Lowe, The Settlement of Disputes in International Law, Oxford, 1999
8. D. Maleski, Me|unardna politika, Me|uzavisnost vo svetskata politika, Praven fakultet pri Univerzitetot "Sv. Kiril i Metodij", Skopje, 2000
9. Deklaratë dhënë për televizionin kombëtar Alsat-m me datë 06/04/2010, [ëëë.alsat-m.tv](http://www.alsat-m.tv)
10. *Dimitar Bechev, Historical Dictionary of the Republic of Macedonia, Scarecrow Press, 2009, ISBN 0810862956,*
11. Dokumenti 95-27866, 15 Shtator 1995, Nju Jork, Në përputhje me rezolutën 849(1993) të Këshillit të Sigurimit nga: Sajrus Vens – i dërguar i posaçëm i Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
12. Dr. Alban Daci, “Një bashkëjetesë e “detyruar” mes Sllavo-maqedonasve dhe Shqiptarëve”, <http://www.forumivirtual.com/analiza/21868-ceshtja-e-maqedonise.html>

13. Dr. Alban Daci, “Një bashkëjetesë e “detyruar” mes Sllavo-maqedonasve dhe SCqiptarëve”,
14. E. Gidens, Tretiot pat, Obnova na socijal-demokratijata, Skopje, 2002
15. Ėilkinson H. R. (1951) Maps and politics: a revieĉ of the ethnographic cartography of Macedonia. Liverpool: Liverpool University Press.
16. **Hercules Furens Seneca-** *Seneca Tragedies*; Vol 1; Prkth. Nga F.J.Miller; London, 1917
Zejnulla Gruda, E drejta ndĕrkombĕtare publike, Prishtinĕ, 2003
17. History of the Balkans, Vol. 2: Tĕentieth Century. Barbara Jelavich, 1983.
18. <https://www.scribd.com/document/116132813/Thelbi-i-Kontestit-Greqi-Maqedoni>
19. I.M. Makinda, Sovereignty and international security: challenges for the UN, Global Governance 2 (1996) str. 149-168; Jarat Chora and Thomas G. Ėeiss: Sovereignty is no longer sacrosanct: Codifying humanitarian intervention, Ethics, International affairs, 1992
20. I/7 nga Deklarata e Manilĕs pĕr zgjidhjen paqĕsore tĕ kontesteve nga viti 1982.
21. Institute for Regional and International Studies, Bulgaria for NATO - 2002, Open society foundation Sofia, Sofia, 2002
22. Interim Accord, the Memorandum of 13 October 1995.
23. Interim accord between Macedonia and Greece, New York, 13/09/1995.
24. J.G, Merillis, International Dispute Settlement, 4th edition, 2005
25. **Joshua S. Goldstein-** *Marrĕdheniet Ndĕrkombetare*; Shtĕpia Botuese Dituria, 2003
26. L. Uolltĕr, Europa nĕ kohĕn tonĕ, faqe 13, Dituria, Tiranĕ, 1996
27. Loring Danforth, *The Macedonian Conflict: Ethnic Nationalism in a Transnational Ėorld*, Princeton University Press, 1995,

28. Mr. Bujar Zylfiqari, Maqedonia – Identiteti dhe Integrimet, Autori është magjistër i Diplomacisë në Fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, aktualisht i punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes së RM-së, bujarzylfiqari@gmail.com
29. Nacev i R. Načevski, Vojna, mir i bezbednost, str. 405, Skopje, 2000
30. NATO Handbook, NATO Office of information and Press, Brussels, 2001
31. NATO Office of Information and Press The, Brussels, Belgium: Reader's Guide to the NATO Summit in Washington, 23 -25 april 1999
32. Nazmi Maliqi, Toleranca politike ne funksion te paqes, Fondacioni Friedrich Ebert, Shkup, 2001
33. Özçelik, Sezai, “The Theory and Practice of Preventive Diplomacy: The Case of Preventive Deployment in Macedonia”, Uluslararası İlişkiler, Volume 3, No 1 1 (Fall 2006), p. 103-128.
34. Renan, Ernest (1996) “Éhat is a nation? (Qu’est-ce qu’une nation?)”. In Geoff Eley and Ronald Grigor Suny, eds. Becoming national: a reader. Neë York and Oxford: Oxford University Press.
35. Rexhail Ramadani, Thelbi i kontestit Greqi - Maqedoni, Monday, 21 June 2010 13:56 <http://www.lajmifundit.com/lajmet/editoriale/komente/8227-thelbi-i-kontestit-greqi-maqedoni/lajmet/editoriale/komente/8227-thelbi-i-kontestit-greqi-maqedoni?format=pdf>
36. Rubin J,Z, Mediation in International Relations, London, 1992.
37. Selmani Asllan, Gjeografia e Maqedonisë Antike
38. Shea John, (1997), Macedonia and Greece: The Struggle to Define a Neë Balkan Nation
39. Sitel.com.mk, 12/07/2010

40. Sitel.com.mk, 28/07/2010
41. Smila Avramov dhe Milenko Kreca, Medunarodno pravo, Beograd, 1996
42. Spyridon Sfetas, In the Shadoë of the Macedonian Issue, Institute for Balkan Studies
Thessaloniki
43. Studentski proekt (2008), Sporot za imeto medju Grcija i Makedonija, ISBN: 978-9989-
617-78-2
44. Te drejtat e njeriut si vlere demokratike, Klubi Demokratik dhe Fondacioni Fridrix Ebert,
Shkup, 2003
45. The Neë Cambridge Medieval History: Volume 1, C.500-c.700. Pg 538
46. The Reader's Gruide To The NATO Sumit in Washington, Statement on Kosovo, 25
April 1999, NATO office Information and Press, Brussels, 1999 14. L. Robertson,
Secretary General of NATO, Kosovo one Year On, North Atlantic, Treaty Organization,
Brussels, 2000
47. Thirlway H, The Law and Procedure of the International Court of Justice 1960-1989,
British Yearbook of International Laë, 1992
48. Trajanovski Aleksandar, The history of Macedonia: A short survey of the history of
Macedonia and the Macedonian people from ancient times to the present day ; ISBN :
978-9989-170—97-3
49. V.D Degan, Sources of International Laë, Martinus Nijhoff Publishers, 1997
50. Vangeli Anastas (2011) “Nation-building ancient Macedonian style: the origins and the
effects of the so-called antiquization in Macedonia”. Nationalities Papers 39, 1.
51. Zahariadis, Nikolaos (1996) “Greek policy toëard the Former Yugoslav Republic of
Macedonia,” Journal of Modern Greek Studies 14, 2, 303–328.

52. Zbir: ^ovekovi prava kako demokratska vrednost, M. Maleska, Pravata i odgovornostite odat zaedno, Fondacija Fridrh Ebert i Demokratski klub, Skopje, 2003
53. Adanar, F. (1998). The Socio- Political Environment of Balkan Nationalism: The Case of Ottoman Macedonia 1856-1912. Nederland's: L luver Laë International.
54. Спортот за името меѓу Грција и Македонија, ЈП службен весник на РМ, Скопје, 2008

Dokumente burimore

- Kushtetuta e R M-së, Studentski zbor, Shkup, 2002
- Marreveshja SOFA (mars 1996)
- Ligji për mbrojtje, "Slu'ben vesnik na RM" nr, 42/2002, Shkup
- Ligji për pune të brendshme, "Slu'ben vesnik na RM" nr.19/95, Shkup
- Ligji për shërbim në ARM, "Slu'ben vesnik na RM" nr. 62/2002, Shkup
- Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana, "Slu'ben vesnik na RM" br. 40/23 juni 2003, Skopje
- NATO Handbook , NATO Office of information and Press, Brussels, 2001
- Marrëveshjet: Republika e Maqedonisë dhe NATO (1998-2002)
- Marrëveshja Kornizë e Ohrit (13 gusht 2001)
- Programata PzM vospostavena vo ramkite na Severnoatlantskiot sovet za sorabotka:
- Akcionen plan za çlenstvo,
- Akcionen plan na Evroatlantskiot partnerski sovet (EAPS),
- Dokumentet themelore të OKB -së
- Dokumentet themelore të OSBE-së

